Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
16

EMËR QË U BË TRADITË

1. NËN MASKËN E MYSAFIRËVE
2. U VRANË TRE EMIGRANTË
3. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË
4. HEILBRONN TRE REFUGJATË JUGOSLLAVË U VRANË NATËN E KALUAR
5. VETURA ME TË VDEKURIT PA DREJTUES PËRPLASET NË DERËN E NJË GARAZHE
6. TERROR NË KRAHINË
7. TERROR POLITIK
8. TRE TË VDEKUR NË ATENTAT NË UNTERGRUPPENBACH JUGOSLLAVËT E EKZILUAR U VRANË NË VETURË
9. U VRANË TRE EMIGRANTË JUGOSLLAVË
10. ATENTATORËT NË UNTERGRUPPENBACH ISHIN „PROFESIONISTË“

11. DHUNA
12. DORA E GJATË E BEOGRADIT SHTRIHET DERI NË REPUBLIKËN FEDERALE
13. FLAMURI SHQIPTAR NË GJYSMËSHTIZË

14. PAS ATENTATIT ENDE S'KA „GJURMË TË NXEHTA“
15. ATENTATI I UNTERGRUPPENBACH-UT ARRITI NË BUNDESTAG
16. E TËRA DUKEJ SI PAS NJË EKZEKUTIMI
17. MARSH I HESHTUR PËR VIKTIMAT JUGOSLLAVE

18. VRASJE POLITIKE
19. NJOHURI MBI VRASJEN E JUGOSLLAVËVE
20. ME FOTOGRAFI FANTOME POLICIA KËRKON ATENTATORËT
21. KUSH E PA VETURËN E BARDHË GJATË NATËS?
22. SOT VARROSEN VIKTIMAT E ATENTATIT
23. ÇKA JANË KËTO SPEKTAKLE TË MJERA?
24. 300 TË PIKËLLUAR NË VARREZAT E VIKTIMAVE TË VRASJES
25. U VARROSËN JUGOSLLAVËT E VRARË TË UNTERGRUPPENBACH-UT
26. NUK KA „ZVARRITJE“
27. QËLLIMI I BACËS
28. QËLLIMI I BABIT
29. QËLLIMI E PRETENDIMI I BIJËS
30. JUSUF GËRVALLA-EMËR QË U BË TRADITË

31. SHTYHET RIVARRIMI I ESHTRAVE TË VËLLEZËRVE GËRVALLA DHE TË KADRI ZEKËS
32. PROMOVOHET LIBRI "PISHTARËT E LIRISË"
33. KTHEHEN NË KOSOVË ESHTRAT E JUSUF GËRVALLËS, BARDHOSH GËRVALLËS DHE KADRI ZEKËS
34. VARRIMI I JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËS DHE KADRI ZEKËS DO TË BËHET MË 24 SHKURT 2002
35. FAMILJA E KADRI ZEKËS REAGON KUNDËR SHPIFJEVE TË GAZETËS BOTA SOT
36. NDERIMET E FUNDIT
37. HOMAZHE NË PRISHTINË
38. BARDHOSH E JUSUF GËRVALLA DHE KADRI ZEKA I KTHEHEN TOKËS SË KOSOVËS
39. PJESË NGA FJALA E IBRAHIM RUGOVËS NË DUBOVIK
40. LETËR FALENDERIMI E FAMILJES GËRVALLA

41. LETËR E HAPUR KRYETARIT TË KOSOVËS IBRAHIM RUGOVA
42. U PËRKUJTUA FIGURA E HEROIT JUSUF GËRVALLA
43. HYSEN GËRVALLA INTERVISTOHET NGA GAZETA BOTA SOT
44. MENDJELEHTËSI APO DIÇKA TJETËR
45. RIAKTIVIZOHET KLUBI LETRAR "JUSUF GËRVALLA"
46. INTERVISTA E HYSEN GËRVALLËS PËR GAZETËN BOTA SOT
47. NË DEÇAN SHËNOHET 25-VJETORI I RENIES SE VELLEZERVE GERVALLA E KADRI ZEKA
48. AKTIVITETE PËRKUJTIMORE
49. E ADMIRON KËTË NJERI
50. DËSHMORËT E "BRIGADËS 131 JUSUF GËRVALLA"

51. MAGJISTRATURA E MYRVETE DRESHAJ-BALIU
52. FLAKA QË NDRIQOI RRUGËN E LIRISË
53. SHKRIMTARI GËRVALLA VJEN I PLOTË PARA LEXUESIT

54. DUHET THYER HESHTJA
55. HESHTJA QË ËSHTË THYER TASH E TRI DEKADA
56. TRE YJEVE TË PAVDEKËSISË

1. NËN MASKËN E MYSAFIRËVE

Nga Sabit Rrustemi

Xhafer Durmishi: "*Nën maskën e mysafirëve*

Përshëndetje Hafiz, Uroi të jesh mirë. Po ta dërgoj shkrimin e Sabit Rrustemit "Nën maskën e mysafirëve" nga prilli 1981 me një parathënie të Jusufit, i ribotuar në Zërin e Kosovës, nr.1, nëntor 1981. Shumë të fala Xhaferi (Letër Hafiz Gagicës, 5 maj 2011 11:48:47)

E nderuara redaksi, të nderuar miq e lexues të "Zemrës shqiptare"
Para pak çastesh, u surprizova këndshëm nga një mik imi dhe veprimtar yni i palodhur i çështjes shqiptare, z. Hafiz Gagica. Ma kishte përcjellur në hotmail, tregimin tim të publikuar para tridhjetë vitesh, NËN MASKËN E MYSAFIRËVE. Për befasinë time të këndshme, tregimi qenka dhe me një shënim përcjellës të heroit tonë, Atdhetarit e shkrimtarit, Jusuf Gërvalla. Dhe, për koincidencë, ky tregim rikthehet tek unë pas tridhjetë vitesh, me tetë Maj 2011, të njejtën datë kur edhe isha arrestuar, pra, me 8 Maj 1981. Vetëm se ajo ditë atë kohë ishte e Premte, kurse sot, është e dielë. Në rikujtim të atyre ngjarjeve dhe në shenjë mirënjohjeje për z. Hafiz Gagica, këtë kënaqësi që përjetova, e ndaj bashkërisht me ju... risjell tregimin dhe shënimin hyrës të të madhit Jusuf Gërvalla, që qenkan botuar bashkërisht më 1 Nëntor 1981 në "Zëri i Kosovës" Sabit Rrustemi
(www.zemrashqiptare.net, 10 maj 2011)

Jusuf Gërvalla: "*Shënim: Tregimi i Sabit Rrustemit "NËN MASKËN E MYSAFIRËVE" (nga fletëza e tetë) u botua për herë të parë në revistën "FJALA" të 1 prillit të këtij viti. Në mëngjesin e asaj dite, herët, sapo revista u lexua nga denoncuesit e parë ose nga nëpunësit e parë të UDB-së, menjëherë u dha alarmi për ndalimin e "FJALËS" dhe për mbledhjen e numrave që tashmë kishin dalë në shitje, si dhe për gjetjen e rrëmbimin e ekzemplarëve të shitur shpejt e shpejt.*

PRETEKSTI: Sipas fjalës së serbomëdhenjve dhe lakejve të tyre, tregimi në fjalë bënte aludim të drejtpërdrejtë në ngjarjet më të reja të Kosovës. Por kjo s'ka si të jetë e vërtetë, po të marrim parasysh kohën që i është dashur autorit për ta shkruar dhe revistës për t'u botuar, të mos flasim për procedurën tjetër të shtypit, siç është redaktimi, lekturimi etj.

Kjo s'do të thotë se tregimit i humbet vlera. Përkundrazi, duke ngjarë shumë me një situatë të mëvonshme të krijuar në Kosovë pas intervenimit ushtarak e policor të Serbisë në Kosovë (në maj të këtij viti, në Gërmi të Prishtinës, u zhvillua një ngjarje thuaja identike me atë që përshkruhet në tregim: policia kroate u përlesh me policinë serbe, me ç'rast mbetën dhjetëra policë të vrarë e shumë të plagosur), ky tregim flet për intuitën thuaja të materializuar të autorit për ngjarjet që do të ndodhnin thuaja atë çast.

Të shtojmë këtu se autori i tregimit, Sabit Rrustemi, dhe kryeredaktori i revistës "FJALA", që e botoi këtë tregim, tani ndodhen në burg, të dënuar, i pari me 4, dhe i dyti me tri vjet burgim të rëndë."

(TREGIM)

... vetëton, bubullon, vetëton, bubullon, pandërprerë. Ka humbur qetësia. Në këtë kohë të zezë nuk ka qetësi. Vetëm shqetësime, vetëm shqetësime.
Qoftëlargu me të vërtetë sillet. Sillet e kërkon. Gjuan e më rrallë qëllon. Huq. Sa nuk pëlcet. Shtrëngon dhëmbët. Kërcëllon. Uluron. Kafshon gjuhën. Shkul mustaqet. Shpurdhë me këmbë. Prish edhe më shumë sytë, krahi i djathtë i tij, Syprishuri. Lirë na bleu se nuk na njohu. Tash po na njeh, pasi na mbështeti për muri... Çirret e çirret kur ia djegin cergën aty-këtu. Ngapak. Ia bëjmë me dije se kjo tokë s'është e lënë, e harruar, asnjëherë, jo ...

Janë bërë si të çmendur, si të çartur. S'shohin nëse është fëmijë, grua apo i moshuar. Po të jetë yni, e shqyejnë si ujqit. Atyre u ngjajnë, ujqve të uritur. Në është yni, e djegin deri në koc. Me ujë të valë e përvëlojnë. Shpirtin ia nxjerrin me gurë e therra. Në është yni, copa-copa e bëjnë. Gjakpirësit. Kokëngrënësit. Zullumçarët kanë shkelur çdo rregull. Nuk e kanë të gjatë, jo. Kanë prekur edhe në fëmijë, hej, edhe në fëmijë... !

*
* *

Ata s'janë nga të mëparshmit. Kur nuk na linin vend kund. S'janë. Ndryshuan si ndryshon koha në dimër. Njëqind fytyra i ndërron brenda ditës. Edhe ata njësoj. Ajo egërsia e dikurshme, që s'hiqej prej syve të tyre, është zhdukur. Veç t'i shohësh; sa të urtë, sa të butë, melaqe! Dreq me gojë s'dinë të thonë. Qafirat. Edepsuzat! I njohim, i njohim! Ujku qimen e ndërron, po mjeshtërinë s'e harron. Edhe këta ujq janë. Ata që na kërkonin kokat, ata që na vrisinin, na digjnin, na vranin ku na zinin... E tash e kanë pisk. Kungulli nuk shkon gjithnjë mbi ujë. Nuk shkon. Rëndohet një ditë. Shafon. Aq thellë shafon, sa nuk e mban më asnjë thellësi. Secila e hedh thellë e më thellë.

Ani ai Syprishuri! Ani ai se! Demek, e harruam ne atë? Zullumet e tij? Jo, ore, jo! Na kujtohen fare mirë. Sa njeriu është zhdukur prej dorës së tij. Sa e sa nëna kanë mbetur qyqe në gur të vatrës duke vajtuar. Sa e sa gra kanë mbetur me fëmijë në djep a në bark, duke e ruajtur. Sa e sa vasha, me pajën në dorë, duke pritur e duke thurur... E njohim fare mirë. Sa fshatrave u është vënë zjarri nga dora e tij. Sa shtëpive u është vënë dryri nga dora e tij... I dimë, të gjitha i dimë. Dhe, ai, ai na ndryshuaka tash? Jo, ore! Le të mos ndryshoj fare. Ata sy do t'ia rregullojmë, që të shoh më drejt. Trimat njihen në kohë të vështira.

Po seç po flasin për të? Nuk më besohet se kam dashur vetë të bëhem ballë për ballë me të. E paska zënë një natë sherri po thonë. E me kë se! Me atë Sybutin, me atë që njëmend dreq me gojë s'dinte të thoshte. Po ia kishin plasur zemrën me krime. Si të mos ishte i tyre: A mund të ketë edhe te ta zemërmirë?
Kishin qenë në rojë. Aty pas mesnate. Jashtë fshatit. Në të hyrë, ku para tyre shtrihej fusha e gjërë. Lepuri u kishte hyrë në bark. Në vend të huaj më! Shumë kohë kishin heshtur. Çile gurë gojën! Dikur s'ishin duruar. Kishin ndërruar fjalë, për ta larguar vetminë që s'i lëshonte, për t'i liruar zemrat e mbushura mëkate ...

— Ftohtë. Na mbytën ethet. Çfarë ethesh se! — kishte folur Sybuti, ai që rrallë fliste.

— Na mërdhinë, na ngrinë, e asku të zëmë vend! — kish pranuar Syprishuri.

Uniformat e përhirta i kishin shtrënguar më shumë për trupi. Disi kishin zënë të ngroheshin. Sidomos Sybuti. Ndiente nevojë për t'u çliruar nga një mal fjalësh të pathëna që i vërtiteshin nëpër kokë. Po si t'ia fillonte? Syprishuri nuk i jepte shenja se është i interesuar për bisedë. Megjithatë ky nuk ishte duruar.

— I ke dëgjuar ç'thonë për ne? — kishte menduar në thashethemet që qarkullonin ndër ne për shqetësimet e tyre, për qerren, që si duket, e kishte marrë tatëpjetën dhe ndale Qoftëlarg, në mund ta ndalësh!

— Hm? — ishte kthyer kah ai Syprishuri. Nëpër terrin e natës kishte dashur t'ia shihte fytyrën. — Ç'thonë?

— E kanë prej dielli thonë. — U ka rënë mbi kokë. I ka trullosur. Nga dielli e kanë. Tash as mirë s'po shohin. Dielli i ka verbuar. I sheh si ecin? Si pulat nëpër terr. U ka rënë terri syve. Të terrosurit. U ka rënë terri i pulave. Të gjorët. Krenoheshin. Botën deshën ta fusnin në grusht. Për çudi, qëlloi e madhe, u mbeti në fyt. Tash diellin e kanë mbi kokë. I djeg e s'i nxeh. I vërbon, e dritë s'i fal. E kanë përbuzur diellin. Le të qëndrojnë tash. Le të durojnë tash. Kjo s'është lojë. Luftë është ...

— S'kanë faj, jo! Ndihen më të lirë! Më parë vetëm tek-tuk një krismë dëgjohej, e lëre më të flasin. Tash jo që nuk i prajnë krismat, po edhe flasin!

— Kohët ndërrojnë.

— Ndërrojnë, ndërrojnë, — kishte pshërtirë Syprishuri. — Njëmend ndërruakan kohët!

— Edhe për të tjera gjëra flasin...

— Le të flasin; goja llap-llap, shpina dap-dap!

— Flasin edhe për shumçka tjetër, por vështirë kuptohen.

— Lëri më! Më vlon koka!... — Ishte ngritur më këmbë Syprishuri. — Lëri më!

— Prapë kishte thënë.

— Por...

— Ç'deshe?

— S'di, jo ...

— Fol de, fol! — kishte vazhduar përsëri, pas një pauze të gjatë, me një zë të ulët e të frikëshëm, nëpër qetësinë e thellë të asaj nate, që e tërhiqte ngadalë pelerinën e zezë, e mblidhte në vete sikur të frikësohej nga dikush, nga dita, nga dita që do të vinte.

— Po flas dhe, plas. Plas. Flas e plas. Nuk na mbeti tjetër.

— Ç' gjuhë është kjo? — ishte hidhëruar Syprishuri.

— Ç'gjuhë? Nuk e kupton? Dëgjo: flaseplasplaseflas. Apo: plaseflasflaseplas.

— Të qenka zgjatur, si duket. Duhet ta shkurtojmë pak.

— Lëre ti gjuhën time. Këta flasin, vazhdimisht flasin.

— Lojë janë fjalët e tyre, lojë, lojë! — kishte ngritur zërin e tij të vrazhdë Syprishuri.

— Ç'loj, ej!

— Lojë, lojë!

— Ne nuk flasim për ata... ?

— I di këto!

— Atëherë?

— Demek. Ditkan edhe këta të flasin?

— Fjalë e shpatë...

— ... ?

— Me plumb vrasin një, me fjalë njëqind. Dhe t'i presin këmbët. Këmbët e rrugët. Së paku të ishim kthyer atje ku ishim! — deri tash ia kishte pëshpëritur vetes disa herë këtë dëshirë. Tash ia thoshte hapur edhe Syprishurit.

— S'kemi ardhur për t'u kthyer...

— Jo, se varret i kanë hapur për të gjithë ne!

Syprishuri i prish sytë sa s'ka. I zgurdullon. Po nuk sheh mirë. Ishte terr. Pika e natës.

— Të huaj jemi këtu...

Syprishuri ishte afruar. Nëpër terr kishte dalluar vetëm hijen e trupit të tij. "Vetëm hije jemi këtu, hije të natës, lugetër!" — dhe një dridhmë ia kishte përshkuar trupin tej për tej. I ishte afruar edhe më, për ta parë sa më mirë.

— Ndien frikë?

Zëri i tij kishte qenë ngapak tallës, ngapak fyes.

— Kush prej nesh nuk ndien frikë?

— Ty të paska hyrë në bark.

— Nuk e kam nga frika. Por nuk jam atje ku isha.

— Filozofi na shet ti? Je këtu ku ke menduar.

— Vetëm ndonjë libër të vjetër kam lexuar për këtë vend, kam dëgjuar për këta njerëz. Se do të vij këtu, as ëndërr s'kam parë. E mendoja gjithnjë si një vend të ashpër, të papërkulur, — kishte ecur në drejtim të Syprishurit, meqë ky kish qëndruar disa hapa larg tij, kinse nuk dëgjonte. — Dhe, dije: të tjerët menduan për mua, për ty, për të gjithë ne. Na mashtruan.

— E zgjate shumë, — ishte bërë i padurueshëm Syprishuri. — Ne erdhëm si mysafirë! E ke harruar këtë? Portat na i hapën vetë. Pastaj na qëlluan, disa të shitur, dhe nisi kjo valle e quajtur luftë.

— Ne s'ishim mysafirë. Vetëm maskën e tyre kishim. Mysafirë s'ishim.

Secili në vete kish rikujtuar për të satën herë ardhjen në këtë vend. Ata zbarkonin. Disa na tanët u bënin temena. Shumica ishin shpërndarë nëpër popull. Ngritnin masën në demonstrata, protesta. Armët ishin në dry. Edhe ato thatë, pa fishekë. Kush kishte në shtëpi, dilte e zinte një breg dhe i përshëndeste këta mysafirë me rafale plumbash, se nderi i këtyre anëve kështu e donte. Ndërsa ata zbarkonin. Si mysafirë. Po të armatosur deri në dhëmbë. Ky mysafirllëk ia kish vrarë syrin edhe Sybutit. "Mysafirë, e të komandosh. Të bëhet si thua ti. Jo!" — për të satën herë nuk ishte pajtuar ai. "Ne pushtues jemi. Jo mysafirë. Vetëm maskën e tyre paskemi, sa për të hyrë brenda në vatër", sa nuk kishte bërtitur të madhe për ta dëgjuar gjithë fushat, malet. Për ta dëgjuar anembanë ky vend i ashpër, i panënshtruar. Vendësit, kah ishin e kah s'ishin. "Ne pushtues jemi", i kishte thënë me mijëra herë vetes në këto vite sa ishin këtu, dhe thellë në shpirt e kishte brejtur diçka. E kishte kafshuar keqas. Sa nuk kishte bërtitur: "Pushtues! Pushtues!"

Koka e tij ishte varur mbi armën e ftohtë. Pas pak e kishte kotur gjumi. Pak, fare pak. Një gjumë, një kllapi. Ai tjetri, Syprishuri kishte lëvizur në vend, më shumë që të mos i ngritej gjaku damarëve, atë natë që frika u kishte hyrë në palcë. Kishte përgjuar fushën. Fusha ka sy, mali ka vesh! Ku e kishte dëgjuar? Këtu, këtej, prej dikujt. Ndoshta prej Sybutit. Ai kishte fjetur, ndërsa ky nuk ia kishte prishur gjumin. Veshët ia kishte qitur këtë natë me llokopendra. Çuditej me të: ku i gjente gjithë ato fjalë, ky që rallë ose fare nuk fliste pa e pyetur, pa ia nxjerrë si me darë. Deri tash qenka zier në vete, qenka ngrënë. Tash shpërtheu. Papritur. E nuk ia prishte gjumin. Le të flejë, vetëm të mos më shurdhojë me filozofi të thata. Mali ishte larg. S'kishte frikë nga askush. Sytë katër i kishte drejtuar andej se mos luante kush, se mos dëgjohej krismë. Po, heshtje, heshtje e rëndë kishte pllakosur. Pas kësaj heshtje, e dinte ç'do vinte.

Ç'hynë në vatër, digjet. Tym bëhet. Ke parë ndonjëherë tym? Ngjyra e tij është e njejtë me ngjyrën e rrobave tona."

U kthye papritur. Prej nga ky zë? Sybuti fliste jerm. Iu afrua. Koka e tij ishte shtrembëruar, ishte varur edhe më mbi armën e ftohtë. Me majën e këpucës e preku në cep të krahut. Ai u zgjua.

— Ç'flet përçart?

— Flas çka shoh!

— Ke luajtur mendsh?

— Ke luajtur mendsh? — ende ishte i përgjumur.

— Ty të them!

— Ty të them? — kishte përsëritur prap Sybuti.

— Nuk të kam papagall. Mos përsërit! — Nga këto fjalë shihej inati, mërzia e Syprishurit.

— Jeta qenka e tillë, përsëritje.

— Të kanë lënë pak!

— S'më kanë lënë, po asgjë mbarë s'na shkon!

— E ke humbur besimin?

— Kam humbur durimin.

— Ç'thua?

— Këtu nata ecën ngadalë.

Syprishuri kishte heshtur.

— Zgjat njëqind vjet.

Syprishurit nuk iu ishte duruar:

— Harruam që jemi në rojë! Heshtim...

Parandjenja të tmerrshme vërtiteshin nëpër perden e syve të Sybutit. Nga rrezet e maleve dilnin njerëz grupe-grupe. Zinin prita. I vënin dy-tre gurë përpara. Pastaj tytat e pushkëve i bënin gati për zjarr dhe pritnin. Edhe pak, flakët e tyre do ta shkyenin terrin e kësaj nate? Jo. Terrin e këtij paraagu. Edhe pak. Nata në gishtërinj mund t'i numërojë minutat, sekondat.

— Afër është! — ishte trandur nga ata parandjenja Sybuti.

— Kush?

— Kapitullimi...

— Mos e thuaj atë fjalë! — kish brofur në këmbë Syprishuri.

— Si të mos e them, kur kemi hyrë në rreth.

— Je penduar?

— E ç'fola deri tash?

— Atë që deshe!

— Atë që pashë: fundin.

— Më lodhe...

— Edhe pak!

— Tërë natën s'të pushoi ajo gjuhë!

— Për të folur e kam gojën. Deri tash heshta. S'duroj më. M'u desh të shprazesha para dikujt njëherë. Dhe ti qëllove këtë natë. Po flas shumë? E di, por ky është i vetmi ngushëllim tash. Keq u mashtruam.

— Nëse u mashtruam, nuk je ti i vetmi, — dukej se pendohej Syprishuri.

— Të gjithë njësoj jemi, me një emër të tmerrshëm, të përbashkët: pushtues! Si fëmijë, i kam urryer lakmitarët. Tash e urrej edhe vetveten.

— Edhe neve?

— Pushtuesit!

— Ti më së paku e paske merituar këtë ardhje! — me gjithë mend i kishte thënë Syprishuri. Sybuti ia kishte plasur gazit.

— Ha, ha, ha! E zë për nder ti këtë ardhje? Krenohesh? Beson se do të kthehesh kryelart? Dhe, do të të thurin himne lavdie? I marrë — i kishte plasur zemra më. — As eshtrat s'do t'i gjejnë për t'i kthyer në vendlindje. Këtu as djalli s'do të shpëtojë.

— Pusho!

Syprishurit i ishte ndezur gjaku. Pak nga ndonjë krismë e largët, ushtime e së cilës nuk i harronte as veshët e tij, pak nga fjalët që kishte dëgjuar më parë prej Sybutit. Ia kishte ngulur sytë. E shikonte si i çartur. Terri i mëngjesit e pengonte ende t'a dallonte atë fytyrë më mirë.

— Ç'më shikon si ujk i plagosur? — Edhe gjaku i Sybutit dinte të nxehej. Edhe zëri, edhe zëri i tij bëhej i vrazhdë. Po sytë, ata sy të butë, bëheshin të egër, të prishur kundruall Syprishurit.

— Pusho! — thirri për të dytën herë Syprishuri. Ai sa vinte bëhej më i padurueshëm. Hiç më pak edhe Sybuti.

— Ia kemi rënduar ndërgjegjen popullit. Më kupton? I kemi poshtëruar nënat tona. Pjellën e tyre — s'ndalej që s'ndalej ai.

— Pusho, ose...

— Më bren nata. Terri i mëngjesit më ha. Afro veshin e dëgjo, si ma grimcon diçka trupin. Patjetër më duhet të flas. Të shprazem dhe të pëlcas. Duart, duart i kemi me gjak. E këtu gjaku gjakun paguan.

— Të vrava...

— Prit edhe pak. Ende nuk ta kam thënë atë që dua të them.

— Thuaje më, e hesht!

— Mos u shqetëso, të njëjtat rroba kemi veshur!

— Kryeneç!

— Kryeneç e dreq. Kur të njoh s'kam pse frikohem.

— E teprove!

— Plumbat i kemi me grat. Ta dish! Rrugët janë mbyllur. Edhe ne. Çdo ditë pakësohemi. Toka na zhduk. Një ditë as ne s'do të jemi bashkë. Do të zhdukemi si këto fjalë në terrin e kësaj nate.

— Frikacakët s'kanë vend as ndër varre.

— Mendove në pushtuesit? Atyre, në vend të luleve, u vënë therra. Në vend të përgëzimeve, urimeve për trimëri, ata marrin mallkimet për krimet që kanë bërë.

— Ti je i dehur...

— Jo!

— Atëherë... ?

— Kot bëmë roje kësaj nate, dita do të vijë me dritë...

— Dreq gjuhë paske!

— Ky s'është kompliment, nuk të falenderoj.

— Edhe me humor? — sa nuk pëlciti ai.

— Për fytyrën tënde të egër. S'qeshë kurrë fatkeq!

— Po luan me kokën tënde.

— Ne të gjithë i kemi kokat në lojë. S'dihet cila qëllohet e para, cila e fundit...

— Krismat shpeshtoheshin. Afroheshin. Këta shqetësoheshin.

— I dëgjon krismat? — shtrëngoi armën e ftohtë Sybuti.

— Krismat? — Syprishuri dridhej me armën në dorë. — Të kujt janë këto krisma? — mezi u dëgjua zëri i tij.

— Të pushkëve tona! — mori veten Sybuti. — Të pushkëve që ne i ndërruam me nga një pulë, me nga dhjetë kokrra vezë...

— Nga vijnë?

— Nga malet. Po ç'ke që je zverdhur?

— Vetëvrasje është kjo, vetëvrasje. Të na vrasin me armët tona...

— Ngadal beg se ka hendek! Hm! Ç'je hutuar? Ç'i shikon duart ende s'të janë tharë fluskat e gjakut? Gjakpirës!

Ai drejtoi armën kundër tij.

Ç'të dridhen gishtat, kriminel, ç'të dridhen?
Tashmë tytat e armëve të tyre nuk ishin kthyer nga malet, andej nga vinin krismat. Ishin drejtuar kah njëra-tjetra.

— Këtu... këtë... kë... tu... — deshi të thoshte diçka Sybuti. Goja iu mbush gjak, njësoj si Syprishurit, nga krismat, nga flakët e përnjëhershme.
Asgjë s'kishin parë më, asgjë s'kishin ndier, pos metaleve të ftohta, plumbave që u futeshin nëpër mishra, nëpër eshtra dhe ua turbullonin gjakrat e ua prenin damarët, lidhjet, jetërat, qetë-qetë. Aty para agut, në të hyrë të fshatit, në fushën e gjerë, i gjetën të vrarë dy rojat e fundit të asaj nate...

Eh sikur të isha bërë sy më sy me të, me atë Syprishurin. I kemi pasur do fjalë, por ç'e do. Nuk qenka më për fat!

(Marrë nga "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ, nr. 1, nëntor 1981)

2. U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar - (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergrupenbah, afër Hajlbronit, në Krahinën Baden-Virtenberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qërim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se "fjala është për krim me prapavijë politike", sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë "rryma" dhe "grupacione".

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktima të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktima e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rrept vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se "qeveria shpreh keqardhje për shkak të përleshjeve të tilla. (RILINDJA)

3. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË

TIRANE, 19 janar 1982 ATSH, - Sikurse njofton agjensia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, të dielën më 17 janar, natën vonë, në fshatin Untergrupenbah, në afërsi të qytetit të Shtutgart të Gjermanisë Perëndimore, u vranë kosovarët Bardhosh Gërvalla, Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka. Sipas burimeve zyrtare gjermanoperëndimore, sulmi u krye të dielën natën, pak kohë pasi të tre kosovarët dolën me makinë nga një garazh. Vrasësit e armatosur hapën zjarr kundër makinës dhe vranë në vend Kadri Zekën (28 vjeç) dhe

Bardhosh Gërvallën (31 vjeç). Jusuf Gërvalla (36 vjeç), i plagosur rëndë vdiq më pas në spital.

Agjencia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, agjencia franceze e lajmeve, AFP, dhe agjencia amerikane e lajmeve, ASPRESS, duke dhënë lajmin e vrasjes së tre shqiptarëve, theksojnë se, sipas deklaratave të zyrtarëve të sigurimit gjermanoperëndimor të Shtutgartit dhe sipas shërbimit lokal të hetimeve kriminale, Jusuf Gërvalla duke dhënë shpirt në spital, akuzoi policinë sekrete jugosllave se qëndronte pas këtyre tri vrasjeve.

Ndërsa agjencia jugosllave e lajmeve TANJUG, lajmin që dha për vrasjen e tre djemve kosovarë e cilëson si " larje hesapesh" midis emigrantëve, shprehje kjo që e kemi dëgjuar shpesh nga udhëheqësit kryesorë jugosllavë dhe ata të Kosovës, kur është fjala për masa shtypëse e terroriste kundër shqiptarëve në Jugosllavi." (Zëri i Popullit, 20 janar 1982)

4. HEILBRONN TRE REFUGJATË JUGOSLLAVË U VRANË NATËN E KALUAR

(Përgatitën Xhafer Leci e Kadri Mani-Osmani)
(Stuttgarter Nachrichten - 19 janar 1982)
Nga një anëtar i redaksise sonë, Heilbronn/Stuttgart (Ppu)

Tre jugosllavë në egzil u vranë të dielën mbrëma, në Untergrupenbach, afër Heilbronn-it, pas një sulmi, sipas te gjitha gjasave me motive politike, e nuk përjashtohet mundësia që në prapavi të jetë kjo vepër e shërbimit sekret. Sipas njoftimit të prokurorit në Heilbron, njëri prej tri viktimave, i cili vdiq nga pasojat e qëllimit me armë, pas katër orësh për gjakderdhjen e mbrëmshme. Për shkak të motivit politik të krimit të mbremshëm, hetimet për këtë rast i ka marrë përsipër zyra shtetërore e krimeve në Stuttgart. Viktimat, në mesin e tyre dy vëllezër, janë jugosllavë, me përkatësi kombëtare shqiptare, të cilët kishin bërë përvojë në kundërshtimin e rrethanave politike në Kosovë, në kufi me Shqipërinë, duke u angazhuar për themelimin e Republikës së Pavarur të Kosovës. Emrat e tyre janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28). Jusuf Gërvalla gjendej në Gjermani nga dhjetori i vitit 1979 si refugjat politik dhe së bashku me vëllanë e tij, duket të jenë fajësuar nga organet jugosllave si anëtarë udheheqës të një organizate antijugosllave. Kadri Zeka, gazetar i radiotelevizionit kishte jetuar në Zvicer. (Nga gjermanishtja: Tefik Ramadani-Qarri)

5. VETURA ME TË VDEKURIT PA DREJTUES PËRPLASET NË DERËN E NJË GARAZHE

Rrjedha e atentatit në Untergruppenbach vazhdon të sqarohet:

Dëshmitarët i vërejtën gjuajtësit / Personi i dytë „kontrollon" rezultatin / Enti Kriminalistik i Vendit kërkon ndihmën e popullit

Nga anëtari ynë i Redaksisë: Uwe Jacobi (Heilbronner Stimme, 19 janar 1982)

Rrjedha e atentatit në Untergruppenbach, në të cilin në natën e së hënës së kaluar ranë viktima tre mërgimtarë jugosllavë (shiko faqen politike 1), mund të sqarohet. Dëshmitarët vërejtën dikë të shtinte me revole dhe dëgjuan 5 deri 7 të shtëna, që u zbrazën mbi personat që ndodheshin në veturë. Nga errësira u shfaq personi i dytë, i cili me një vështrim në veturë e kontrollon „rezultatin" e breshërisë,

dhe u zhduk në këmbë në drejtimin e njëjtë sikurse gjuajtësi i parë. Pastaj, vetura pa drejtues u përplas në derën e një garazhe, me dy të vdekur dhe një të mbijetuar sulmit, i cili gjithashtu vdiq më vonë. Është e paqartë, gjithsesi, si ndodhi që këta tre jugosllavë, që ishin angazhuar për pavarësinë e atdheut të tyre, Kosovës, të bien në të njëjtën „kurth". Për akuzat, se Shërbimi Sekret Jugosllav është i përfshirë në vrasje, dje u tha se nuk është vërtetuar nga zyrtarët e hetuesisë. Përmes zëdhënësit policia kërkoi nga populli në Untergruppenbach që të ndihmojë në kapjen e të dyshuarve.

Tre mërgimtarët jugosllavë, të dielën, pak pas orës 22:00, dolën nga shtëpia e vëllezërve Gërvalla në Habichthöhe 40: Gazetari Jusuf Gërvalla (36), punëtori social Bardhosh Gërvalla (31), dhe Kadri Zeka (28) reporter i radios, i cili të shtunën në mbrëmje kishte ardhur nga Zvicra te vëllezërit Gërvalla.

Arsye e daljes së tyre natën, më vonë u mësua nga qarqet familjare të familjes Gërvalla se ishte shkuarja në Donnbronn, për të telefonuar nga një kabinë publike telefonike. Në shtëpinë e familjes Gërvalla nuk kishte lidhje telefoni. Gjithsesi, mbetet e paqartë se pse dëshironin të telefononin nga një vend më i largët si Donnbronn-i, e jo nga një kabinë telefonike e cila ishte vetëm 200 metra larg.

Treshja zbret në garazhin e shtëpisë së tyre, në një oborr të madh garazhesh, e cila i takonte një vendndërtimi të ri, ku ndodhej edhe BMW e vëllezërve Gërvalla. Vetura për shkak të borës s'mund të kthehej në oborr, por shkoi prapa rreth 40 metra, për t'u kthyer pastaj në Habichthöhe.

Gjatë ecjes së ngadalshme, papritmas shfaqet një pamje burri, i cili shtie mbi personat që ishin në veturë. Sipas dëshmitarëve që kanë dëgjuar krismat, duhej të kenë qenë 5 deri 7 të shtëna. Se a ka qenë revole automatike apo automatik, mbetet e paqartë. Nga vetura nuk ka pasur të shtëna kundër, por as më vonë nuk janë gjetur armë në të.

Gjatë të shtënave, vetura ec edhe disa metra prapa mbi rrugë, pastaj ndalet. Pastaj sulmuesi vrapon. Sakaq shfaqet një person i dytë, i cili nuk shtie por vetëm vështron brenda veturës dhe gjithashtu arratiset.

Vetura qëndron në vend e ndezur dhe me lëvizje të shpejta të motorit. Papritur ecë përpara, si duket pa drejtues, bën një gjysmërrethi nga e majta dhe pastaj përplaset në një portë të mbyllur garazhe, e cila shtypet. Me gjithë ndaljen, rrotat vazhdojnë të sillen duke u ngrënë fort mbi borë, pastaj "vdesin".

Dy nga personat që ishin në veturë supozohet të kenë vdekur menjëherë gjatë sulmit me zjarr: Bardhosh Gërvalla, i cili e ka drejtuar veturën, dhe Kadri Zeka, i cili ka qenë afër tij. Jusuf Gërvalla, i cili ka qenë i ulur prapa, goditet nga dy plumba në pjesën e epërme të trupit, fillimisht e mbijetoi atentatin.

Me lëndime të rrezikshme për jetën, Jusuf Gërvalla dërgohet në spital. Në pyetjen e parë, ai e bën përgjegjës Shërbimin Sekret Jugosllav për sulmin. Policia për kriminalistikë e Heilbronn-it, e ndihmuar nga policia për mbrojtje, filloi menjëherë hetimet për përcaktimin dhe sigurimin e gjurmëve.

Pak pas orës 03:00, në ndërtesën e Komunës ku ishte e vendosur provizorisht policia kujdestare, vjen lajmi se Jusuf Gërvalla kishte vdekur rreth orës 02.55 në spital.

Për shkak të rrethanave politike, hetimet për vrasjen dje i mori përsipër një komision i veçantë i Entit Kriminalistik të Vendit. Në hetime thuhet se ka të dhëna qenësore se vrasësit kanë ikur në drejtim të Donnbronner Höhe, prandaj Enti Kriminalistik i Vendit i bën thirrje popullit që të ndihmojë në gjetjen e vrasësve për sa vijon:

– Kush ka parë të dielën para orës 22.30, në regjionin Habitchöhe, persona ose

veturë të dyshimtë?

– Kush ka parë ose dëgjuar pas të shtënave personat ose veturën e dyshimtë?

– Në ditët e fundit a është vërejtur diçka tjetër e dyshimtë, veçanërisht, a janë vërejtur persona që kanë përcjellë banesën e familjes Gërvalla, kanë pyetur për banesën, apo për familjen Gërvalla?

Të dhënat i merr „Komisioni i Veçantë në Untergruppenbach“. (telefoni: 07131/1042179) ose çdo stacion i policisë. Për informata të veçanta, Komisioni i Veçantë ka vënë në dispozicion një „telefon të besueshëm“, me numrin 07131/1042123.

Heilbroner Stime 19. 01. 1982

6. TERROR NË KRAHINË

Nga Hans Georg Grimm: (Heilbronner Stimme, 19 janar 1982)

Në komunën e vogël u prish qetësia nga një seri të shtënash. Terror në krahinë – si në natën mes të së dielës dhe të hënës në Untergruppenbach. Tre njerëz, tre veprimtarë politikë ish-jugosllavë, nga regjioni i trazuar i Kosovës, vdiqën në rrugë të hapur.

Qytetarët e vendit të goditur dhe të tronditur janë ballafaquar nga afër me grindjet politike brutale, të cilat mund të barten deri para dyerve të shtëpive të tyre, me ngjarje të cilat njeriu gjithnjë i ka përfytyruar si të largëta, por të cilat brenda natës mund të bëhen pjesë e përditshmërisë, siç janë goditur në fqinjësi ata të Reihenhaus-it.

Kur do të fashitën goditja dhe tmerri?, do të ketë pyetje.

Pyetje urgjente, të cilat më nuk janë vetëm pyetje akademike. Do të jenë pyetje të cilat nuk do të shtrohen vetëm në komunat e prekura. Pyetje për politikanët që duhet të bëjnë diçka për këto vrasje gjakftohta në Republikën Federale, më së shpeshti të nxitura nga skenat e huaja politike. Pyetje për politikanët të cilët lidhur me vrasjen më gjakftohtë dhe më të poshtëruar nga skena politike e të huajve, do të bëjnë presion në Republikën Federale.

Këtu nuk duhet hetuar nëse ka apo jo prapavijë kombëtare apo ndërkombëtare ngjarja që ka të bëjë në dhe rreth Kosovës. Duhet të parashtrohet pyetja në radhë të parë për politikën që ndiqet lidhur me të strehuarit dhe të huajt në Republikën Federale dhe në ç’masë është e garantuar siguria e shtetit dhe e qytetarëve të tij.

E mërzitshme, por duhet pyetur për politikën e jashtme dhe vetë imazhin e Republikës Federale, nëse edhe një herë konfirmohet dyshimi se Shërbimi Sekret Jugosllav UDBA qëndron prapa sulmit me armë zjarri, ku si pasojë pat vrasjen e trefishtë të urryer në pjesën e poshtme të vendit.

Shërbimet Sekrete parasëgjithash janë pjesë dhe organ ekzekutiv i qeverisë, në vendet ku mbretëron diktatura. Në këtë rast, secili qeveritar në Beograd, i cili për herë të parë nuk sulmon me mjete të tilla që azilantët e padëshiruar t’i mënjanojë pa u turpëruar.

Në këtë rast, lejimi i gjërave të tilla iu shkon për shtati atyre që qeverisin në Beograd, të cilët, për t’i eliminuar të ekziluarit e padëshiruar, jo për herë të parë përdorin mjete të tilla, e të cilët nuk druhen t’i quajnë edhe terroristë gjermanë, ngase ata janë ngatërruar me rrjetin e tyre policor. Kjo ndodhë pasi Qeveria Federale nuk ka pranuar të bëjë pazarllëqe të pandershme.

Përkundër gjithë kësaj, politikanët tanë, jo vetëm për kalkulime ekonomike, në mënyrë të përsëritur kanë proklamuar „mot të mirë“ në Beograd. Kjo ka bërë që rastet si ky i Untergruppenbach-ut të mos pengohen.

Jo vetëm siguria jonë, por edhe integriteti ynë kombëtar kërkon që Bonn-i të flasë

me jugosllavët me një gjuhë të ashpër, pa keqkuptim për fushën ekonomike, fushën e turizmit dhe fushën e marrëdhënieve diplomatike, si dhe për sektorin e pasaportave dhe vizave. Jo pak shërbime sekrete kanë vendin e tyre nëpër ambasada.

Në këtë drejtim duhet të shtrohen pyetje - dhe do të shtrohen edhe nga ata të cilët supozohet se kanë marrë një copë mësimi nga brutaliteti politik i përjetuar para dyerve të shtëpive të tyre. (Heilbronner Stimme, 19 janar 1982)

7. TERROR POLITIK

Një dëshmitar kishte vëzhguar vrasësit (gazeta e Stuttgartit)

Dy plumba ishin në gjoksin e tij. Jusuf Gervalla (36) kishte gjakderdhje të madhe. Ai gjendej i shtrirë në një batanije, në rrugën e mbuluar me borë "Auf der Habichthöhe" në Untergrupenbaeh. Ai mundi t`i thoshte policisë, se përgjegjës për sulmin vrastar ishte UDB-eja. Të dielën mbrëma, rreth arës 22,15 h, u dëgjuan shumë të shtëna në lagjën e re. Plumbat kishin shpuar dritaren e djathtë anësore të BMW -së 316, ngjyrë të gjelbër dhe vranë në vend Bardhoshin (31) vëllaun e Jusufit dhe Kadri Zeken (28). Një mësues e kishte vëzhguar atentatin: "Unë dola në ballkon, që të thith pak ajër të pastër. I pashë tre jugosllavët (vëllezërit Gërvalla dhe Kadriun) duke dalë nga garazha me BMW-në e tyre, duke vozitur nga prapa shpejt, rreth nja 40 m. deri në udhëkryqin e afërm. Kështu bënin ata gjithnjë. Kur vetura u ndal tek drita e rrugës, nga punishtja e afërme doli një mashkull dhe iu aftua veturës. Pastaj i dëgjova 5-8 të shtëna. Vetura lëvizi përpara me shpejtësi dhe u përplas për derën e një garazhi. Ai që qëlloi dhe një mashkull tjetër me shpejtësi u larguan nga vendi i krimit." Vëllezërit Bardhosh dhe Jusuf Gervalla, jetonin me gratë e tyre dhe pesë fëmijët në shtëpinë familjare në "Habiehtshöehe". Këta burra luftonin kundër rrethanave politike në Kosovë, në vendin që ndodhet në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në këtë shtëpi, si duket, ishte redaksia e gazetës "Zëri i Kosoves". Të shtunën në mbrëmje, erdhi nga Zürihu në Untergrupenbaeh Kadri Zeka, i cili ka të ngjarë të ishte kryeredaktor i kësaj reviste. Një zyrtar i policisë thotë kështu: Ata të tre donin të shkonin në kabinën telefonike, sepse në shtëpinë ku banonin nuk kishte telefon. Krejt kjo vepër kriminale, duket se ishte një ekzekutim. Rreth orës tre të natës, pas një operacioni urgjent Jusuf Gërvalla vdiq në spitalin e Heilbronn-it. Policia: "Dyshohet se arma me të cilën u krye krimi ishte një automatik i kalibrit 7,65 mm." Angazhimi i zgjëruar për kapjen e kriminelëve mbeti pa rezultat. (Nga gjermanishtja: Tefik Ramadani-Qarri)

8. TRE TË VDEKUR NË ATENTAT NË UNTERGRUPPENBACH JUGOSLLAVËT E EKZILUAR U VRANË NË VETURË

Viktimat kërkonin Kosovën e pavarur / I vrari akuzoi shërbimin sekret

Nga anëtari ynë i Redaksisë: Uwe Jacobi (Heilbrnner Stimme, 19 janar 1982)

Untergruppenbach: Tre jugosllavë, natën e së hënës së kaluar, u vranë në një atentat në Untergruppenbach, në qarkun e Heilbronit.

Pas daljes nga një garazh, nga njerëz të panjohur, nga prita, u vranë në veturën e tyre. Mes të vrarëve janë dy vëllezër që jetonin së bashku me familjet e

tyre në Untergruppenbach, dhe një bashkëvendës i tyre nga Zvicra. Motivi i vrasjes, sipas Prokurorisë së Heilbronn-it dhe Shërbimit Kriminalistik të Vendit, supozohet të jetë me prapavijë politike, pasi tri viktimat kanë qenë kundër Jugosllavisë dhe janë angazhuar për pavarësinë e atdheut të tyre- Kosovës, krahinës jugore të Jugosllavisë. Njëra nga viktimat, që fillimisht e kishte mbijetuar sulmin me armë zjarri, para se të vdiste akuzoi Shërbimin Sekret Jugosllav „UDBA“, duke thënë se ajo është përgjegjëse për vrasjen. Policia dje ftoi popullin që ta ndihmojë në gjetjen e fajtorëve.

Menjëherë pas sulmit me armë zjarri, që ndodhi rreth orës 22.15 në Habichthöhe në Untergruppenbach, dëshmitarët vërejtën dy persona duke ikur në këmbë. Aksioni i madh i policisë për kapjen e tyre derisa u mbyll gazeta ishte i pasuksesshëm. Për këtë vrasje me sa duket të bazuar mbi motive politike, hetimet e mëtutjeshme i mori përsipër një komision i veçantë i Shërbimit Kriminalistik të Vendit.

Të dy vëllezërit, Jusuf (36) dhe Bardhosh Gërvalla (31), të cilët u vranë në sulm, nga gushti i vitit 1980 së bashku me familjet e tyre, me dy dhe tre fëmijë, jetonin si refugjatë politikë në një shtëpi në Habichthohe – 40 në Untregruppenbach. Viktima e tretë ishte 28-vjeçar, reporter i radios dhe televizionit, Kadri Zeka, i cili të dielën rreth orës 3 kishte ardhur nga Zvicra te bashkëvendësit e tij në Untergruppenbach.

Sipas njohurive të zyrtarëve të sigurimit, që të tre jugosllavët e ekziluar të përkatësisë shqiptare, për shkak të qëndrimit të tyre politik në Kosovë ishin arratisur dhe ishin bashkuar për një Kosovë të pavarur.

Zyrtarët jugosllave i fajësuan dy vëllezërit Gërvalla si anëtarë të udhëheqjes së një organizate kundërjugosllave.

„E jap jetën time për çështjen!“, ka thënë Jusuf Gërvalla shkurt, sipas një dëshmitari. 36-vjeçari ishte gazetar dhe redaktor i gazetës autoritative “Zëri i Kosovës”, e ndaluar në Jugosllavi, për të cilën punonte në Untergruppenbach, në Republikën Federale.

Vëllai i tij më i ri, Bardhosh Gërvalla, së fundi ishte punëtor social në territorin e Ludwigsburg-ut, dhe përkujdesej për punëtorët sezonalë shqiptarë dhe jugosllavë. Për viktimën e tretë të vrarë në sulm, dihet se ishte reporter i radios dhe televizionit dhe jetonte në Zvicër si refugjat politik. Nga krahina jugosllave-jugore e Kosovës, ku vitin e kaluar ka pasur shpesh trazira, është kryer atentati në Untergruppenbach. Krahina Autonome, në kuadër të Republikës së Serbisë, është e banuar kryesisht me shqiptarë myslimanë. „Amsfeld“ me vulë orientale, e përkthyer nga “Kosovë”, që më parë i takonte Turqisë, në vitin 1913 e ndajnë Serbia dhe Mali i Zi mes veti, dhe pas formimit të Jugosllavisë e tëra shkon nën Serbinë. Vëllezërit Gërvalla në qarqet e brendshme njiheshin si mbështetës fanatikë të mendimit për një Kosovë të pavarur, e cila nuk duhet t’i takojë as Jugosllavisë e as Shqipërisë fqinje. Në lidhje me këtë dihet se në hapësirën e madhe Heilbronn / Shtutgart së paku jetojnë 2000 banorë nga Kosova, si refugjatë, por edhe ilegalë.

Deputeti i parlamentit të Heilbronit, Ulrich Stechele, në lidhje me atentatin në Untergruppenbach dje ka përsëritur kërkesën e tij për ashpërsimin e praktikave dëbuese kundrejt atyre që janë në kundërshtim me kushtetutën.

Përmes kësaj qasjeje ai konfirmoi dyshimin e tij se Heilbroni gjithnjë e më shumë po bëhet qendër rajonale potenciale e dhunës politike të të huajve. Sipas mendimit të tij, dëbimi i të hujave duhet të filloj që me shkarravitjen e mureve posaçërisht me përmbajtje politike. (shih faqen 3, si dhe “Statdt – und Landkreis Heilbronn”) (Heilbronner Stimme, 19 janar 1982)

9. U VRANË TRE EMIGRANTË JUGOSLLAVË

(Përgatitën Xhafer Leci e Kadri Mani-Osmani)

(Stuttgarter Zeitung- Gazeta e Stuttgart-it ,19 janar 1982)

Nga anëtari i redaksisë sonë Untergruppenbach, rrethi i Heilbronn-it

Në Untergruppenbach, afër Heilbronn-it - shërbimi sekret jugosllav përgjegjës? Në një atentat, me siguri të motivuar politikisht, në natën e së hënës, në Untergruppenbach, afër Heilbronn-it janë qëlluar për vdekje tre jugosllavë që jetonin në egzil. Kur diku rreth orës 22, 15 h, tre të huajt nga një shtëpi në Untergrupenbach, deshën të largohen me automobil, për në vendbanimin e afërm për të telefonuar, janë qëlluar me armë zjarri nga persona të panjohur. Dy udhëtarë vdiqën në vend, ndersa i treti vdiq disa orë më vonë në spital, i cili arriti të thotë se përgjegjës për vrasjen është shërbimi sekret jugosllav. Të tre të vrarët ishin jugosllavë, me prejardhje shqiptare, të cilët angazhoheshin për pavarësinë e Kosovës, provincë kjo e shqetësuar në kufi me Shqipërinë. Vrasësit janë zhdukur pa gjurmë. Dëshmitarët duket të kenë parë, menjëherë pas atentatit, dy meshkuj duke ikur. Sipas njoftimit të shërbimit shtetëror për kriminalistikë në Stuttgart, bëhet fjalë për viktima nga Jugosllavia që jetonin në egzil. Fjala është për Bardhosh Gërvallën (31), vëllain e tij Jusufin (36) dhe gazetarin e radios Kadri Zekën (28), që jetonte në Zvicër. Ata nga fillimi i vitit të kaluar, banonin në një shtëpi në Untergruppenbach, përafërsisht 40 m. nga dera e garazhit, janë qëlluar me armë dhe në vend kanë mbetur të vrarë, vozitësi dhe personi afër tij, ndërsa Jusufi që ishte i ulur në karrigën e prapme, ishte i qëlluar rëndë në pjesën e epërme të trupit, vdes në mëngjës në spita1. Gërvalla, sikur vëllau i tij, jetonte si refugjat politik në Gjermani nga viii 1979. Qeveria jugosllave i kishte akuzuar të dy vëllazërit se janë pjesëtarë të një organizate që vepronte kundër shtetit jugosllav.

Jusuf Gërvalla ishte cilësuar udhëheqësi kryesor i kësaj organizate. Sipas një njoftimi të policisë, Kadriu jetonte në Zvicër, ku kishte marrë strehim politik. Bardhoshi punonte si punëtor social, në AWO-në e Ludwigsburgut. Policia fare nuk ka njohuri për kryesit e këtij krimi. Në vendin e krimit nuk janë gjetur armë. Dy meshkujt që janë parë nga dëshmitarët kanë ikur këmbë nga vendi i krimit. Gjithashtu, policia nuk e di se sa herë kanë qëlluar vrasësit. Jusuf Gervalla, që ishte i lënduar rëndë, ishte goditur nga dy plumba në pjesën e epërme të trupit. Baden Würtemberg gjithnjë ishte fushë e parapëlqyer për konfliktin në mes të refugjatëve kroatë dhe shtetit jugosllav. Deri tash sulmoheshin kryesisht refugjatët konservativë kroatë, kësaj radhe janë goditur papritmas, kundërshtarët e shtetit jugosllav. Për atentatet e deritashme mbi diplomatët jugosllavë, si të akuzuar paraprakisht ishin pjesëtarët e Këshillit Nacional Kroat, organizatë kjo që në vitet e kaluara e kishte përqëndruar aktivitetin në Stuttgart, në Mannheim, në Karlsruhe në rrethinën e Freiburgut, Lörachit, Offenburgut, si dhe në liqenin e Bodense-së. Qëllimi kryesor i organizatës ishte krijimi i shtetit të pavarur kroat, edhepse në të kaluarën brenda organizatës kishte konflikte të ashpra rreth asaj se a duhet ky të jetë një shtet i organizuar në baza socialiste apo të një demokracie parlamentare. Herën e fundit KNK-së i është dëgjuar zëri, atëherë kur Jugosllavia kishte kërkuar dorëzimin e tetë kroatëve, në shkëmbim të katër terroristëve gjermanë. Atëherë u organizuan disa protesta nga KNK-ja kundër kërkesave të qeverisë jugosllave, të cilat qeveria gjermane nuk i përfilli.

(Nga gjermanishtja: Tefik Ramadani-Qarri)

10. ATENTATORËT NË UNTERGRUPPENBACH ISHIN „PROFESIONISTË“

A ishte i përfshirë Shërbimi Sekret Jugosllav?

Shpërblimi prej 10. 000 markash / Kryeministri Späth dënoi „aktin e tmerrshëm“
Nga anëtari ynë i Redaksisë: Uwe Jacobi (Heilbronner Stimme, 20 janar 1982)

Vrasja e tre mërgimtarëve jugosllavë në Untergruppenbach deri më tani ishte një nga atentatet më të rënda kundër të huajve në Baden – Württemberg. Sipas Entit Kriminalistik të Vendit, në mbledhjen për siguri u tha se vrasësit e panjohur deri më tani janë „vrasës profesionistë“. Udhëheqësi i Komisionit të Veçantë, Sambeth, theksoi se 36-vjeçari Jusuf Gërvalla, pak para se të vdiste u shpreh se përgjegjës për vrasjen është Shërbimi Sekret Jugosllav, UDB-a. Në pyetjen e HSt, tha: “Ne jemi skeptik, por mundësia ekziston!” Për të dhënat që çojnë deri te zbulimi i vrasësve, prokuroria e Heilbronit ka ofruar shpërblimin prej 10.000 markash. Kryeministri Lother Späth paralajmëron ekstremistët e huaj se nga grindjet e tyre „këtu, tek ne në Gjermani, po bartet dhuna“. Në anën tjetër, para konsullit të përgjithshëm jugosllav në Shtutgart, ai shpreh „shqetësimin mbi zhvillimet e tilla në aspektin e marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Baden – Württemberg-ut“.

Me përpjekjen e 35 „zyrtarëve të policisë kriminale”, Komisioni i Veçantë në Untergruppenbach përpiqet t’i gjejë atentatorët nga Habichthohe. Tre mërgimtarë jugosllavë, në moshë prej 28 deri në 36 vite, dy prej tyre vëllezër që jetonin me familje në Untergruppenbach, u vranë në veturën e tyre, natën para së hënës, në ora 22:15, në automobilin e tyre, duke dalë nga një garazh. Dyshimi se vrasja rrjedh nga motive politike në ndërkohë është përforcuar.

Sipas të dhënave të deritashme, fjala është për së paku 2 burra që afër garazhit kanë pritur viktimat e tyre. „Gjuajtësit profesionistë“ përdorën dy revole të kalibrit 7.65 mm dhe zbrazën së paku 12 plumba. Bardhosh Gërvalla, 31-vjeçar, punëtor social, i goditur nga gjashtë plumba, mbeti i vdekur në ulësen e shoferit. Gjithashtu, 28-vjeçari Kadri Zeka, reporter i Radios, i ulur pranë shoferit, vdes në vend, i goditur nga dy plumba. Jusuf Gërvalla, 36-vjeç, që ndodhej i ulur prapa, i shpëtoi breshërisë së parë, por vdes pastaj në të njëjtën natë nga pasojat e plagëve prej dy plumbave. Në përgjithësi, 10 nga 12 plumba i kanë goditur viktimat, në zemër, qafë dhe mushkëri.

Akuzat e Jusuf Gërvallës para se të vdiste, se „vrasësit“ i kishte dërguar Shërbimi Sekret Jugosllav, ende janë të pasqaruara. Përgjegjësi i Komisionit të Veçantë të Entit Kriminalistik të Vendit thotë: „Ne po hetojmë në të gjitha drejtimet“. Kryeprokurori i Heilbronn-it, Herwig Mainz, thotë: „Kjo ose duhet të vërtetohet, ose të demantohet“.

Të gjitha shenjat flasin për këtë, si e formulon një zëdhënës i prokurorisë. "Përfundimisht e tëra duhet të ketë prapavijë politike“. S’ka kurrfarë pikëmbështetje se „marrëdhëniet private dhe jopolitike“ të kenë çuar deri te vrasja. Prapavija politike shihet edhe nga ajo se tri viktimat ishin refugjatë politikë, nënshtetas jugosllavë, me prejardhje shqiptare. Nga Republika Federale Gjermane ata përpiqeshin që atdheu i tyre, krahina e Kosovës, që gjendet në jug të shtetit jugosllav, të shndërrohet në një republikë të pavarur në kuadër të Jugosllavisë. Lidhur me motivin e vrasjes së tri viktimave, të cilët gjatë natës u vranë në veturë, në ndërkohë ka më shumë sqarime. Fillimisht thuhej se dëshironin të telefononin në vendbanimin e afërt Donnbronn, pasi që në shtëpinë e Gërvallajve, në Habichthohe 40, nuk kishte lidhje telefonike. Është e paqartë se pse ata nuk deshën ta përdornin telefonin që gjendej shumë më afër, pranë supermarketit, kur dihej se telefoni në Donnbroner s’kishte lidhje me botën e jashtme.

Një bisedë me të afërmit e të vrarëve solli dritë në këtë çështje misterioze. Të tretë, sipas të dhënave të para, dëshironin të shkonin në një kabinë krejt tjetër, që kishte qasje me botën e jashtme. Arsyetimi: Kadri Zeka, i cili kishte ardhur nga Zvicra në Untergruppenbach të shtunën në mbrëmje dhe duhej të kthehej të dielën në mbrëmje për Cyrih të Zvicrës, dëshiroi ta lajmërojë familjen se treni me të cilin duhej të kthehej i kishte ikur.

Të shtënat vdekjeprurëse, që u shkrehën para kësaj thirrjeje, dje e vunë në lëvizje edhe Këshillin e Ministrave të Baden-Württemberg-ut. Kryeministri Lother Späth dënon vrasësit „në formë të rreptë dhe me neveri".

Nëse ekstremistët e huaj, me grindjet e tyre „këtu tek ne në Gjermani e bartin dhunën" kjo do të ishte një gjendje e padurueshme. Qeveria e Vendit me mjete dhe mënyra të ndryshme do të luftojë zhvillimin e dukurive të tilla. "Akti i tmerrshëm nga Untergruppenbach", thotë me keqardhje Späth, "është gjithashtu dukuri që mund të çojë deri te futja e një pyke mosbesimi në mes të qytetarëve gjermanë dhe të huaj, ku kjo do të vë në pyetje përpjekjet për integrimin e gjeneratës së dytë të të huajve".

Kryeministri i paralajmëroi "ato forca që janë të gatshme që përmes veprimeve të dhunshme, pa kurrfarë konsiderate për bashkatdhetarët e tyre, ta prishin paqen dhe miqësinë në mes njeri-tjetrit". Nga autoritet hetimore u ripërsërit ftesa drejtuar popullit për të ndihmuar që atentati në Untergruppenbach të sqarohet.

Informatat pranohen nga „Komisioni i Veçantë në Untergruppenbach", telefoni me numër (071 31/104 21 79), ose në çdo stacion tjetër policor. Është vendosur edhe një numër telefoni i besueshëm: (071 31/ 104 21 23). („Heilbronner Stimme", 20 janar 1982)

11. DHUNA

(Bild Zeitung-Gazeta ditore, 20 janar 1982)
(Përgatitën Xhafer Leci e Kadri Mani-Osmani)

Vrasja e tre refugjatëve jugosllavë në Heilbronn, të rikujton analizën e ministrit te brendeshëm Baum, të paraqitur në opinion në mënyrë shqetësuese në fund të verës së kaluar, në të cilën bëhej fjalë për një rritje të dukshme të terrorit shtetëror në Republikën Federale të Gjermanisë. Se a bën pjesë vrasja e trefishtë në këtë kategori, është ende çështje e hapur. Njëri prej viktimave, pak para vdekjes për atentatin e ka bërë përgjegjës shërbimin sekret jugosllav (UDB-en).Hedhja e fajit nga njëra palë tek tjetra, në mes të përfaqësuesve zyrtarë të shtetit jugosllav dhe organizatave ekstremiste të refugjatëve Jugosllavë për vrasje dhe terror, është pjesë e repertoarit tanimë të njohur. Sipas përvojës së deritanishme, kjo nuk është vetëm "propagandë tmerri", sepse që disa vjet, vazhdimisht ndodhin sulme misterioze dhune me viktima nga të dyja anët. Nga e gjithë kjo, ka një dallim. Nuk është njësoj, kur një organizatë terroriste e refugjatëve jugosllavë e vret një diplomat jugosllav, sikur atëherë kur shteti jugosllav, nëpërmjet shërbimit të tij sekret, në mes të territorit gjerman, praktikon sulmet vdekjeprëuse dhe vrasjet. Për ne është e papranueshme që shërbimet e huaja sekrete të dërgojnë vrasës tek ne. Kjo vlen njësoj, sikur për revolverashët e shërbimit sekret të Shahut, ashtu sikur për figurn e errtë të Gadafit dhe vlen, natyrisht edhe për ekzekutorët e Beogradit.

(Nga gjermanishtja: Tefik Ramadani-Qarri)

12. DORA E GJATË E BEOGRADIT SHTRIHET DERI NË REPUBLIKËN FEDERALE

Heilbronner Nachrichten- Lajmet e Heilbronn-it, 21 janar 1982)
Korrespondenti ynë: Horst Zimmermann

Edhe përkundër marrëveshjes komandotë vrasëse godasin sërish në mënyrë të përgjakshme
BONN/ HEILBRONN

Nga Pas vrasjes së tre refugjatëve jugosllavë në Untergruppenbach afër Heilbronit, shtohen dyshimet te organet gjermane të sigurimit se shërbimi sekret jugosllav (UDB-ja), angazhon sërish forca të shtuara të agjentëve vrasës në Gjermani, kundër refugjatëve ekstremistë jugosllavë, që jetojnë në egzil. Marrëveshja e fshehtë e arritur në mes të ministrit të brendshëm federal Baum, pranverën e kaluar dhe kolegut të tij nga Beogradi, Franjo Herleviq, është e pavlefshme, sepse Beogradi nuk po i përmbahet. Z. Baumi ia kishte bërë të qartë Herleviqit se veprimi i komandove vrasës të Beogradit në territorin e Republikës Federale nuk mund të tolerohet më (më gjatë).

Herleviqi la të kuptohet që Beogradi do të përmbahet nga marrja e masave vetjake për mbrojtje kundër aksioneve terroriste të refugjatëve jugosllavë, nëse organet gjermane janë në gjendje t`i marrin nën kontroll organizatat radikale të refugjatëve jugosllavë. Në kuadër të marrëveshjes së arritur, ishin zotuar për të marrë masa të rrepta të mbikëqyrjes për rreth 1600 refugjatë jugosllavë që konsideroheshin si ekstremistë, që nga ndalimi i marrjes me veprimtari politike e deri te kufizimi i qarkullimit.

Gjithashtu personat e cilësuar si posaçërisht të rrezikshëm, u vunë nën mbikëqyrjen e policisë. Menjeherë pas takimit Baum-Herleviq, u pa qartë se Beogradi në asnjë mënyrë nuk dëshironte t`i përmbahej marrëveshjes. Më 14 maj të vitit të kaluar në Frankfurt u qëllua Rasim Zenelaj (33), refugjat me prejardhje kombëtare shqiptare nga krahina e shqetësuar e Kosoves dhe për pasojë mbeti invalid i përjeteshëm.

Njëzet e katër vjeçarja Zorica Aleksiq, e ka pranuar se kishte qëlluar me armë, me urdhër të shërbimit sekret-UDB-së. Që në mesin e vitit të kaluar, u panë shenjat e ashpërsimit të raporteve të ndërsjella. Organizatat e refugjatëve jugosllavë grumbullonin në sasi të mëdha armë dhe mjete shpërthyese.

Baum njoftonte për shenjat e shtimit të dukshëm të sulmeve të terrorit shtetëror. Konflikti i ndërsjellë në mes të organizatave të refugjatëve jugosllavë dhe shërbimit sekret (UDB-a), në këto 20 vjetët e shkuara, ka lënë gjurmë të gjata gjaku në Gjermani. Policia ka numëruar deri tash rreth 20 kufoma nga të dy palët.

Që nga Igo Kühe këtu vlen motoja nga testamenti i vjetër "dhëmb për dhëmb, sy për sy". Njëherë shkojnë bombat paketë në Zagreb ose në trenin e shpejtë "Helas-ekspres", herën tjetër noton një kufomë e një refugjati në Rajnë. Pas atentateve dhe sulmeve kundër punëtorit të konzullatës në Stuttgart, Milovanoviç, ose vicekonsullit, Topiq në Düseldorf, vinin gjuajtjet me armë ndaj refugjatëve radikalë jugosllavë. Një zyrtar i sigurimit na tha "Në fshehtësi ka filluar armatosja intenzive".

Momentalisht si duket, posaçërisht të rrezikshëm, sipas organeve gjermane, janë anëtarët e grupit që grumbullohen rreth revistës "Revolucioni kroat".

(Nga gjermanishtja: Tefik Ramadani-Qarri)

13. FLAMURI SHQIPTAR NË GJYSMËSHTIZË
Pas vrasjes së trefishtë

Kritika dhe Kërkesa „Heilbronner Stimme“, 21 janar 1982

Para Shtëpisë së viktimave të Atentatit në Untergruppenbach valëvitej në gjysmështizë flamuri kombëtar i Kosovës dhe i Shqipërisë. Te të vejat dhe 5 fëmijët pa babë janë gjendur numër i madh shqiptarësh jugosllavë nga Baden-Württemberg-u. Në një bisedë për HSt (“Heilbroner Stime”, vër. ime) dje janë bërë kritika dhe kërkesa kundër qeverisë së Beogradit.

Krahina Autonome e Kosovës gjendet në jug të Jugosllavisë, në kufi me Shqipërinë, i përket Republikës së Serbisë dhe ka gati 2 milionë banorë, nga të cilët 85% janë shqiptarë. Parasëgjithash, nga viti i fundit ka pasur shpesh trazira të dhunshme, sepse populli shqiptar e ndjen veten të shtypur nga pushteti jugosllav.

Qëllimi i shqiptarëve të Kosovës, kështu është shprehur dje një zëdhënës në Untergruppenbach, është që Krahina e Kosovës të bëhet Republikë e pavarur në kuadër të federatës jugosllave: „Ne nuk dëshirojmë ta copëtojmë Jugosllavinë, por të jemi një Republikë më vete“. Ata e arsyetojnë këtë duke thënë se populli shqiptar është i treti me radhë, pas serbëve dhe kroatëve, për nga numri i banorëve në Jugosllavi, e cila deri tani ka gjashtë republika. Me forcë u shtypen kërkesat e tyre për Kosovën Republikë. Beogradi sundon me një pakicë të serbëve në Kosovë dhe ka frikë se e humbë autoritetin nëse dorëzohet para kërkesave të bashkëvendësve të vet shqiptarë. Përpos kësaj, Kosova është një vend i pasur me shumë pasuri natyrore si thëngjill, bakër, nikel dhe argjend. jac 21. 01. 1982

14. PAS ATENTATIT ENDE S’KA „GJURMË TË NXEHTA“
LKA (Enti Kriminalistik i Vendit) merr në pyetje të vejat

Njëzet persona kërkojnë armët e vrasjes

Lidhur me kapjen e atentatorëve pas atentatit në Untergruppenbach ende nuk ka „gjurmë të nxehta“, njoftoi dje Shërbimi i Kriminalistik i Vendit.

Njësiti komando i përbërë nga 20 zyrtarë policie, dje kontrolloi vendin afër Habichthohe, ku në natën e së hënës u vranë tre mërgimtarë jugosllavë. U kërkuan armët me të cilat u krye vrasja, dy revole të kalibrit 7.65 mm, që dyshohej se vrasësit pas atentatit mund t’i kenë hedhur. Aksioni i kërkimit u ndërpre pa sukses.

Nga populli u dhanë shumë të dhëna. Udhëheqësi i Komisionit të Veçantë, Hermann Sambeth, tha: „Ende mungojnë të dhënat vendimtare“.

Nga Shërbimi Kriminalistik i Vendit u morën dje në pyetje dy të vejat e vëllezërve Gërvalla, si dhe bashkudhëtarja e jetës e viktimës së tretë, Kadri Zekës, e cila pasi u njoftua për vrasjen, kishte ardhur nga St. Galen-i në Untergruppenbach. Për hulumtimin e mëtutjeshëm, kryeprokurori Herwig Mainz mendonte: „është vështirë dhe do kohë të sqarohet vendi i ngjarjes“. jac (Heilbronner Stimme, 22 janar 1982)

15. ATENTATI I UNTERGRUPPENBACH-UT ARRITI NË BUNDESTAG

Funerali për viktimat

(Heilbronner Stimme, 22 janar 1982)

Pyetja e Sporit: A ishte përgjegjës Shërbimi Sekret Jugosllav UDB-a?

Atentati në Untergruppenbach, në të cilin ranë viktimë tre mërgimtarë jugosllavë, në mbledhjen plenare javën e ardhshme, me iniciativën e parlamentarit Spöri, do të diskutohet në Bundestag. Dje, në shtëpinë e të vrarëve në Untergruppenbach, pasi prokuroria ua dorëzoi kufomat familjeve të tyre, iu bënë homazhe viktimave.

Me dy pyetje lidhur me vrasjen e trefishtë në Untergruppenbach, iu drejtua gojarisht. Qeverisë Federative anëtari i SDP (Partia Socialdemokrate) Dr. Dieter Spöri: „A është përgjegjës Shërbimi Sekret Jugosllav (UDB) për vrasjen e tre mërgimtarëve jugosllavë në Untergruppenbach te Heilbroni, dhe deri në çfarë mase kanë arritur deri tani përleshjet e dhunshme mes grupeve rivale jugosllave, si dhe çfarë hapash ka bërë qeveria federale për t'i kundërshtuar këto zhvillime? "

Në lidhje me këto çështje, Spöri theksoi se në prapaskenë të gjakderdhjes në Untergruppenbach ka ndodhur intensifikimit i veprimeve të shërbimit sekret jugosllav në truallin gjerman, që Beogradi ka angazhuar kundër organizatave armiqësore dhe aktiviteteve të tyre.

Republika Federale nuk mund të pranojë që armiqësia në mes të ilegales së mërgimtarëve jugosllavë nga njëra anë dhe Shërbimit Sekret Jugosllav në anën tjetër, të degjenerojë në një „masakër të hapët". Rasti në Untergruppenbach ishte kulmi i një serie të tërë sulmesh dhe atentatesh, me të cilat Jugosllavia përgjakshëm e ka injoruar rendin juridik të Republikës Federale. Gjatë kohës për parashtrimin e pyetjeve, qeveria duhet të sqarojë se çka ka ndërmarrë konkretisht për secilin rast deri më tani dhe çka ka ndërmend të bëjë. Mbi gjendjen e hetimeve „Komisioni i Veçantë Untergruppenbach" dje theu heshtjen. Në një pyetje, ai tha se „do të zhvillohen hetime në të gjitha drejtimet". Gjer tani nuk ka pasur arrestime: „Ndoshta nesër mund të themi diçka më shumë", tha udhëheqësi i „SOKO"-os (Sonderkommission – Komisioni i Veçantë vërejtje ime). Dje, në Habichthohe 40 në Untergruppenbach, në ndërtesën ku jetonin vëllezërit Gërvalla, tanimë të vrarë, u bënë nderime për viktimat e atentatit. Për këtë orë nderimi, Prokuroria e Heilbronn-it ua dorëzoi familjeve të tyre arkivolet me trupa të viktimave.

Momentalisht mbretëron një paqartësi se ku do të bëhet varrimi. Të afërmit dhe rrethi i shokëve të viktimave dëshirojnë që varrimi të bëhet në Krahinën e Kosovës, në Jugosllavinë jugore, ku këta gjatë kohës sa ishin gjallë u përpoqën që krahinën e Kosovës ta bëjnë Republikë të pavarur. Nga qeveria jugosllave ende nuk ka përgjigje. Nëse Beogradi nuk lejon bartjen e tyre në Jugosllavi, atëherë varrimi do të bëhet të shtunën në Shtutgart. jac (Heilbronner Stimme, 22 janar 1982)

16. E TËRA DUKEJ SI PAS NJË EKZEKUTIMI

Der Spiegel, 25 janar 1982

Vrasës të panjohur i vranë në afërsi të Heilbronnit tre jugosllavë. Për autoritetet shtetërore gjermane kjo masakër është kulminacion i ri në luftën e fshehtë, në të cilën agjentë të sigurimit jugosllavë dhe kundershtarë të pushtetit luftojnë mes tyre. Pas kroatëve në ekzil si duket qeveria e Beogradit u ka shpallur luftë të përgjakshme shqiptarëve në ekzil që vijnë nga Republika e Kosovës.

“BMW”-ja e gjelbërt 316 dilte nga garazha. Shoferi nuk donte ta kthente veturën në borë dhe vazhdon të vozisë deri te udhëkryqi duke vozitur së prapthi diku rreth 40 metra. Kur ndalet vetura del një njeri nga një vend ndërtimi në anën e djathtë të veturës dhe gjuan nga një distancë 3m. në veturë. Një njeri i dytë gjuan gjithashtu dhe shikon pastaj në veturë për t`u bindur se a ia kanë arritur qëllimit. Fqinj të frikësuar nga krismat i shohin dy burra duke ikur.

Ishte shqetsuese ajo që kanë parë banuesit e komunës së "Untergruppenbach"-ut te Heilbronni: Vetura vazhdonte të uturinte sepse shoferi e kishte këmbën ende në pedalen e gasit. Pastaj ai e lëshon si duket freksionin dhe vdes. Kështu që vetura vazhdon të ecën deri sa i mëshon një garazhe përballë. Vetura ndalet, motori fiket dhe mjedisi qetësohet.

Policia ka gjetur në veturë: Shoferin Bardhosh Gërvalla, 31 vjeq, jugosllav, i goditur nga 6 plumba, qëndronte i vdekur pas timonit, Bashkudhëtarin e tij, Kadri Zekën, 28 vjeç, i vrarë nga 2 goditje me plumba në trup, dhe Vëllain e shoferit, Jusuf Gërvallën, 36 vjeç, gjithashtu i plagosur rëndë nga 2 goditje me plumba.

Tri viktimat u identifikuan shpejt dhe gjithashtu shpejt u dit edhe drejtimi i tyre politik: jugoslavë në ekzil që i takonin kombësisë shqiptare nga provinca e Kosovës në jug të shtetit ballkanik, dhe që të tre veprimtarë kundër qeverisë së Beogradit. Edhe për autorët e vrasjes pati shënime.

Në vendin e ngjarjes Jusuf Gërvalla, i cili më vonë vdes, i kishte pështpëritur policisë: "Ka qenë UDB-ja"- policia sekrete jugosllave (Sluzba Drzavne Bezbednosti). Dymbëdhjetë herë ishte gjuajtur mbi të tre burrat nga pistoleta të kalibrit 7,65, dhjetë goditje kishin qëlluar zemrën, mushkëritë dhe qafën.

Një polic në vendin e ngjarjes thotë: "E tëra dukej si pas një ekzekutimi". Është metodë që përdoret nga shërbimi sekret, siç thotë snajperisti dhe instruktori i policisë nga Stuttgarti Siegfried Hübner - duhet qëlluar me katër plumba "tre për ta mbërthyer viktimën nëse ajo qëndron ende, pra për ta rrëzuar dhe për ta bërë të paaftë për kundërvënie, dhe pastaj rigjuajtja e katërt e domosdoshme dhe vdekjepruese". Edhe kjo flet për UDB-në."

Qe shumë vjet grinden shërbimi sekret jugosllav dhe kundërshtarët e regjimit në botën e jashtme. Në shumë raste, jugosllavët në ekzil i kanë sulmuar ambasadat, konsullatat dhe përfaqësuesit e qeverisë së tyre. Beogradi reagonte në krim dhe terror gjithmonë me të njëjtën mënyrë. Skenë e Shoot-out-it ballkanik ka qenë kohë pas kohe Republika Federale e Gjermanisë dhe policia ka qenë deri më tash e pafuqishme për t`i dhënë fund kësaj veprimtarie. Ndërsa përgjegjësit janë dal në shesh. Beogradi ua ka frikën grupeve në ekzil, të cilat janë vatër trazirash në shtetin shumënacional - dhe i lufton ato. Sidomos kroatëve që janë jashtë ua kanë drejtuar pistoletat vrasësit e shërbimit sekret. Në shumë raste krimesh kundër kroatëve në ekzil është dëshmuar pjesëmarrja e Beogradit. Për shembull: Kur shkëputet kroati Franjo Goreta nga shërbimi sekret jugosllav me detyrë për vrasje në Republikën Federale Gjermane dhe e vranë një oficer udhëheqës, Beogradi e nis një komando menjëherë për ta likuiduar atë. Ende se kishte kryer dënimin Goreta , kur njerëz të UDB-së ndërmorën një atentat, në të cilin Goreta shpëtoi për pak.

Në procesin e këtij akti gjyqtari dërgoi një apel deri më tash të kotë drejt Bon-it. "Nuk mund të lejohet që në vendin tonë të kryhen vrasje të shteteve të huaja për t`i zgjidhur problemet e tyre të brendshme". Krahas kroatëve tashmë në shënjestër të shtetit jugosllav janë edhe shqiptarët. Që nga pranvera e fundit kur shqiptarët rezistuan në provincën jugosllave në Kosovë, ku u bënë trazira të përgjakshme, Beogradi i ka zbuluar shkaktarët jashtë vendit: Prej shtetit shqiptar fqinj dhe prej shërbimeve besnike komuniste dirigjohet konflikti, mirëpo edhe nga Republika Federale Gjermane, siç thonë politikanët e Beogradit.

Në fakt vetëm në Baden-Württemberg jetojnë diku 2000 shqiptarë, shumica prej tyre me strehim politik. Lidhur me aktivitetet e tyre shpeshherë u ankua konsullata e përgjithshme në Stuttgart.

Për shembull, në pranverën e 1981-shit demonstruan shqiptarët në një demonstratë jo të rëndësishme, në të cilën ata kërkuan ndarjen e Kosovës nga Jugosllavia. Ndërkohë demonstruasit e diktuan se dikush nga një shkollë jugosllave po i fotografonte, hynë disa brenda dhe pos fotografistit ata e takuan edhe konsullin e përgjithshëm jugosllav Branko Dimitrijevic. Ata au morën filmin, të cilin më vonë u detyruan ta dorëzojnë në polici.

Kjo mund ta ketë lidhur një zingjir vdekjeprues, se njëri prej të cilëve kishte hyrë në atë shkollë dhe të cilin me siguri e kanë fotografuar, ishte Bardhosh Gërvalla, ngarësi i veturës, i vrarë te Heolbronni. Gërvallajt kanë qenë të njohur në skenën e jashtme. Vëllai Jusufi i cili para pak kohe i kishte dhënë një intervistë një gazete ditore, në të cilën thoshte se ishte për luftën e armatosur kundër shtetit jugosllav, ka qenë sipas njoftimeve të policisë edhe redaktor i gazetës "Zëri i Kosovës" në ekzil. Bardhosh Gërvalla kshte ardhur në Gjermani më 1974. Ai punonte si këshilltar për punëmarrësit jugosllavë, në Solitudestraße 44, në Ludwigsburg. Bardhoshi i martuar, dy fëmijë ka qenë aktiv sidomos në legjislacionin e punës për bashkëkombësit e tij.

Koka politike e vëllezërve ka qenë si duket Jusuf Gërvalla. Sidomos ai fajsohej nga konsullata e përgjithshme jugosllave të jetë antar udhëheqës i "Fronti të kuq" që luftonte kundër qeverisë jugosllave. Kjo organizatë ishte aktive, deri më tash, vetëm në Jugosllavi dhe po aq pak, si grupe të tjera kosovare u shfaqte në raportin vjetor të ministrisë federale për mbrojtjen e kushtetutës.

Jusufi, i martuar, tre fëmijë, duhet të ishte bashkëbotues i gazetës së ndaluar në Jugosllavi "Zëri i Kosovës", për të cilën ai punonte nga vendbanimi i tij. Kadriu, gjithashtu gazetar, ishte bashkëpuntor kompetent i të njëjtës revistë.

Në murin e jashtëm të shtëpisë së vëllezërve në "Auf der Habichtshöhe 40" e kishin varur, në shenj pikëllimi, një flamur në gjysmështizë të kuq me një shqiponjë dykrenare dhe një yll - ngjyrat e Kosovës dhe njëherit flamuri kombëtar i Shqipërisë.

DËSHMOHET INVOLVIMI I SHËRBIMIT SEKRET JUGOSLLAV

Çfarë rëndësie kanë aktivitetet e shqiptarëve në ekzil për Beogradin nuk e dëshmon vetëm masakra në Heilbronn. I ngjashëm ishte edhe një aksion i madh i shërbimit sekret serb në fillim të vitit, kur bashkëkombësi, Rasim Zenelaj u mor në shënjestër. Zenelaj ka qenë një antar udhëheqës i "Besëlidhjes Kombëtare Shqipëtare". Me gjuajtjet nga pistoleta në kundërshtarin e qeverisë Zenelaj, i cili e mbijetoi edhe pse i lënduar rëndë i shpëtoi atentatit, u dëshmua për herë të parë drejtimi i ri i shërbimit sekret jugosllav.

Për ta mënjanuar Zenelajn Beogradi kishte kurdisur plane të kushtueshme. Kishte nisur disa agjentë, madje kanë rrezikuar edhe dikë nga zyrtarë të konsullatës dhe kanë eksponur ndihmësit e heshtur. Megjithatë plani dështoi dhe pjesëmarrësit u zbuluan: Në procesin e nisur atë kohë kundër përgjegjësve të atentatit qartësohet edhe më shumë implikimi i zyrtarëve jugosllavë në ndjekjen e emigrantëve me metoda drastike.

Kah fundi i 70-tave ishte ngritur një agjent i mëhershëm në gradë të konsullit. Me emrin Salih Salihi ai u shfaq më vonë me shërbim diplomatik për vendin e tij në Republikën Federale Gjermane, së pari në konsullatën e përgjithshme në Hamburg dhe pastaj në konsullatën e përgjithshme në Frankfurt. Atje u vendos i pajisur me një dokument identifikimi si zyrtar me nr. 6750 në cilësinë e rojes. Në Frankfurt vepronte edhe një kolegë tjetër i shërbimit sekret, si zyrtar i lartë i konzullatës me dokument identifikimi nr. 6322, i firmuar me emrin Svetozar Mirjaqiç, i quajtur "Tozo". Një besnik

me rang të lartë i këtyre dy shërbyesve ishte Rade Surla, një partizan i hershëm, që kohët e fundit punonte në një ndërmarrje ndërtimi në Frankfurt.

Surla i vizitonte shokët e konzullatës dhe i informonte ata për veprimtaritë e njerëzve në ekzil. Njëherë, siç i kujtohet shoferit të tij, e vizitoi dikush vetë Surlan. Mysafiri kërcënues (Surla shoferit: "Duhet me ju ruejt këtij njeriu") ishte gjenerali i shërbimit sekret Milan Shashiç.

Në mars të vitit 1981, menjëherë pas shpërthimit të trazirave në Kosovë, filloi të veprojë treshi në Frankfurt. Salihi gjurmonte shprehitë e jetës së Zenelajve dhe i dërgonte Tozos informacione. Edhe Surla filloi të veprojë, kur u përfundua plani konkret i vrasjes. Disa gjurmë dhe dëshmitarë dokumentojnë se me sa përkushtim kanë vepruar agjentët.

Agjenti i parë të cilin e caktuan për Zenelajn ishte një kroat në ekzil, por ai demaskoj urdhërdhënësit nëpërmes deklaratave të tij në procesin gjygjësor. As agjenti i dytë nuk e mbajti fshehtësinë. Ante Kujundzic ishte rekrutuar nga Tozo si vrasës, kur iu hap shokëve të tij kroatë në ekzil. Së shpejti policia gjermane i dinte hollësitë e përgatitjeve për atentat.

Organet gjermane nuk kishin vepruar në mënyrë të kujdesshme. Kroatit Ante Kujundzic i kishte folur një bashkëkombas i panjohur në prill të vitit 1981, në stacionin e trenit në Frankfurt. I kishte thënë me e thirrë një "person me rëndësi" dhe t'i paraqitet me emrin "Studenti i muzikës". Pastaj i kishte dhënë një numër të telefonit - 21 77 01 - dhe e kishte udhëzuar që kur të thirrte secilën shifër ta mbledhte me numrin dy.

Në lidhjen telefonike 43 99 23 ishte lajmëruar konsullata e përgjithshme jugosllave. Kështu ishte vendosur kontakti me Tozo-n. Kujundzic-in e kishin urdhëruar për ta gjurmuar shqiptarin Zenelaj. Si shpërblim atij Tozo i ofronte para, dokumente të reja dhe përkrahje për ta fituar azilin politik në Republikën Federale Gjermane.

Në një takim tjetër Tozo ia dha një pasaport, për çdo rast, nëse duhej ta lëshonte vendin shpejt. Kujundzic: "E pata të kjartë se me siguri duhej ta vrisja dikë". Agjenti hoqi dorë nga ky plan dhe i informoi autoritetet gjermane. Si rrjedhim, policia e mori në mbrojtje të rrezikuarin Zenelaj.

Për t`ua treguar komplotistëve këtë, policët gjermanë e dërguan Zenelajn demonstrativisht për të shëtitur para konsullatës jugosllave. Një herë tjetër duke shëtitur në një kopsht zoologjik, Zenelajn me përcjellësit e tij e vëzhgonin agjentët jugosllavë dhe kështu ata u vërejtën edhe njëherë nga gjermanët. Zenelaj ra në rrezik me mendjelehtësinë e vet: Ai kishte treguar në rrethin shoqëror se ishte i mbrojtur dyfish, d.m.th. edhe me një jelek antiplumb. Njëri që e kishte dëgjuar këtë ishte nën shërbimin e Surla-s. Kështu jugosllavët e planifikuan një plan, që kundërshtarin e tyre ta manovronin në një situatë, që ai të detyrohet ta zdesh jelekun e tij antiplumb. Një grua duhej ta kryente këtë punë dhe pastaj ta godiste me pistoletë.

Si ndihmëse u gjet shpejt bjondina serbe Zorica Aleksic. Ajo jetonte pa të ardhura dhe pa punë në afërsi të Darmstadt-it. Nëpërmjet kërcënimeve si dhe nëpërmjet premtimit se do t`ia japin 2000 DM e bindën atë. Ishte aranzhuar një takim me gruan dhe viktimën e saj. Rasim Zenelaj e kishte marrë agjenten në apartamentin e tij. Kur doli gruaja me pistoletë nga banja, Zenelaj e kishte zdeshur jelekun antiplumb. Prej pesë goditjeve në afërsi të zemrës, Zenelaj falimentoi. Autorja kishte ikur dhe në hyrjen e shtëpisë e kishin pritur Surla me shoferin e tij. Zorica Aleksic ua kishte kthyer armën dhe i kishte marrë paratë bashkë me një tiketë për Beograd. Me një Volvo ishin nisur menjëherë për në aeroportin e Frankfurt-it. Mirëpo serbja nuk mundi ta lëshonte vendin. Fqinjtë, e alarmuar nga krismat, i kishin lajmëruar policinë menjëherë. Rastësisht e kishin dëgjuar këtë lajm në radiolidhje edhe policët të cilët ishin të ngarkuar me mbrojtjen e Zenelajt. Një gjurmim i shpejtë në rrethin shoqëror të viktimës i çoi policët te Zorica, e cila pak më vonë u arrestua në aeroport.

Zyrtarët e konsullatës Tozo dhe Salihi janë urdhëruar të kthehen në Jugosllavi. Surla mundi të ikte që në ditën e atentatit. Surla u paralajmërua me anë të telefonit dhe ishte përgjigjur: "në rregull". Pastaj shoferi, i cili ishte dëshmitar i kësaj telefonate, e kishte dërguar me ngut përtej kufirit, në Strasburg në hotelin Holiday Inn. Aty humbën gjurmët e tij.

Dështimi, si duket, nuk e ka dëshpëruar UDB-në. Një vërtetim është 10. tetori 1981në Bruksel: Atje ishte vrarë një shqiptar me emrin Vehbi Ibrahimi në rrugë para banesës së tij, me një pistoletë të kalibrit 7.65.

Gruaja e tij e cila ishte me të ishte lënduar rëndë nga goditjet. Ibrahimi ka qenë nënkryetar i "Besëlidhjes shqiptare". Organet shtetërore gjermane tash, pas atentateve në Zenelajn dhe Ibrahimin duhej ta mbronin kryetarin, Emin Fazlija. Ai banonte te Göppingen-i dhe ka qenë i njohur te fqinjtë si "një burrë i vjetër dhe i rrespektuar". Policët kompetentë ishin të brengosur se "mos do ta vrasin edhe atë". Që prej atëherë, Fazlija është nën mbrojtje dhe nuk lajmërohet më në lidhjen telefonike të mëparshme. Policët nuk gjejnë gati fare përkrahje politike në luftën kundër kësaj lufte ilegale. Në të vërtetë ekziston një marrëveshje në mes të Bonn-it dhe Beograd-it për të përkrahur njëri-tjetrin në rast atentati. Herëpasherë ndërrohen informata për ardhjen e lëndëve shpërthyese ose të ndonjë arme. Mirëpo sa pak rëndësi ka kooperimi në mes dy shteteve për palën serbe e vërtetojnë atentatet. Zyra federale kundër krimit ka regjistruar se kur janë bërë atentate në kroatët në ekzil, në shumicën e rasteve UDB-ja ka përdorur pistoleta të cilat gjuajnë me rrotullim djathtor rreth boshtit, edhe pse shumica e pistoletave të këtij lloji gjuajnë me rrotullim majtor rreth boshtit. Organizatorët e atentateve as që e kanë pa të arsyeshme ta maskojnë këtë dallim.

Kur ranë në rrjetin e policisë jugosllave katër anëtar të RAF-it gjerman, jugosllavët prezentuan një listë me kroatë që lypeshin urgjentisht për t`i ndërruar ata. Zyrtarët gjermanë e refuzuan këtë dhe Beogradi i lëshoi anëtarët e RAF-it. Nëse mund të flitet për bashkëpunim në mes të policisë gjermane dhe asaj jugosllave, ana gjermane ankohet. Në vend që t`i përciellin shkakëtarët, jugosllavët japin vetëm këshilla në kërkesën e motiveve: "grindje për çështje nderi", "grindje për femra", "hakmarrje përreth stacionit të trenit" ose "tregti armësh" janë konfliktet e vërteta.

Politikanët jugosllavë e mohojnë katgorikisht implikimin e policisë sekrete jugosllave në këto raste. Lidhje me këtë ka bisedime të rregullta në mes të ministrisë së brendshme gjermane dhe kolegëve beogradas. Ministri i punëve të brendshme Franjo Herljevic, një gjeneral i vjetër partizan dhe bshkudhëtar i Titos, i demanton gjithmonë dhe deklaron se policia sekrete jugosllave nuk është duke vepruar në Republikën Federale Gjermane.

Kur kishte pyetur deputeti i CSU-së Fritz Wittmann në vjeshtë të vitit 1981, se cilat janë reagimet e Bonn-it lidhur me sjelljet e Beogradit, e mori një përgjigje të shmangshme. Bonn-i shprehet lidhur me këtë, thoshte ministrja Hildegard Hamm-Brücher, vetëm atje ku është e arsyeshme dhe e dobishme. Krahas proceseve gjyqësore ka aty-këtu edhe vetëdëshmi për veprime të UDB-së. Në ambasadën jugosllave ka qenë një diplomat bashkëbisedues i policisë gjermane, Tomo Renac, i cili pyetjet vetëm i përcillte për Beograd dhe kurr nuk përgjigjej. Në shumicën e rasteve vetëm i rrudhte krahët. Arsyen për këtë stil të mbajtun gjermanët e nuhatën, kur ra në duar të tyre një letër që Renac e kishte dërguar në Beograd.

Aty Renac, si një agjent i ofenduar ankohej se: "Po mundohen me masa propagandistike dhe penale për t`i bërë të pamundura aktivitetet e sigurimit të shtetit jugosllav në RF të Gjermanisë. Në një pritje shefi i policisë së Bonn-it ka tërhequr vëmendjen se kishte fakte se diplomacia jogosllave është tepër aktive në RFGJ. Kjo na

detyron të vimë në përfundim se puna në RF të Gjermanisë është bërë shumë e komplikuar".

Hetuesit gjermanë nuk prisnin shpërblim nga shërbimet jugosllave. Kur para pak kohe një prokuror i Frankfurtit paralojmëroi se në rastin e shqiptarit Zenelaj së shpejti do të fillojë me marrë "hetime në Jugosllavi", nuk deshi askush t`i jepte zemër. Një mbrojtës i shtetit në Bonn tha: "Lidhur me këtë ne vetëm kemi qeshur".

17. Marsh i heshtur për viktimat jugosllave

Në brendi të qytetit të Shtutgartit

Rreth 500 persona, sipas vlerësimeve të policisë, të shtunën kanë marshuar në heshtje përmes qendrës së qytetit në Shtutgart, në përkujtim të tre burrave jugosllavë, të cilët të dielën e kaluar në Untergruppenbach, afër Heilbronn-it, u vranë nga sulmues të panjohur deri tani. Në transparente demonstruesit kishin vendosur fotografitë e të vrarëve, duke kërkuar nga zyrtarët gjermanë që ta ndriçonin vrasjen. Në një trakt shkruante: Është dashur të merren masa të ashpra kundër "veprimtarisë kriminele të shërbimeve sekrete të jashtme" në Republikën Federale. Isw (Heilbronner Stimme, 25 janar 1982)

18. VRASJE POLITIKE

Me rastin e vrasjes në Untergruppenbach: Si gjithmonë në Republikën Federale duhet të fluturojnë gurë ose të ketë të vdekur para se të dihet ndonjë gjë zyrtarisht. Punëtorët sezonalë shqiptarë nga Jugosllavia, mes të cilëve edhe vëllezërit Gërvalla, më 24 prill24 1981 demonstruan në Shtutgart. Për shtypin kjo ishte vetëm një ngjarje periferike, me një titull sensacional „Kërcënim me bomba në stacion të trenit". Shqiptarët atëherë dëshiruan që me demonstratat të tërhiqnin vëmendjen për ngjarjet që po ndodhnin në krahinën jugosllave të Kosovës. Siç më tregonin ata, kryengritja popullore ka shkaktuar mbi 1000 të vrarë. Gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së demonstratës ata e dinin se do të kërcënoheshin me vdekje, dhe këtë e kanë futur edhe në trakt. Këto trakte shtypi nuk i publikoi. Se frika e tyre ishte e arsyeshme, tregoi edhe rrjedha e demonstratës: Nga anash është fotografuar demonstrata, natyrisht nga bashkëvendës joshqiptarë, dhe në rastin kur demonstruesit tentuan që ta pengonin fotografimin, policia sulmoi në mënyrë masive dhe i arrestoi shtatë shqiptarë, derisa fotografistin e la të lirë.

Kjo që shqiptarët deshën të bënin për t'i bërë të njohura ngjarjet në atdheun e tyre, për opinionin tonë publik dhe zyrtarët tanë ishte e pakëndshme. Befasia për vrasjen politike në Untergruppenbach, pas këtyre ngjarjeve është hipokrizi.
Rene Tablot, Shtutgart (Heilbronner Stimme, 29 janar 1982)

19. NJOHURI MBI VRASJEN E JUGOSLLAVËVE

(Südwestdeutsche Zeitung, 30 janar 1982)

Stuttgart: Banesa e të huajve ishte vështruar kohë të gjatë para veprës

Dymbëdhjetë ditë mbas vrasjes së tre mërgimtarëve jugosllavë në Untergruppenbach të Heilbronn-i, Enti Kriminal Federal (EFK) Baden Württemberg ka marrë njohuritë e para mbi vrasësit e mundshëm dhe ka filluar kërkimet. Organet hetuese i kërkojnë dy burra në moshë prej 30 dhe 35 vitesh, të cilët qysh se disa ditë para atentatit, duket e kishin vështruar banesën e dy vëllazërve të vrarë Bardhosh dhe Jusuf Gërvalla. Përpos kësaj organet hetuese kërkojnë një jugosllav të moshës 30 vjeçare, i cili në gusht të vitit 1980 ishte burgosur me dyshim të veprimtarisë për shërbimin sekret jugosllav, mirëpo i cili ishte liruar përsëri, mbasi që atij asgjë nuk mund t'i dëshmohej me siguri.viktimat e atentatit, deri më tash më të rëndë në shtetasit e huaj në Baden-Württemberg, me prapavi të mundshme politike apo shërbim sekret, janë mërgimtarë jugosllavë me kombësi shqiptare, të cilët kanë vepruar për themelimin e një Republike të Pavarur të Kosovës në Jugosllavi. EFK ka referuar në informata, në bazë të cilave 28 vjeçari Kadri Zeka, poashtu i vrarë gjatë atentatit, është dashur që të shtyhet për t'u kthyer në Jugosllavi. Në rast që nuk pranon, ai është kanosur se do të vritet. Edhe banesa e vëllazërve Gërvalla kishte qenë vëzhguar qysh moti, jo vetëm shkurtimitsht para atentatit. Ata dy burrat, të cilët kinse, shkurtimisht para atentatit e kanë vëzhguar benesën e dy vëllazërve, kanë bartur në bazë të njohurive të EFK, kësula të zeza. Posa sërish kishte rënë në sy edhe dallimi i gjatësisë i të dy të dyshuarëve edhe veshmbadhja e çuditshme e njërit prej tyre, i cili kishte veshur një pallto ngjyrë kafendryshk, me jakë gëzofi të errët dhe pantollona të kuqe të ngushta. Është e mundur se ata kanë qenë duke udhëtuar me një veturë të markës Citroen Cx. Personi i tretë (shikoje fotografinë), ka " ndryshuar qarkullimin" e postave të bashkatdhetarëve me një mashtrim, dhe e ka përvehtësuar atë. Me ç`rast ai ishte mundur edhe për letrat e vëllazërve Gërvalla, të cilët mbi këtë çështje i kishte informuar policia.

Policia e kërkon jugosllavin Riza Salihu, i cili në vitin 1980 kishte sjellë në pronsinë e tij postën e bashkatdhetarëve të tij dhe kundër së cilit ekziston edhe fletarresti edhe për delikte tjera. (Nga gjermanishtja: Xhafer Leci)

20. Me fotografi fantome policia kërkon atentatorët

Vrasësit janë vërejtur paraprakisht në Untergruppenbach

(Heilbronner Stimme, 30 janar 1982)

Me Citroën CX 2000 ngjyrë të çiltër në rrugë? / Kërkohet Riza Saliu

Për zbardhjen e atentatit në Untergruppenbach, në të cilin ranë tre mërgimtarë jugosllavë, dje Prokuroria e Heilbronn-it dhe Enti Kriminalistik i Vendit, kanë shpallur një fletarrest. Sipas të dhënave të deritashme, "fotografitë fantome" kanë dhënë atentatorin e dyshimtë. Lidhur me rastin e Untergruppenbach-ut kërkohet edhe mërgimtari jugosllav, Riza Saliu.

Edhe më tutje ekziston dyshimi se ata që me revole bënë atentatin me prapavijë politike ishin „profesionistë“. Të tre jugosllavët, të cilët në natën e 17 janarit në orën 22.15 u vranë në veturë në Untergruppenbach, ishin të angazhuar që atdheu i tyre në Jugosllavinë jugore, Kosova, të bëhet e pavarur. Për informatat që çojnë në kapjen e

sulmuesve është premtuar shpërblimi prej 10.000 markash. Siç u njoftua dje, disa ditë para vrasjes në Untergruppenbach, kanë rënë në sy persona të cilët supozohet se e kanë vështruar vendin e banimit të dy personave që më vonë pësuan. Përshkrimi i personave të dyshimtë:

– Rreth 30-vjeçar, i madh, me figurë të fuqishme, shpatullgjerë, mbante kapelë të zezë leshi, një xheketë ngjyrë ndryshku-kafe me jakë gëzofi, ngjyrë e mbyllët, pantallona të ngushta ngjyrë të kuqe që bien në sy, çizme të çiltra lëkure, të gjata.

– Personi i dytë ishte rreth 25-vjeçar, krahasuar me përcjellësin më elegant mbante një kapelë të mbylltë me një xhufkë dhe një xhaketë të ngjashme, të mbylltë.

Komisioni i Veçantë shpreson se për shkak të dallimit në madhësi mes dy të dyshuarve dhe veshjes karakteristike të njërit prej tyre, do të jepen informata të mëtejshme nga popullata, parasëgjithash për kohën e qëndrimit të të kërkuarve.

Ata, është e mundur të kenë qenë me një veturë të çiltër të markës Citroën CX 2000.

Për vrasje me motive politike, pos LKA (Entit Kriminalistik tåe Vendit) flet edhe fakti se njërin nga viktimat, i cili ka ardhur nga Zvicra, Kadri Zekën, para disa muajsh kanë bërë përpjekje që me dhunë ta kthejnë në Jugosllavi dhe e kanë kërcënuar edhe me vdekje. Lidhur me vrasjen në Untergruppenbach kërkohet edhe jugosllavi Riza Saliu, kundër të cilit është një urdhërarrest edhe për delikte të tjera.

Salihu është 30-vjeçar, 1.88 cm i gjatë, i hollë dhe ka flokë ngjyrë kafe të mbylltë.

Informatat për personat e dyshimtë dhe për Saliun i merr Komisioni i Veçantë në numrin e telefonit: 071 31/104-21 79, ose secili stacion i policisë.

A kanë qenë Atentatorët duke udhëtuar me një Citroën CX 2000?

Fotos: LKA (Enti Kriminalistik i Vendit) (Heilbronner Stimme, 30 janar 1982)

21. KUSH E PA VETURËN E BARDHË GJATË NATËS?

Atentati i jugosllavëve

Dy atentatorëve, të cilët dy javë e gjysmë më parë në Utergruppennbach vranë tre jugosllavë të mërguar, akoma iu mungon çdo gjurmë, por nga banorët në ndërkohë ka „të dhëna interesante“. „Komisioni i veçantë i Untergruppenbach-ut“ i Entit Kriminalistik të Baden-Würtenbergut, në kuadër të njoftimeve për publikun, dje bëri të njohur një detaj tjetër. Pak minuta para të shtënave, nga të cilat më 17 Janar, në orën 22.15, në Habichthöhe ranë viktima në automobilin e tyre treshja, afër vendit të ngjarjes është vërejtur një veturë e bardhë, mendohet të ketë qenë Audi 80. Vetura ka qëndruar aty ku bashkohen Falkenstrasse me Habichthöhe në Untergruppenbach, në drejtim të Falkenstrasse në anën e majtë të rrugës.

Kushdo që di diçka për këtë veturë, për ngasësin dhe bashkëngasësin, janë të lutur që të paraqiten në „soko Untergruppenbach“ (Telefoni 07131 – 1 04 22 05).

Më këtë rast është përsëritur edhe një herë se Prokuroria e Heilbronit ka ofruar shpërblimin prej 10.000 markash për informatat që çojnë në kapjen e sulmuesve. (Heilbronner Stimme, 3 shkurt 1982)

22. SOT VARROSEN VIKTIMAT E ATENTATIT
Pasardhësit në grevë

(Heilbronner Stimme, 5 shkurt 1982)

Të tri viktimat e atentatit në Untergruppenbach, do të varrosen të premten, ditën e sotme, në orën 14, në varrezat kryesore në Shtutgart-Steinhaldenfeld. Pas një protestimi, duke qëndruar ulur para Bashkisë për gjashtë orë, familjarët e të ekziluarve të vrarë jugosllavë, u pajtuan që varrimi të bëhej të premten, e jo të shtunën siç dëshironin ata.

Pas refuzimit nga qeveria jugosllave që kufomat të varrosen në Krahinën e Kosovës, të afërmit e tyre vendosën që varrimi të bëhet në Shtutgart. Një zëdhënës theksoi se shpreson që më vonë rrethanat politike do ta lejojnë varrimin e viktimave në atdheun e tyre. Me qëllim që pjesëmarrja e të afërmve të jetë sa më masive, ata kishin kërkuar që varrimi të bëhet një të shtunë. Kështilli i qytetit kishte kundërshtuar. Thuhej, parimisht varrimet nuk lejohen në fundjavë, prandaj as për këtë rast nuk do të ketë përjashtim. Me trakte transparente dhe me kërkesa që varrimi të bëhet të shtunën, të vejat e viktimave me fëmijët dhe të afërmit e tyre shkuan të mërkurën në Bashkinë e Shtutgartit, por pas një demonstrimi gjashtorësh ata hoqën dorë nga kërkesat. Nuk ishte paraparë një demonstratë si ajo e para dyjavësh, ku rreth 400 shqiptarë në brendi të Shtutgartit kërkuan „Liri për Kosovën“. Gjithsesi pritën „qindra pjesëmarrës“ në varrim. (Heilbronner Stimme, 5 shkurt 1982)

23. ÇKA JANË KËTO SPEKTAKLE TË MJERA?

Në skenat I-2, -3 dhe -4 ngjarja zhvillohet në banesën e gruas dhe fëmijëve të Jusufit në Tiranë, dhe ka të bëjë me përgatitjet rreth një filmi dokumentar.

Në skenën I-3 gjenden këto fjalë:

Sabri Hamiti: *"REGJISORI –A dini zoti Fitimi, ne do të bëjmë një emision për Isën. Do të ishte mirë që ju të flisni për babain tuaj e heroin.*

FITIMI, preraz. – Ndal! Ç'janë këto parulla që flisni këtu? Çka janë këto spektakle pa ngjyrë?

Regjisori i bën me shenjë kameramanit të xhirojë. Fitimi e heton dhe e ndalon.

FITIMI, regjisorit të ngrirë. *– Shiko djalë i mirë. Babai im, Isa, nuk ka qenë asfarë heroi. Ai ka qenë krejt i zakonshëm. E ka dashur muzikën, letërsinë, familjen e vet e lirinë. Ka punuar shumë. i ka urrejtur për vdekje rrenat. Kjo edhe i ka kushtuar me jetë. Mund të flitet për jetën e një shqiptari të zakonshëm të Kosovës, që jeton jetën e vet e vdes si vdes njeriu. Sa për spektaklet nuk i jap as pesë para. Kur e mbaruan spektaklin e mjerë në varrin e tij, e isha një fëmijë, të gjithë ikën e më lanë vetëm me flamur në dorë te kryet e tij. Do të më linin te varri po të mos ishte nëna, të më merrte ngryk në atë tmerr e në atë tubim të tmerrshëm. Mos shpifni e shpikni miq, rrena, heronj të gjallë e të vdekur se do të keni punë me ndërgjegjen tuaj dhe me mua.*

Ua kthen shpinën. Mund të shkoni. Fitores. Përcilli deri te shkallët.

Dalin të gjithë pa thënë asnjë fjalë." (Misioni, Prishtinë 1997, f.87-88)

24. 300 TË PIKËLLUAR NË VARREZAT E VIKTIMAVE TË VRASJES

Mërgimtarët jugosllavë u varrosën

„Heilbroner Stimme“ 6 shkurt 1982

Nga Gerhard Viel

Derisa policia e Shtutgartit llogariste me rreth 1000 pjesëmarrës në varrim, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit nga afër dhe larg, të premten 300 meshkuj dhe femra përcillnin në varrezat e Shtutgartit Steinhaldenfriedhof arkivolet e tre mërgimtarëve jugosllavë, të vrarë në një atentat në Untergruppenbach. Sipas dëshirës së tyre, të afërmit e viktimave kishin hequr dorë nga simbolet fetare, ndërsa arkivolet ishin të zbukuruara vetëm me flamurin kombëtar, me shqiponjë të zezë dy krenare në fushë të kuqe. Deri te të papriturat nuk erdhi gjatë 80 minutave, sa zgjati ceremonia e varrimit në anën lindore të kryeqytetit të vendit.

Pjesëmarrësit në varrim në numrin më të madh erdhën nga tërë territori i vendit, ndërsa një autobus i vetëm erdhi nga rajoni i Ruhr-it, të cilët shkuan në këmbë nga Obere Zigelei në Shtutgart deri te varrezat në Bad Cannstatt. Ata e shfaqnin dhimbjen përmes shalleve të kuqe, e disa të tjerë bartnin kostume kombëtare me plis të bardhë. Edhe vetë fëmijët merrnin pjesë në marshin e përmortshëm.

Fjalimet e përmortshme që i mbanin kryesisht flisnin në gjuhën e tyre, por pjesërisht edhe i përkthenin, sidomos kur i falënderonin të pranishmit për pjesëmarrje, e veçanërisht fqinjët nga Untergruppenbach-u. Pastaj, u ndalën në historinë e vëllezërve Gërvalla, babai i të cilëve ishte vrarë gjatë trazirave në Kosovë, në Jugosllavinë jugore. Një person në fjalimin e përmortshëm tha se të dy të vrarët i kanë njohur dhe përjetuar kampet e përqendrimit në Jugosllavi dhe kanë luftuar kundër padrejtësive të cilat ua shkaktonte regjimi jugosllav. Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Jugosllavisë, ku shqiptarët jetojnë dhe dëshirojnë një Republikë për vete si Mali i Zi, janë të njëjta si ato mes Izraelit dhe Palestinës.

Të dy mërgimtarët Gërvalla janë vrarë në Untergruppenbach „nga kriminelët dhe urdhërdhënësit e tyre, emrat e të cilëve ne nuk duam t’i përmendim këtu“, tha njëri në fjalën e tij të përmortshme. Në të njëjtën kohë, në një transparent të KPD/ML (Partia Komuniste Gjermane/Marksiste-Leniniste) mund të lexohej: „Ne mbajmë zi për shokët tonë që u vranë nga shërbimi sekret“.

Oratorët, në fjalimet e përmortshme, për më tepër kritikonin qeverinë e vendit dhe të rrethit, për atë se nuk kanë ndërmarrë kurrfarë hapi kundër shërbimit sekret jugosllav.

„Politikën e qeverisë së vendit po e shfrytëzon qeveria e Beogradit“, thoshte një përfaqësues i KPD (Partia Komuniste Gjermane) dhe kritikonte mënyrën e shprehjes së kryetarit të fraksionit të Partisë CDU (Unioni Krishterë Demokratik), Teufel, i cili kishte thënë se „atentati në Untergruppenbach është qërim hesapesh mes grupeve ekstremiste të të huajve në truallin gjerman“. Këtu u tha se të vrarët janë barazuar me vrasësit!

Sipas fjalëve të avokatit të zonjës Gërvalla, Michael Wolf, pritet që të hënën e ardhshme prokurori i Heilbronn-it t’i mbyllë hetimet. Natyrisht, parashtrohet çështja se a mos duke bërë kërkimin e gjurmëve dhe të vrasësve po del shumë në sipërfaqe çështja e mbrojtjes së shtetit. Kështu, edhe Enti Kriminalistik i vendit është e mundur që gjatë hetimeve të vrarët t’i penalizojë si bashkim kriminelësh. Është fakt se policia në rastin e vrasjes në Untergruppenbach „nuk ka gjetur kurrfarë gjurmësh konkrete“, ashtu si e vërtetoi edhe Enti Kriminalistik i Vendit. Kërkimi i dy burrave të moshës 30 deri 35-vjeçare, të cilët kanë përgjuar banesën e të vrarëve pak kohë para se të ndodhte vrasja, vazhdon.

Përfaqësues të KPD/ML, pas kryerjes së varrimit, në një konferencë për shtyp ku

ishin të pranishëm edhe një numër i madh i të afërmve të të vrarëve, kritikuan zyrtarët gjermanë që nuk pati kurrfarë programi zyrtar për ngushëllime për të vrarit jugosllavë nga Kosova, „as nga kryetari i komunës së Heilbronn-it, as nga qeveria e vendit“, po ashtu as nga Këshilli Bashkiak i Shtutgartit, i cili udhëhiqet nga kryetari Rommel.

Ndërmarrja e Varrezave të kryeqytetit të Landit (vendit) i është shmangur varrimit për të shtunën, edhe përkundër asaj se në raste të veçanta është e mundur, pasi që më shumë se 22.000 punëtorë nga Kosova në nivel federal do të kishin dashur të merrnin pjesë.

Gjithashtu, prania e policisë në varreza ishte shumë e madhe, edhe pse para një jave në Shtutgart, në marshin përkujtimor, u dëshmua manifestimi paqësor. Avokati i llahtarisur tregon se si zyrtarët e Ndërmarrjes së Varrezave, paraprakisht kanë kërkuar nga të afërmit një nënshkrim për shpenzimet e varrimit. (Heilbronner Stimme, 6 shkurt 1982)

25. U varrosën jugosllavët e vrarë të Untergruppenbach-ut

Tre mërgimtarët jugosllavë me prejardhje shqiptare, të vrarë në Untergruppenbach, vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka, u varrosën dje në varrezat e Shtutgartit në Steinhaldenfriedhof, në praninë e 300 pjesëmarrësve. Në fjalët e përmortshme, Shërbimi Sekret Jugosllav u bë përgjegjës për vrasjen e tre burrave në mërgim, të cilët luftonin për lirinë e Kosovës, të banuar me shumicë shqiptare, që ajo të bëhet republikë konstituive. E thanë me fjalë e me shkrime se gjithçka tjetër ishin pos terroristë. Ata kritikuan edhe zvarritjen në zbulimin e krimeve. (Heilbronner Stimme, 6 shkurt 1982)

26. Nuk ka „Zvarritje“

Heilbronn/Untergruppenbach (jac):

Akuzat e shqiptarëve të ekziluar jugosllavë, drejtuar organeve gjermane të ndjekjes, për „zvarritjen“ e ndriçimit të atentatit në Untergruppenbach, dje janë hedhur poshtë nga kryeprokurori i Heilbronit, Mainx: „Unë nuk di të jetë krijuar ndonjëherë në regjionin e Heilbronit menjëherë një komision i veçantë me 40 anëtarë“.

Megjithatë, ende s'ka „dyshim konkret“ për vrasjen e tre mërgimtarëve jugosllavë nga Kosova, më 17 janar 1982, në Untergruppenbach. Komisioni i Veçantë, në ndërkohë, ka ndërruar selinë dhe nga Heilbronn-i është bartur në Shtutgart; përveç kësaj ai është zvogëluar. (Heilbronner Stimme, 11 shkurt 1982)

27. QËLLIMI I BACËS

Letra e Hysen Gërvallës, 12 korrik 1985

Lëtër e hapur
Tri grupeve që, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së

Që në fillim e shoh të udhës të theksoj se propozimi i parashtruar më poshtë, është mendim i lirë, i mbështetur në qëllimet më të sinqerta, të cilat ia ka imponuar koha dhe momenti çdo njeriu të ndershëm të popullit tonë e që jam i bindur se i ka parasysh secili prej jush. ...

Madje, edhe nëse ekziston ndonjë grup apo organizatë tjetër me orientime dhe qëllime të drejta, mendojmë se është e udhës t'i bashkohet Lëvizjes së përgjithshme. ....

Në bazë të këtyre dal me këtë propozim:

-që te tri grupet t'i autorizojnë përfaqësuesit e vet me të gjitha kompetencat e duhura, prej 3-5 vetave.

-bashkimi të bëhet pa asnjë kusht nga të tri grupet ekzistuese, respektivisht organizatat. (Po deshëm të arrihet mirëkuptimi, **duhet t'i hedhim poshtë të gjitha pretendimet** se njëra është e drejtë, se tjetra është më e fortë, apo se "akcila" është koka e kombit shqiptarë, **pretendime këto megalomane**, tendencioze, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi shkojnë në dobi të armikut e që pengojnë bashkimin e lakmueshëm). ...

Po që se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz që punojnë për armikun, do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndroj mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive.

Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet, çdo njëri në emër të kësaj çështjeje të madhe, të distancohet secili pa ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të odës dhe mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë e konstruktiv, sepse siç ka thekësuar Ismail Qemali, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në të mirë të kombit dhe atdheut.

Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë e jo në grupe e as individë.

Delemont – Zvicër, 12 korrik 1985

28. QËLLIMI I BABIT

Donika Gërvalla: "Qëllimi i Babit në Gjermani ishte të bashkonte diasporën shqiptare. Këtë qëllim e ndiqte me shumë ngulm, pasion dhe mençuri. Ai me shqiptarët e emigruar bisedonte rreth familjeve të tyre, lirisë dhe asaj që duhej bërë për të përmirësuar situatën në vendlindje. Në fillim të viteve '80, për herë parë nën organizimin e tij, shqiptarët mbushën rrugët e Gjermanisë për të demonstruar për të drejtat e tyre dhe kundër tankeve dhe dhunës së ushtruar në Kosovë." (DUHET THYER HESHTJA, Koha Ditore, 19 Janar 2012)

29. QËLLIMI E PRETENDIMI I BIJËS

Donika Gërvalla-Schwarz: "Kam atë pretendim që në Kosovë ka ardhur koha të mos heshtet. ... Ka në Kosovë kaq shumë të rinj që kanë një vizion kaq të qartë, se nuk ka nevojë për ndonjë filozofi të madhe, sendet janë shumë të thjeshta. Mundësitë ekonomike janë në njërën anë, dëshirat janë në anën tjetër dhe vetëm duhet gjetur një zgjidhje e cila është konform ligjit, të mos shkelet ligji, të mos shikoj secili si të pasuroj xhepin e vet, po sesi të mbetet pak edhe për atë që është për t'u bërë. ... Prandaj për një realitet që ne e njofim mjaft mirë, kë presim që të vij dhe të na e ndryshoj?" (Kohavizion, 18 maj 2012)

30. JUSUF GËRVALLA – EMËR QË U BË TRADITË E POPULLIT

Nga Kadri Rexha

Përvjetorët dhe varrezat

Përvjetorët kanë diçka të ngjashme me varrezat. Pikërisht me varrezat e fshatit tim të lindjes, Cerrcës. Ndoshta jo vetëm për faktin se ato pushojnë të qeta buzë rruge dhe bëhen pasqyrë e kalimtarit të rastit apo pse ato janë hije të trasha nën të cilat balsamoset jeta njerëzore me të gjitha ngjyrat e saj, sa për shkakun se në pllakën e një varri të varrezave të fshatit tim, pikërisht aty ku pushon amshueshëm trimi Selman Kadrija, shkëlqen i gdhendur ky epitaf:

Ju shtegtarë që kaloni
Pranë këtij trimi ndaloni
Veprën mos ia harroni
Bijve tuaj t'iu tregoni

Pra, përvjetorët, si edhe varrezat, të ngacmojnë, të nxisin për të mediuar, për të evokuar, për të thënë gjithë atë që fle në kujtesë lidhur me një person apo ngjarje të rëndësishme. Gjatë përvjetorëve, si edhe në varreza, shkrihet kufiri në mes të gjallëve dhe të vdekurve, përzihen bisedat, amanetet, mesazhet, i gjalli dhe i vdekuri japin dhe marrin nga njëri tjetri. Kështu po ngjanë sot edhe me Jusuf Gërvallën. Përvjetorët e vdekjes së tij (së bashku me Kadriun dhe Bardhoshin) janë bërë tribuna të gjalla dialogu midis popullit dhe bijve të tij martirë. Varrezat e Jusufit, Kadriut dhe Bardhoshit janë kthyer në vende të shenjta prehjeje dhe ngushëllimi ku populli aq sa po merr forcë prej veprës dhe amanetit të tyre po aq po e qanë hallin me ta. Pra, Jusuf Gërvalla me gjithë qenien e tij u bë pjesë e traditës përparimtare shqiptare, u bë emër i shenjtë që hyri në traditë për të jetuar përjetësisht.

Përfaqësues i denjë i epokës sonë

Jusuf Gërvalla, shkrimtar, mendimtar, ideolog dhe veprimtar, i takon profilit të personaliteteve të shquara të kulturës, të shkencës dhe të historisë shqiptare, të cilëve posa t'u zihet në gojë emri të rrëqethin në shtat, të tronditin në ndërgjegje, të mbushin me frymëzim dhe, që, me porosinë e veprave të tyre, të mobilizojnë, për të punuar dhe për të luftuar deri në flijim për të vërtetën, për të drejtën, për lirinë, për progresin shoqërorë dhe për progresin historik. Veprimtaria e gjithanshme e tij në planin kulturorë, shoqërorë dhe në atë politik përputhet plotësisht me kohën kur kombit dhe atdheut tonë po i përgatitej qefini mortor nga shteti serb dhe fund e krye ajo përshkohet nga filli i kuq i aspiratave dhe i idealeve të mbarë popullit shqiptar. Prandaj, duke qenë personaliteti më vital që iu përgjigj flakë për flakë kërkesave të popullit, që i ripohoi ato me një gjerësi dhe me një cilësi të shkallës më të lartë, si askush tjetër para tij, Jusuf Gërvalla me të drejtë konsiderohet si njëri ndër përfaqësuesit dhe ideologët më tipik të lëvizjes patriotike dhe nacionalçlirimtare të popullit tonë, si njëri ndër përfaqësuesit më të denjë të epokës sonë. Dhe, që në fillim Jusuf Gërvalla ishte i ndërgjegjshëm se rruga e lirisë nuk ishte e lehtë. Se ajo rrugë kalonte përmes vuajtjeve dhe flijimeve të mëdha, përmes parmakëve të burgjeve të pushtuesit, përmes torturave çnjerëzore të pushtetit dhe plumbave vdekjeprurës të armikut... Ai e kishte më se të qartë se lirinë nuk ta falë kush dhe se liria fitohet me mundime të mëdha, me djersë dhe me gjak të pakursyer. Këtë mësim themelor Jusuf Gërvalla e kishte nxjerrë nga përvoja e madhe e popullit të tij si dhe nga përvoja e

të gjithë popujve liridashës të botës së qytetëruar. Këtë përfundim të drejtë Jusuf Gërvalla, me jetën dhe me veprën e tij, e vuri edhe në bazën e edukimit të shëndoshë të popullit të tij të shtypur e të robëruar: "Në ballë të këtij populli dhe të këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme", do të shprehet ai më vonë. Ky betim i Jusuf Gërvallës në altarin e atdheut nuk ishte një deklaratë e thatë e as pozë e personit që atdhetarizmin e ka tregti, por ishte ideal i shenjtë që u bë realitet në fushën e nderit. "Pa ideal nuk ka fitore në asnjë luftë" – ishte kjo moto e jetës së Jusuf Gërvallës, ishte ky besim i patundur i tij. Me mish e me shpirt, me zemrën plot për Kosovën dhe Shqipërinë, me shpresën e madhe për çlirimin dhe për bashkimin e Kombit, Jusuf Gërvalla u dogj si qiriri për t'ia sjellë lirinë aq shumë të merituar popullit shqiptar, të ndarë dhe të pushtuar. Dhe, duke mos ndalur asgjë për vetveten Jusuf Gërvalla krejt çka pati të shenjtë ia fali popullit të tij të shumëvuajtur. Prandaj, nuk është e rastit as dashuria popullit për Jusuf Gërvallën, as kujtimi dhe nderimi që po i bëhet tashti e një çerek shekulli. Është konstatim i moçëm se secila kohë e madhe i ka edhe heronjtë e vet të mëdhenj. Të tillët pastaj, me kujdesin më të madh të popujve që u takojnë, vendosen në altarin e quajtur traditë për ta gëzuar kujtimin dhe respektin e thellë të gjeneratave aktuale dhe të brezave që do të vijnë. Në këtë drejtim edhe epopeja e kohës sonë e mishëruar me figurën poliedrike të Jusuf Gërvallës gjeti jehonë të denjë në krijimtarinë shpirtërore të popullit. Me të gjitha tiparet e njeriut, poetit, atdhetarit dhe prijësit të shquar figura e Jusuf Gërvallës u skalit në poezi, në prozë, në pikturë, në skulpturë, në këngën popullore, në shkrimet përkujtimore, në kujtime, në deklarata të miqve të tij, etj. Sipas traditës së vet kujtimin dhe respektin për Jusuf Gërvallën populli do ta shprehë edhe me pagëzimin e fëmijëve me emrin e tij, po ashtu me emërimin e shoqatave, klubeve, shtëpive të kulturës, shkollave, rrugëve, brigadës së UÇK-së, kazermës së ushtrisë, me organizimin e tubimeve popullore me rastin e vrasjes së tij, me shënimin e ditëlindjes së tij, me vizitat në shtëpinë e tij të lindjes në Dubovik, me hapjen e ekspozitave shëtitëse me fotografi personale të tij, me homazhet për njëzet vjet rresht në varrezat e fshatit Bad Canstat afër Shtutgardit në Gjermani si dhe tashti në varrezat e fshatit të tij të lindjes në Dubovik, me manifestimin kulturor tradicional "Flaka e Janarit", e kështu me radhë. Pra, ashtu siç i ka vlerësuar me shekuj ngjarjet dhe figurat e mëdha të historisë së vet edhe në rastin e Jusuf Gërvallës populli dha gjykimin e vet të pagabueshëm.

A i kemi dalë borxhit figurës së Jusuf Gërvallës

Por, me gjithë këtë, shtrohet pyetja: me kaq a i kemi dale borxhit figurës së Jusuf Gërvallës dhe sa kemi bërë që vepra e këtij personaliteti të njihet në popull, sidomos nga gjeneratat e reja. Përgjigjja pozitive lidhur më këtë çështje lë shumë për të dëshiruar. Nëse deri me tashti është ribotuar vepra e tij letrare (poezia, romani dhe një dramë) dhe kjo me një tirazh të pamjaftueshëm dhe me një shpërndarje në vijë partiake. Kanë mbetur të pa mbledhura dhe të pabotuara në një vëllim tregimet e tij, pastaj shkrimet kritike për letërsinë, muzikën dhe filmin, publicistika, intervistat, letrat,etj. Çështje në vete është edhe mbledhja dhe botimi i ngutshëm i veprimtarisë politike të Jusuf Gërvallës, me çka do të kompletohej kuadri i njohjes së tij edhe në këtë aspekt. Por, kaptina më e dhimbshme dhe më tragjike e veprës së Jusuf Gërvallës është kënga: mbi dyqind këngë të kënduara nga ai dhe të regjistruara në produksionin e Radio Prishtinës dhe të Televizionit të Prishtinës janë zhdukur njëherë e përgjithmonë nga dora gjakatare serbe. Në këtë rast mund të fajësohen edhe njerëzit tanë që punonin në këto institucione dhe që, në një klimë pak më të volitshme që u krijua në fillim të viteve të nëntëdhjeta, këto këngë nuk i nxorën dhe nuk i dërguan në Radiotelevizionin Shqiptar në Tiranë. Sidoqoftë, është detyrë e

dorës së parë që të hulumtohet lidhur me këtë çështje edhe në qendrat televizive jugosllave si dhe të mblidhen në një vend, të paktën, ato këngë të cilat ende ruhen në shirita të magnetofonit nga dashamirët e këngës së Jusuf Gërvallës. Pastaj edhe në organizimin e përvjetorëve të vdekjes së Jusuf Gërvallës (si dhe dy dëshmorëve që ranë me të) duhet bërë ndryshime pozitive. Këta përvjetor janë shndërruar në tubime uniformë ku lexohet një referat i thatë dhe ku interpretohen disa pika muzikore dhe asgjë tjetër. Nëse nuk i llogarisim këtu shkrimet letrare dhe këngët popullore kushtuar Jusufit, një pjesë prej të cilave janë shkrime me vlerë dhe mbresëlënëse, për këto njëzet e pesë vjet pas vdekjes së Jusuf Gërvallës u bënë vetëm katër-pesë deklarata të miqve të Jusufit, dy shkrime të bashkëpunëtorëve të tij, dy-tri shkrime kritike për veprimtarinë tij letrare dhe muzikore, një sprovë për një jetëshkrim të tij, një bust dhuratë familjes së tij dhe asgjë më. Gjithçka tjetër e thënë nëpër referate dhe gazeta mbetët në nivelin e improvizimit. Çështje tjera shumë me rëndësi dhe që nuk presin janë edhe këto: ngritja e varrezës së tij, ngritja e një muzeu të mirëfilltë për të si dhe përjetësimi i tij në një përmendore monumentale. Dhe, nëse llogaritet mundi, përpjekjet dhe flijimi që Jusuf Gërvalla e bëri për ne, padyshim, rezultati tregon se ne kemi bërë shumë pak për të. Dhe, çka është edhe më keq, në shumë raste figura e Jusuf Gërvallës është provuar të keqpërdoret. Partitë tona politike, secila në mënyrën e vet, provuan ta përvetësojnë figurën e Jusufit dhe ta fusin atë në kornizën e tyre. Por Jusufi i pavdekshëm është kolos i madh i kombit shqiptar sa nuk ka kornizë partiake dhe as kornizë lokaliste-klanore që figurën e tij ta mbërthejë brenda vetës, sot as nesër. Dhe, në fund, detyrë e shkencës së mirëfilltë mbetet që sa më parë të dalë para popullit me studime të veçanta apo me një monografi shkencore mbi jetën dhe veprën e Jusuf Gërvallës. Vepra e plotë dhe e ndritshme e Jusuf Gërvallës duhet ta shohë dritën sa më parë. Ajo e tëra duhet të bëhet ushqim dhe pronë e mbarë kombit shqiptar.

Rasim Selmanaj: "Heroi me kitarë", sesion i zgjeruar shkencor, Fokus, Prishtinë, 2007, fq.174

31. Shtyhet rivarrimi i eshtrave të vëllezërve Gërvalla dhe të Kadri Zekës

Prishtinë, 9 janar 2002 (Kosovapress)

Këshilli Organizativ për Rivarrosjan e Eshtrave të Jusuf Gërvalla e Bardhosh Gërvalla dhe të Kadri Zekës, para pak ditësh, në mjetet e informimit publik ka dalë me një informatë se rivarrimi i eshtrave të këtyre dëshmorëve, që u vranë nga UDB-ja jugosllave në Unter-Grupenbah të Gjermanisë, do të bëhet me rastin e njëzetvjetorit të vrasjes së tyre, më 17 janar 2002.

Mirëpo, sipas Vesel Lekajt, për shkak të motit të lig, është shtyrë rivarrosja e eshtrave të këtyre dëshmorëve, për kohë më të mirë. Ndërkohë, komisioni ka filluar përgatitjet për organizimin e këtij manifestimi kombëtar, ku pritet të marrin pjesë shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare. Për punën dhë iniciativën e këtij komisioni do të informohet edhe kryetari i Parlamentit të Kosovës, Nexhat Daci, Kuvendi Komunal, si dhe do të bisedohet, në veçanti, me familjen e dëshmorit Kadri Zeka.

Shtyrja e rivarrimit bëhet në pajtim me kërkesën e familjes Gërvalla, e cila së bashku me familjen Zeka ka marrë përsipër, që eshtrat e bijve të tyre t'i sjellin në atdhe.

Rivarrimi i eshtrave të Jusuf e Bardhosh Gërvallës do të bëhet në fshatin e tyre të lindjes, në Dubovikë të Deçanit, kurse për rivarrimin e eshtrave të Kadri Zekës do të

konsultohet familja e tij dhe do të respektohet vullneti i saj. Për një manifestim të tillë, çfarë duhet të jetë ky, duhet të angazhohen të gjitha subjektet dhe institucionet kosovare e kombëtare, sepse vlera e këtyre martirëve paraqet madhështinë e kombit tonë.

Gjithashtu, iniciativë e këtij komisioni është që me emrat e këtyre dëshmorëve të nderohen institucionet tona dhe në Prishtinë të ndërtohet një kompleks, ku do të ngriten tri shtatore të këtyre dëshmorëve.

32. Promovohet libri "Pishtarët e lirisë"

Prishtinë, 15 janar 2002 (Kosovapress)

Në Institutin Albanologjik të Prishtinës, të martën, u promovua libri "Pishtarët e lirisë", ku përvijohet jeta dhe vepra e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës. Libri është përmbledhje e materialeve të tubimit përkujtimor kushtuar këtyre tre dëshmorëve, mbajtur në Tiranë në vitin 1992.

"Historia e lavdishme e këtyre trojeve të pamposhtura, heroizmat e brezave, natyra e bukur e madhështore e bjeshkëve, do të ndikonin, pa dyshim, në jetën dhe veprimtarinë atdhetare të Jusuf e Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës",- tha znj.Myrvete Dreshaj, në fjalën e hapjes së këtij manifestimi kulturor-letrar, që u mbajt pikërisht me rastin e njëzetvjetorit të rënies së dëshmorëve Jusuf Gërvalla, Bardh Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Në këtë manifestim kulturor-letrar, para familjarëve, shokëve të dëshmorëve dhe të interesuarve të tjerë u lexuan kujtime e mesazhe të dëshmorëve. Libri "Pishtarët e lirisë" është përmbledhje e materialeve të tubimit përkujtimor "Nderim dëshmorëve Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla, në dhjetëvjetorin e rënies", mbajtur në Tiranë në vitin 1992, organizuar nga Shoqëria Atdhetare për të Rënët e Kombit Shqiptar

33. Kthehen në Kosovë eshtrat e Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës

Shtutgart, 16 shkurt 2002 (QIK) - Më 23 shkurt, me rastin e kthimit në Kosovë të eshtrave të vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zekës, duke filluar nga ora 11,00, do të bëhen nderimet e fundit në varrezat qendrore në Bad Canstadt, si dhe përcjellja për në vendlindje. Lidhja Demokratike e Kosovës në bashkëpunim me familjet e heronjve dhe shoqatat e ndryshme shqiptare, fton të gjithë bashkatdhetarët në Gjermani dhe në shtetet përreth që me pjesëmarrjen e tyre t'ia shtojnë madhështinë kësaj ngjarjeje aq të pritur nga mërgata shqiptare, për të cilën Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka ishin burimi kryesor i frymëzimit në ruajtjen e identitetit dhe angazhimit në ndihmë të Kosovës.

Pas nderimeve të fundit, të shoqëruar nga familjet e tyre dhe një grup miqsh, Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka do të kthehen në Kosovë, ku do të prehen eshtrat e tyre përjetësisht në tokën, të cilës ia falën jetën.

Për të gjitha hollësitë rreth organizimit mund të drejtoheni në këtë numër të telefoni: +49-711-221630, thuhet në njoftimin e degës së LDK-së në Shtutgart.

34. Varrimi i Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës do të bëhet më 24 shkurt 2002

Shtutgart, 18 shkurt 2002 (QIK) - Kanë kaluar njëzet vjet që nga nata e 17 Janarit 1982, kur në pabesi të plotë, u vranë Bardhosh e Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka, tre dëshmorë të kombit shqiptar nga dora e zezë e UDB-së jugosllave. Kanë kaluar po aq vite, që kur familja dhe shokët e tyre u detyruan që ata t'i varrosin në Shtutgart të Gjermanisë, pasi që trupat e tyre nuk u lejuan të ktheheshin në vendlindjen e tyre, në Kosovë, thuhet në një deklaratë të familjes Gërvalla.

Pas njëzet vitesh nën dhe të huaj dhe larg vendlindjes së tyre të dashur, sot, ka ardhur dita, që Kosovës t'i kthehen bijtë e saj më të devotshëm, Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Me këtë rast, Familja Gërvalla njofton të gjithë të interesuarit se varrimi i vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla do të bëhet më 24 shkurt 2002, në varrezat e fshatit Dubovik (komuna e Deçanit), pra në vendlindjen e tyre, aty ku me zemër të hapur nga plagët e njëzet viteve të shkuara do t'i presë nëna Ajshe.

Ndërkohë, familja e të ndjerit Kadri Zeka do të dalë me një njoftim të veçantë, në lidhje me vendin dhe orën e varrimit, thuhet në këtë deklaratë të familjes Gërvalla.

35. Familja e Kadri Zekës reagon kundër shpifjeve të gazetës *Bota sot*

Gjilan, 21 shkurt 2002 (Kosovapress)

Familja e dëshmorit Kadri Zeka nuk ka mundur të heshtë të enjten përballë shpifjeve të gazetës Bota sot, e cila për interesa të caktuara ka manipuluar edhe me emrin e dëshmorit Kadri Zeka, të vrarë më 17 janar në Gjermani.

Familja e Kadri Zekës ka lëshuar një deklaratë lidhur me këtë. Në gazetën Bota Sot është dhënë njoftimi se Dega e LDK-së në Gjermani është marrë vesh lidhur me homazhet e organizuara për Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën në Shtutgart, me rastin e rivarrimit të eshtrave të tyre. Këtu përmendet marrëveshja me familjet e dëshmorëve. Lidhur me këtë Familja e dëshmorit Kadri Zeka ka lëshuar një deklaratë për opinion në të cilën thuhet:

"Ne njoftojmë opinionin se Familja Zeka nuk është marrë vesh me asnjë parti, e aq më pak me LDK-në, lidhur me homazhet dhe në përgjithësi me rivarrimin e eshtrave të dëshmorëve. Mendojmë se homazhet do të ishte mirë të bëheshin nga të gjithë të interesuarit pa dallime, po ashtu do të ishte mirë që organizimi i tyre të bëhej bashkërisht nga të gjitha subjektet e interesuara që veprojnë atje", thuhet në fund të reagimit të familjes së dëshmorit Kadri Zeka, lidhur me shpifjet e së enjtes në të përditshmen Bota sot./kps/

36. Nderimet e fundit

Afër Shtutgartit u bënë nderimet e fundit për tre dëshmorët Jusuf e Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka

Shtutgart, 23 shkurt 2002 (QIK) - Sot afër Shtugartit të Gjermanisë qindra shqiptarë bënë homazhet e fundit para eshtrave të dëshmorëve Bardhosh e Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka, të cilët kishin ardhur nga shumë vise të Gjermanisë dhe nga vendet e tjera. Me emocione të papërshkruara kalonin para arkivoleve të dëshmorëve qindra bashkatdhetarë për t'u bërë nderimet e fundit këtyre martirëve, para se eshtrat e tyre të sillen në Atdheun e lirë.

Varrimi i vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla do të bëhet nesër në Dobovik të Deçanit përkatësisht i Kadri Zekës në Gjilan.

37. HOMAZHE NË PRISHTINË

Mijëra qytetarë në Prishtinë u bënë homazhe vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekës

Prishtinë, 25 shkurt 2002 (QIK) - Më shumë se 20 vjetë pas vrasjes tinëzare në Shtutgard një aeroplan gjerman solli në Kosovë eshtrat e atdhetarëve të paepur për kauzën tonë kombëtare Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Me këtë rast me mijëra qytetarë të Kosovës ishin mbledhur në sheshin kryesor të Prishtinës "Skënderbeu" për t'u bërë homazhe këtyre dëshmorëve të kombit, eshtrat e të cilëve u sollën këtu dhe u rivarrosën në vendlindjet e tyre. Në këtë ceremonial ishin të pranishëm edhe familjarët, personalitete të jetës publike të Kosovës dhe ndërkombëtarë, si dhe shumë miq të vëllezërve Gërvalla dhe të Kadri Zekës.

Duke iu drejtuar në këtë ceremonial masës së mbledhur kryetari i Kuvendit të Kosovës akademik Nexhat Daci tha se vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka ishin atdhetarë që synim të jetës kishin çlirimin e Kosovës dhe inkuadrimin e saj në Evropë.

"Shpirti juaj liridashës ishte në Kosovën dhe kosovarët atëherë kur zhvillonit betejat tuaja ilegale, kur morët rrugën e kurbetit në një vend mik të kosovarëve, ishte me kosovarët kur mundoheshin ta hapnin autostradën evropiane të lirisë dhe të demokracisë", tha z. Daci. Tre veprimtarët shqiptarë: Jusuf e Brdhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka u larguan ilegalisht nga Kosova në fillim të viteve të 80-ta nga frika e ndjekjes nga Shërbimi Sekret jugosllav për shkak të veprimtarisë së tyre politike. Ata u vranë më 17 janar të vitit 1982 në një qytezë të Gjermanisë me një atentat akoma të pasqaruar, për të cilin besohet të jetë kryer nga Shërbimi Sekret jugosllav. Ata ishin organizatorë të veprimtarisë politike ilegale atë botë brenda në Kosovë dhe në perëndim që për qëllim kishte arritjen e shtetësisë për Kosovën.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci tha para mijëra qytetarëve të Kosovës se ardhja e eshtrave të tre atdhetarëve shqiptarë ka një simbolikë të veçantë meqë ata e gjejnë Kosovën ashtu siç kishin dëshiruar. Eshtrat e dëshmorit Kadri Zeka e nderuan pjesëtarët e TMK-së të cilët e shoqëruan për në Gjilan, ndërsa eshtrat e Jusuf e Bardhosh Gërvallës nuk i shoqëruan pjesëtarët e TMK-së, pohoi shefi për informim i Shtabit të përgjithshëm të TMK-së Shemsi Syla për shkak se familja Gërvalla nuk i kishte lejuar Trupat Mbrojtëse të Kosovës të shoqërojnë eshtrat e bijve të tyre për në varrezat e vendlindjes.

38. Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka i kthehen tokës së Kosovës

Prishtinë, 25 shkurt 2002 (Kosovapress)

Jusufi, Bardhoshi dhe Kadriu u vranë më 17 janar 1982, në Untergrupenbah të Gjërmanis, nga njerëz të shërbimit sekret jugosllav . Eshtrat e tre martirëve pushonin në varrezat e Bad Kanstatit të Gjermanisë, ku qenë varrosur 20 vjet më parë. Eshtrat e tre dëshmorëve në mëngjesin e 24 shkurtit u sollen me aeroplan nga Gjermania në Kosovë, ndërsa pasdite me nderime të mëdha nga bashkëkombasit e tyre u rivarrosen ndaras, Jusufi e Bardhoshi në Dubovikë të Deçanit, ndërsa Kadriu në “Varrezat e Dëshmorëve “ në Gjilan. Në përcjellje të policisë dhe nga familjarët e tyre, të ardhur enkas për këtë

ngjarje në Kosovë, arkivolet e tre martirëve të kombit kanë mbrritur rreth orës 9 e 30 minuta në sheshin "Skënderbeu", para Teatrit Kombëtar në Prishtinë. Eshtrat e tre martirëve u priten nga mijëra qytetarëve, të cilët kanë dalur për t'u bërë nderimet e fundit tri simboleve të bashkimit dhe të luftës për liri.

Të pranishëm ishin kryetari i Kuvendit të Kosovës akademik Nexhat Daci, komandanti i TMK-së, gjenerallejtënant Agim Çeku, shefi i misionit gjermanë në Kosovë Mihael Shmunk, ish-komandanti i UÇK-së Azem Syla, bashkëpunëtor të dëshmorëve dhe, përfaqësues të partive politike. Duke i quajtur Jusufin, Bardhishin dhe Kadriun "të dashurit e Kosovës", akademik Nexhat Daci, tha se shpirti i tyre liridashës ishte me Kosovën dhe me kosovarët, atëherë kur ata zhvillonin betejat ilegale.

Kortezhi me arkivolet e vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla ka vazhduar për në fshatinë e lindjes në Dubovik Deçanit nën përcjelljen e policisë, ndërsa arkivoli i Kadri Zekës, pasi ka parakaluar pranë pjesëtarëve të Gardës së Kosovës të TMK-së, që i bënin nderimet në dalje të qytetit të Prishtinës, vazhdoi nën percjelljen e TMK-së për në Gjilan.

Sipas një deklarate të përgjegjësit për informim të SHP të TMK-së, Shemsi Syla, familja Gërvalla nuk ka pranuar që Jusufit e Bardhoshit t'u bëhen nderime ushtarake. Mijëra banorë të komunës së Deçanit pritën dje me madhështi eshtrat e dëshmorëve Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla, në Dubovik ku u bë rivarrimi.

Në ceremoninë publike të rivarrimit në sheshin e fshatit, ishin mbledhur mijëra qytetarë të shumtë nga mbarë Kosova, në mesin e tyre edhe liderët e LDK-së e AAK-së dhe pjesëtarë të TMK-së. Për figurën shumë dimensionale të Jusuf Gërvallës dhe ndikimin e tij në përpjekjet e popullit për krijimin e Kosovës së lirë folën Zekeria Cana, i biri i Jusuf Gërvallës Premton Gërvalla, i cili rikujtoi se puna e babait dhe axhës së tij së bashku me Kadri Zekën u ndërprenë nga plumbat e armiqve para njëzet vjetësh.

39. Pjesë nga fjala e Ibrahim Rugovës në Dubovik

Mijëra qytetarë nga e gjithë Kosova morën pjesë në rivarrimin e vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla në Dubovik të Deçanit

Dr. Rugova: Jusuf Gërvalla ishte dhe do të mbetet burrë i madh, i urtë dhe trim i Kosovës

Deçan, 25 shkurt 2002 (QIK) - Në fshatin Dubovik të Deçanit dje pasdite u bë rivarrimi i dëshmorëve të kombit Bardhosh e Jusuf Gërvalla. Në ceremoninë e rivarrimit morën pjesë mijëra qytetarë nga e gjithë Kosova. Ishin të pranishëm edhe kryetari i LDK-s dr. Ibrahim Rugova, kryetari i AAK-së Ramush Haradinaj dhe komandanti i Zonës së Tretë të TMK-së kolonel Shaban Shala dhe veprimtari Zekeria Cana.

Dr.Ibrahim Rugova, duke folur për këta atdhetarë tha: "Të gjithë ne dhe e gjithë Kosova sot është krenare, ngase i sjell eshtrat e vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla e shokut të tij Kadri Zekës në tokën e vet, sepse ranë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Të gjithë ne jemi krenarë për kthimin e tyre në Kosovën e lirë dhe demokratike". "Dhembja njerëzore nuk shuhet, ndërsa rritet krenaria për ata që i patëm dhe për veprën që na lanë. Puna dhe vepra e tyre na e lanë lirinë e cila na duhet si buka dhe fryma e Zotit, e këtë diti ta bëjë Jusuf Gërvalla", tha në vazhdim Dr.Rugova, përpara të pranishmëve.

Lidhur me personalitetin e Jusuf Gërvallës, Ibrahim Rugova tha se ai ishte dhe do të mbetet burrë i madh i Kosovës, i urtë dhe trim. "Jusufi doli nga një familje me tradita të larta kombëtare. Ai ishte një artist i madh dhe me veprat e tij letrare solli frymën e Dheut të Kosovës dhe shpirtit njerëzor, ndërsa në fushën e artit muzikor dhe të këngës nxori zërin e thellë të lashtësisë shqiptare që del nga thellësia e dheut dhe ringjall popullin

e vet", - nënvizoi z.Rugova. Ai shtoi se pena e Jusufit ishte e mprehtë dhe në gazetarinë e Kosovës ai ngriti popullin përmes shprehjes në art. Dr.Rugova tha se për shkak të veprimtarisë së tij ai u përzu nga atdheu, duke shtuar se sikundër edhe në Gjermani ai iu kushtua veprimtarisë së tij politike dhe kombëtare për lirinë e Kosovës. "Jusufi kurrë nuk u ndal, por pranë vetes tuboi të gjithë bashkatdhetarët, ngase gjithmonë ishte për një bashkim kombëtar në të mirë të Kosovës", - deklaroi kryetari i LDK-së. Por, sipas dr.Rugovës, duke e parë rrezikun nga ky organizim, ai u likuidua fizikisht për ta shuar atë organizim, të cilin nuk arritën ta shuajnë kurrë. "Sot mund të themi se Jusufi i ka vrarë ata", - tha Rugova për të vazhduar se "Jusuf Gërvalla i takon brezit të parë të shkolluar komplet në Universitetin e Prishtinës, i cili ishte qendër shpirtërore e Kosovës e Jusufi i takon atij brezi që u përcaktua për pavarësinë e Kosovës, për integrim në Evropë të kombit shqiptar", - tha Dr.Rugova.

Kryetari i LDK-së në vazhdim theksoi se "idealet e tyre ishin bazë e mirë, që të bashku me miqtë tanë, të krijojmë shtetin tonë për të cilin ëndërronte Jusuf Gërvalla". Rugova falënderoi të ëmën e dëshmorëve, nënën Ajshe dhe anëtarët e tjerë të familjes për kontributin e tyre dhënë çështjes kombëtare për Kosovën.

Në këtë ceremoni foli edhe Zekeria Cana i cili bëri thirrje për bashkim të të gjithë shqiptarëve. "Na vijnë djemtë e Kosovës në Kosovën e përplakur por krenare me qëndresë të pamposhtur për të qëndruar, për të jetuar për të sotmen dhe të nesërmen tanë", tha z. Cana. Ndërkaq në emër të familjes Gërvalla falenderoi pjesëmarrësit në këtë rivarrim i biri i Jusufit, Premtoni. "Ardhja e juaj këtu është një ngushëllim dhe një nderim i madh për ne familjen, por mbi të gjitha është një nderim dhe respekt i thellë për jetën dhe veprën e këtyre dy bijve të Kosovës tonë të dashur. Puna dhe jeta e mixhës dhe vëllait të tij u ndërpre nga plumbat e armiqve tanë shekullor para 20 vitesh. Bashkë me ta atë natë të 17 janarit 1982 u vra edhe një shok i tyre i ngushtë Kadri Zeka" tha Premton Gërvalla. Në vijim të fjalës së tij ai theksoi se pas 20 vitesh shumë të gjata përplot me vuajtje e sakrifica jo vetëm të familjeve tona, por të mbarë popullit të Kosovës erdhi edhe kjo ditë fatlume, që këtij trualli të përgjakur t'ia kthejmë bijtë e tij Jusufin, Kadriun dhe Bardhoshin.

Ndryshe, para rivarrimit të dëshmorëve, kryetari Rugova e vizitoi familjen Gërvalla dhe nënës Ajshe i dhuroi një medalon të arit me portretin e Nënes Tereze.

40. Letër falenderimi e familjes Gërvalla

Prishtinë, 27 shkurt 2002 (QIK) - Ne, bashkëshortja dhe fëmijët e Jusuf Gërvallës, dëshirojmë të falenderojmë dhe t'i shprehim mirënjohjen tonë popullit të Kosovës dhe të gjithë atyre, që kanë udhëtuar me qindra kilometra nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga diaspora, dhe të cilët me atë pritje madhështore dhe me nderimet e fundit të bëra për tre bijtë e vet, na e lehtësuan dhimbjen shumëfish.

Me këtë rast dëshirojmë të falenderojmë edhe komunat e Deçanit, të Prishtinës dhe të Pejës, të gjithë banorët e Dubovikut dhe të fshatrave përreth, si dhe personelin e aeroportit të Prishtinës për mirëkuptimin dhe për ndihmën, që i ofruan familjes, duke bërë të mundur një varrim dinjitoz dhe në përputhje me kërkesat tona, të shprehura edhe publikisht.

Në këtë kuadër, falenderojmë Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, prof. Nexhat Daci, të gjitha institucionet, partitë politike dhe personalitetet e ndryshme për pjesëmarrjen e tyre si dhe për respektin e treguar ndaj dëshirës së familjes së Jusufit, që ky rivarrim të mbahet dhe të përfundojë si një ceremoni familjare, pa ngjyrime politike dhe pompozitete të rastit. Megjithatë, kjo kërkesë e fëmijëve të Jusufit nuk u respektua plotësisht gjatë rivarrimit dhe ky rast u shfrytëzua për ta instrumentalizuar politikisht ceremoninë, gjë për të cilën shprehim habinë dhe keqardhjen tonë.

Së fundi, dëshirojmë të shprehim kënaqësinë tonë se pas 20 vitesh, arritëm të kthejmë në vendlindje eshtrat e babait tonë, Jusuf Gërvalla, duke çuar në vend amanetin e tij për t'u varrosur në fshatin e tyre të lindjes, Dubovik.

Me mirënjohje të thellë, bashkëshortja dhe fëmijët e Jusuf Gërvallës.

41. Letër e hapur kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova

Nga Sabri Novosella-Maxhuni

I nderuari dhe shumë i respektuari kryetar I. Rugova. Të drejtohem me këtë letër si kryetarit të Kosovës edhe i imi edhe pse për ty nuk kam votuar (nuk kam votuar fare). Të lavdërojnë apo të shajnë dy ekstremet e politikës shqiptare. Unë nuk pajtohem me asnjërën palë. Të lavdërohet apo të shahet kryetari i një shteti nuk është në rregull. Për kryetarin duhet të thuhet e vërteta e argumentuar. Kam bindjen se e vërteta nuk është sharje as lavdatë.

E dini se kam jetuar 20 vjet në diasporë. Më së shumti në Suedinë demokratike. Gjithnjë kam ëndërruar Kosovën e lirë me kryetar si në Suedi, i cili është kryetar i atyre që e kanë votuar, i atyre që kanë votuar kundër tij, i atyre që nuk kanë votuar fare. Dhe asnjëherë nuk është akuzuar se i ka mbështetur ata që kanë votuar për të, e nuk i ka mbështetur ata që nuk kanë votuar apo kanë votuar kundër tij. Gjatë qëndrimit tim në Suedi, disa herë kanë ndodhur vrasje të veprimtarëve të ndryshëm. Është vrarë edhe kryetari i partisë më të madhe, Partisë Socialdemokrate të Suedisë, Ulof Palme. Asnjëherë, absolutisht asnjëherë, jo mbreti por asnjë përfaqësues i partisë së Ulof Palmes, nuk i kanë akuzuar përfaqësuesit e partive tjera për vrasjen e Ulof Palmes, që siç dihet ishte edhe kryeministër. Të gjithë kanë kërkuar nga hetuesia, nga prokuroria, nga gjyqësia, që të vihet drejtësia në vend, duke e ditur se lufta më e suksesshme kundër krimit është vënia e drejtësisë në vend.

Ju i nderuari kryetar i Kosovës, I. Rugova e dini se edhe bajraqet-fiset shqiptare e kanë pas bajraktarin-të parin e fisit. Bajraktarit i ka ndodhë që t'i vrahen dy familje mes vedi. Nuk ka ndodh që bajraktari t'a mbështesë njërën familje, e të ngritet kundër familjes tjetër. Po të ndodhte një gjë e tillë, do ta humbiste të drejtën për të qenë bajraktar i fisit të vet. Në këto raste, edhepse e ka dashtë njërën familje më tepër, e ka ruajtë asnjanësinë. Edhe bajraktari për t'a luftuar krimin i ka thirrë pleqnarët për ta vënë drejtësinë në vend. Për t'i penguar vëllavrasjet, ka ndodhë që anëtari i familjes së bajraktarit të vritet nga ndonjë kundërshtar i tij. Prapë bajraktari e ka ruajtur asnjëanësinë. I ka thirrë pleqnarët për t'a vënë drejtësinë në vend. Po të vepronte ndryshe do t'a humbiste të drejtën për të qenë bajraktar i fisit të vet.

I nderuari, shumë i respektuari Kryetar i Kosovës I. Rugova, a veproni ju si në Suedi, apo si bajraktar i një fisi që vepronte në të kaluarën?!!!

Ju, mbi kufomën e njërit derdhni lot, kufomën e tjetrit nuk e shihni fare.

Njërin e shpallni hero, tjetrin e shpallni tradhtar. Për njërin shpallni ditë zie, për tjetrin bubullojnë tupanat?!!!

Ju, i nderuari dhe shumë i respektuari kryetar i Kosovës I. Rugova, jeni kryetar i të gjithëve!!!

Sot me 17 janar 2003, u bënë 21 vite nga dita e rënies në altarin e lirisë të heroit Jusuf Gërvalla, bashkë me Kadri Zekën dhe Bardhosh Gërvallën. Ju, i nderuari kryetar i Kosovës I. Rugova, mbajtët mbledhje komemorative. Në atë tubim, nuk na thatë pse u

vra Jusuf Gërvalla me dy të tjerët! E shpallët se do të ndahet çmimi: “Kitara e artë e Jusuf Gërvallës”

Mos vallë i nderuari kryetar i Kosovës I. Rugova, keni menduar se Jusuf Gërvalla u vra se i binte mirë kitarës?!!!

Ju njoftoj i nderuari dhe shumë i respektuari kryetar i Kosovës I. Rugova se në vitin 1976, Jusuf Gërvalla u inkuadrua në Organizatën Kombëtare “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës” që udhëhiqej nga Tribuni popullor Metush Krasniqi (këtë e ka shpjeguar shumë mirë adhuruesi juaj i flakët Shefqet Jashari-Strovci), e cila organizatë luftonte për të arritur këtë që ju sot keni mundësi në Teatrin Kombëtar të mbani mbledhje komemorative mu për Jusuf Gërvallën etj.

Në këtë tubim, as nga ju apo nga ndonjë pjesëmarrës tjetër nuk u përmend se çka ka bërë Jusuf Gërvalla për t’u ndjekur këmba- këmbës në Gjermaninë e largët dhe për tu derdhur gjithë ata plumba mbi të.

Jo i nderuari kryetar i Kosovës I. Rugova ! Jusuf Gërvalla nuk u vra pse i binte kitarës. Shumë të tjerë i binin kitarës edhe më mirë, por askush nuk i vrau.

Okupatorët serbo-sllavë nuk i burgosnin, nuk i dënonin, nuk i vrisnin luftëtarët e lirisë kot. Okupatori kishte arsye të forta dhe i burgoste, i dënonte, i vriste. Okupatorit i rrezikohej Kosova nga luftëtarët e lirisë. I rrezikohej Kosova për t’i dalë nga dora, jo nga kitara e Jusuf Gërvallës, për çka ju i nderuari kryetar i Kosovës I. Rugova mbani mbledhje komemorative dhe ndani shpërblimin për kitaristin Jusuf Gërvalla.

Jusuf Gërvalla meriton që emri i tij të përjetësohet për veprën e tij madhore. Vepër që e bëri të pavdekshëm dhe e vuri në ballë të atyre që ranë në altarin e lirisë.

Jusuf Gërvalla që ra në altarin e lirisë është tjetër Jusuf Gërvallë. Jo ashtu si e dëshironi ju i nderuari dhe shumë i respektuari kryetar i Kosovës I. Rugova! Edhe një adhurues i juaji e tha: “Jusuf Gërvallën don t’ia marrin kulturës shqiptare dhe t’ia dhënë grupeve politike”. Jusuf Gërvalla, kulturës shqiptare për aq sa e ka merituar, kurse historisë kombëtare, prapë për aq sa e ka merituar. Merita e Jusuf Gërvallës është aq sa okupatorëve serbo-sllavë iu deshtë të marrin vendim që vetëm i vdekur të jetë i parrezikshëm për ta. Jusuf Gërvalla i historisë shqiptare u vra nga plumbat e okupatorëve serbo-sllavë, mu pse e shtroi çështjen shqiptare për ZGJIDHJE.

Jusuf Gërvalla doli para popullit të vet dhe tha: “Nuk pyesim për çmimin e lirisë”. Jusuf Gërvalla për veprimtarinë e tij si aktivist i LNÇK-së, si njëri nga prijësit kryesor, si njëri nga organizatorët kryesor, u dëshmua se nuk pyeste për çmimin e lirisë.
Jusuf Gërvalla iu drejtua popullit të vet me fjalët: “Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, vdekjen do ta përjetojmë si çastin më të bukur në jetë dhe nuk do të ketë forcë të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme”.

Jusuf Gërvalla edhe këtë e dëshmoi me jetën e vet. Nuk pat forcë që ta ndalë në rrugën e tij të ndritshme dhe vdekjen e përjetoi si çastin më të bukur të jetës. Bashkë me frymën e fundit dha amanetin: “ Për mua zi mos mbani. Në varrimin tim, kënga të jehoi”.

Porosit e Heroit Jusuf Gërvalla u bënë programi jetësor i luftërave të lirisë dhe në shembullin e tij luftonin dhe binin në altarin e lirisë. Pushkët që jehonin në malet e Kosovës ishin porosia e Jusuf Gërvallës. Ishin vetë thirrjet e Jusuf Gërvallës si luftëtar i lirisë, e jo si kitarist me të cilën në ndonjë çast pushimi i shprehte ndjenjat e tij shume njerëzore.

Jusuf Gërvalla edhe sot nga varri në Dubovik, në Kosovën e tij të dashur, thotë përmes gojës së Nënës Ajshe: “Dua të më varros Ushtria Shqiptare. Po të mos ishte kjo ushtri, as eshtrat e mia nuk do të preheshin këtu, pavarësisht a do të vij ndokush apo jo në varrimin tim”.

Ai “ndokush” je ti i nderuari dhe shumë i respektuari kryetar i Kosovës I. Rugova. Askush nuk mund të ta mohojë të drejtën me e pas atë pjesë të Jusuf Gërvallës që ti e don. Jusuf Gërvallën si kitarist!

Po të lutem i nderuari kryetar i Kosovës I. Rugova, mos u përpiq t’ua mohosh luftëtarëve të lirisë dhe popullit shqiptar, Jusuf Gërvallën si veprimtar politik. Si organizator i mirëfilltë. Si ideolog madhor, idealet e të cilit u realizuan nga pasardhësit e tij. Nga luftëtarët e lirisë. Edhe në këtë rast, kryetari i Suedisë, apo një bajraktar i fiseve shqiptare, së paku do të mbante qëndrim asnjanjës e jo ta përjetësonte Jusuf Gërvallën si kitarist e ta varros si luftëtar të lirisë.

Sabri Novosella, 17 janar 2003

42. U përkujtua figura e heroit Jusuf Gërvalla

Në kazermën e brigadës 331 “Jusuf Gërvalla” në Pejë

PEJË, 17 JANAR 2003 - U përkujtua figura e heroit Jusuf Gërvalla të premten në kazermën e brigadës së Zonës III të TMK-së, e cila ka emrin e tij. Njëherësh u përkujtua edhe 5- vjetori i formimit të brigadës 331 dhe 21-vjetori i vrasjes së vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zekës. Komandanti i brigadës, nënkoloneli Rasim Agushi, tha për Jusufin se ai, bashkë me shokët e tij, ishte zëri i kushtrimit për lirinë e Kosovës, duke kujtuar 17 janarin e vitit ‘89, kur në varreza të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit në Shtutgard ishin tubuar më shumë se 60 mijë shqiptarë, jo vetëm për të bërë homazhe, por edhe për të dhënë besën për të luftuar për lirinë e Kosovës. Nënkolonel Agushi përkujtoi edhe, siç tha ai, epopetë e lavdishme të luftës së madhe për liri të djelmoshave nga Dukagjini, që ishin rreshtuar në brigadën heroike “Jusuf Gërvalla”. “U ndez flaka e lirisë, që mori forcë në orën e madhe të lavdisë në Prekaz për t’u shpërndarë fuqishëm në Dukagjin e kudo në Kosovë”, tha komandanti, duke shtuar se thënia o vdekje o liri, u bë moto e mijëra bijve e bijave që ishin rreshtuar në radhët e UÇK-së në luftë kundër soldateskës serbe, së cilës po i printe komandanti, gjeneral Daut Haradinaj. Për jetën dhe veprën e Jusuf, Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës foli dr. Xhavit Aliçkaj. “Si gazeta e tij, lajmëtar i lirisë u bë bashkë me shokët”, tha Aliçkaj, duke shtuar se zëri i tyre u dëgjua larg dhe i tregoi botës demokratike se shqiptarët e Kosovës jetojnë të shtypur e pa të drejtat më elementare. Safete Shala në emër të familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, ka nderuar familjen Gërvalla dhe ka lartësuar kujtimin për dëshmorët. Komanda e brigadës 331 “Jusuf Gërvalla” ka ndarë mirënjohje të veçanta për familjen Gërvalla dhe për gjeneralin Daut Haradinaj. “Në nderim të kontributit të madh dhe trimërisë gjatë përpjekjeve për lirinë e Kosovës dhe për kontributin e dhënë për sukseset e shumta të kësaj brigade”, thuhej në mirënjohje.

43. HYSEN GËRVALLA INTERVISTOHET NGA GAZETA *BOTA SOT*

Intervistë dhënë Jusuf Ferizit për 'Bota Sot' nga 10-16 mars 2003

«DIKTATORI HOXHA ISHTE KUNDËR LËVIZJES KOMBËTARE»
HERETIZIM E LEQITJE
“EMISARËT SPECIALË” TË PATRIOTIZMËS!

VRASËSE ËSHTË SERBIA E NDIHMUAR MGA SHQIPFOLËSIT
KURRKUSHAT DHE KARAKUSHAT
VETËM KARAKUSHAT MUND TË JENË KURRKUSHAT!
NËNSHKRUESIT E APELIT '99
HAGA ËSHTË TEMPULLI I DREJTËSISË
"MOS QOFSHA NË LËKURË TË DEMËS-Demaçit **E TË QOSJES"!**
"PERANDORIA E SË KEQES"
DORËZANËT E CYRIHUT
SHTABI I SHKATËRRIMIT TË PËRGJITHSHËM
EPOKA E ZEZË E NANOMEIDANXHUIT!
GRUSHTSHTETI I 31 JANARIT 1997
LISTAZINJTË
AHMET KRASNIQIN E VRAU TRADHËTIA LËPËKËISTE
SHKELJA E MARRËVESHJES SË OSLOS
S'KA TRIMËRI PA FISNIKËRI
VARGU I GJATË I BURRAVE QË I VRAU KRETA
SIGURIMCAT E ENVER HOXHËS
PSE NUK DHA DORËHEQJE HALIL BICAJ?
VOTA E LIRË ËSHTË FJALA E ZOTIT
SHQIPTAROFOLËSIT SERBO-GREKË !
KUSH PO BËN SHALLTITROME ME HERONJTË?
VOTA E LIRË

«DIKTATORI HOXHA ISHTE KUNDËR LËVIZJES KOMBËTARE»!

Si bashkëpunonin natën e shaheshin ditën Shqipëria e Jugosllavia? Pse Tirana e Enverit e quajti tradhti kombëtare raportin e Jusuf Gërvallës dërguar Amnesty International!? Çka dinë për atentatin e 17 janarit 1982 Saime Jusufi, e njohur si «Bule», Hasan Mala i njohur si «Plaku» dhe Ibrahim Kelmendi? Kush e Themeloi «Komitetin Revolucionar» për likuidimin e vëllezërve Gërvalla? Kush është Hysen Gega?

HERETIZIM E LEQITJE

« BOTA SOT » Zoti Gërvalla, para se të vijmë te ai 17 janari i kobshëm 1982, çka dini për ngjarjet që i paraprinë këtij atentati makabër në Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën?

Hysen GËRVALLA: Shtëpia jonë kishte një biografi të moçme. Për çdo regjim të huaj ajo ishte e heretizuar dhe e leqitur. Ishim të përndjekurit e të pesë regjimeve, duke u nisur nga ai turk, malazias, serb, nga mbretëria serbe e deri te Jugosllavia e Titos. Mbaj mend mirë kohën e regjimit të Rankoviqit kur OZNA dhe UDB-a ishin porositur të na mbajnë nën mbikëqyrje dhe rrethim të përhershëm, duke na akuzuar, madje, edhe për veprimet e burrave të Gërvallajve kundër Perandorisë Osmane.Të gjithë brezat e kësaj familjeje kanë qenë të ballafaquar me padrejtësi, presion, dhunë dhe biseda të pandërprera hetimore policore. Familjen tonë e përcollën burgosjet, dënimet e rënda deri edhe me vdekje. Na u pat marrë edhe toka e trashëguar den-baba-den me anën e asaj "reformës agrare", si dënim i "kaçakëve" që kishin vepruar kundër Jugosllavisë. Kjo e kaluar e rendë por krenare për Gërvallajt ia ka lehtësuar Serbisë të ndërmarrë edhe aktin e vrasjes se Jusufit dhe Bardhoshit. Kuptohet, nëse i ka vrarë vetëm Serbosllavia. Jeta e rendë plot vuajtje e

krajata na kishte vënë në lëvizje të pandërprerë kur u detyruam të marrim edhe rrugën e kurbetit .Mos të harroj. Gjatë tërë asaj kohe të rendë si plumbi, Jusufi e Bardhoshi ushqenin shpirtin e tyre me muzikë, duke i kënduar me kitarë komponimet e kohës, ato të Johan Lennonit, si "Let it Be, "Yesterday" etj, të cilat ndikuan ne kalitjen e shpirtit të tyre, deri në ditën e vrasjes.

"EMISARËT SPECIALË" TË PATRIOTIZMËS!

As Jusufi, as Bardhoshi nuk ishin avanturierë. Që të dy kanë patur talent edhe për muzikë, edhe për politikë. Kanë qenë shumë të vëmendshëm. Dhe kur e panë se pakkush ishte i gatshëm të kacafytet me përbindëshat (Shqipëri e Enverit e Jugosllavi e Rankoviqit) që natën bashkëpunonin e ditën shaheshin, i përvolen mënget dhe u futen të gjallë në zjarrin që përvëlonte.

Pasi dolën në Perëndim bënë përpjekjet e para për dialog kombëtar e njerëzor me "krerët" e OMLK-së dhe të grupimeve tjera që u përngjanin tufave të deleve, duke u përpjekur t'i ofrojnë mërgimtarët, t'i largojnë nga kursi ideologjik, në mënyrë që të viheshin të gjithë në binarë kombëtarë. Fatkeqësisht, gjithë këto përpjekje dështuan, sepse tufat e deleve që i kishte organizuar Enver Hoxha nëpër kruzhoqet partiake, ishin me tru të shpërlarë. Megjithatë, Jusufi e Bardhoshi nuk u ndalen. Dhe, deri në ditën kur u vranë nuk pushuan së insistuari për një pajtim të arsyeshëm e të qytetëruar. Sa miope ishte politika e Enverit që ishte ngulitur në kokat e këtyre tufave njerëzish, për ilustrim, ja vetëm një shembull. Jusuf Gërvalla i kishte dhënë shënime Amnesty International mbi shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë. Këtë raport të parë dorëzuar një organizate ndërkombëtare, Tirana e asaj kohe e quajti "tradhti ndaj çështjes kombëtare".

Pushkës që vrau Jusufin e Bardhoshin ia kanë hapur rrugën me raportet e tyre që shqipfolësit ia dorëzonin UDB-së. Deri me sot opinioni disponon me disa fakte. Gjatë takimeve të LNÇKVSHJ-së (Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla) me përfaqësues zyrtarë të Tiranës, doli hapur se diktatori Enver Hoxha nuk ishte i interesuar për forcimin e Lëvizjes Kombëtarë, por për formimin dhe zgjerimin e organizatave komuniste në diasporë. Për këtë shkak dështojnë edhe bisedimet për bashkim në mes të Lëvizjes Kombëtare të Jusufit dhe OMLK-së se Hidajet Hysenit, që u mbajtën në Stamboll në tetor të vitit 1981. Pra kundër Lëvizjes se Jusuf e Bardhosh Gërvallës nuk ishte vetëm UDB-a por edhe Sigurimi i Tiranës. Atëbotë, në Perëndim vepronin edhe disa grupe me orientime të ndryshme, si Lidhja e dytë e Prizrenit, Lëvizja për Shqipërinë etnike, mirëpo krerët e këtyre grupimeve nuk ditën kurrë ta ndajnë shapin prej sheqerit, andaj as nga këto grupe nuk u prit mirë dalja në skenën politike të diasporës e Jusuf Gërvallës. Dhe në atë moment kur Jusufi e Bardhoshi e kuptuan se çlirimi i Atdheut nuk mund të bëhet nëpërmes "emisarëve specialë" të patriotizmës, që lansoheshin nga ambasada të ndryshme dhe nga vetë ambasada e Shqipërisë, ata u rrezikuan hapur nga qendra ideologjike e krimit me seli ne Tiranë, Beograd e gjetiu. Jusuf Gërvalla do të rrënonte kullën prej kartoni që e kishte kurdisur Enver Hoxha në bazat e ideologjisë marksist-leniniste në diasporën shqiptare.

VRASËSE ËSHTË SERBIA E NDIHMUAR MGA SHQIPFOLËSIT

"BOTA SOT": Të kthehemi tani te atentati i 17 janarit të kobshëm. Deri me tani dihet se në vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës kanë marre pjesë, përpos UDB-së jugosllave, edhe Sigurimi i Tiranës. Mirëpo, anonimati akoma mbretëron mbi këtë atentat. Pse?

Hysen GËRVALLA: Përsa i përket edhe Sigurimit të Tiranës, si i involvuar në këtë atentat, keni plotësisht të drejtë. I një rëndësie të veçantë është fakti se Tirana zyrtare ishte kundër çdo organizimi të diasporës sonë në baza kombëtarë. Dhe fakti tjetër që nga themelimi i tij, Sigurimi i Tiranës ka ekzekutuar pa fije hezitimi njerëzit me eminentë bashkë me familjet e tyre.

Sa i takon anonimitetit, deri më sot dihet se Serbia është ajo që nuk ndihet e fortë për ta shpalosë këtë vrasje. Pa fije dyshimi janë edhe disa shqiptarë që kanë ndihmuar për t'u kryer ky atentat.

"BOTA SOT": Si u gjenden këta tre dëshmorë të Kombit në një vend ditën e atentatit. Si ndodhi që bashkë me Jusufin e Bardhoshin të vritej edhe Kadri Zeka i cili i takonte OMLK-së se udhëhequr nga Hidajet Hyseni?

Hysen GËRVALLA: Si dhe pse shkoi Kadri Zeka në Gjermani për t'u takuar me Jusufin ditën e atentatit, në këtë pyetje kanë obligim historik t'i përgjigjen familjes Zekaj, por edhe familjes Gërvallaj, shoqja dhe shokët e Kadri Zekës, e këta janë Saime Jusufi e njohur si “Bule”, Hasan Mala, i njohur si "Plaku"' dhe Ibrahim Kelmendi, shok i Kadri Zekës. Pas tyre vije edhe Faredin Tafallari.

"BOTA SOT": Është shkruar disa herë për njëfarë "Komiteti Revolucionar" për likuidimin e vëllezërve Gërvallaj!

Hysen GËRVALLA : Është e vërtetë se ka ekzistuar ai farë "Komiteti Revolucionar" i përbërë nga një grup njerëzish të organizuar. Sa di unë udhëheqës i këtij "Komiteti" ka qenë Riza Salihu nga fshati Mushtisht, ndërsa Ibrahim Kelmendi ka qenë njëri ndër udhëheqësit e atij farë "Komiteti" të famshëm. Nuk është aspak me rëndësi cili është i pari apo i dyti. Nga ky "Komitet" Hysen Gega është caktuar për të bërë atentat në Jusuf Gërvallën. Hysen Gegës iu kam drejtuar publikisht për sqarime, pa e akuzuar fare. Përkundrazi, familja Gërvallaj, Hysen Gegën e konsideron viktimë, e kurrsesi fajtor. Këtij njeriu ju kam falenderuar që ia zgjati pak jetën Jusufit, duke refuzuar detyrën që kishte marre nga ai farë "Komiteti". Falenderimi im atij nuk i ka bërë përshtypje. Ndoshta ai ka akoma ndalesa për t'u takuar me familjen tonë, kush e di? Sidoqoftë, familja jonë e falenderon atë për moszbatimin e urdhrit të "Komitetit Revolucionar".

KURRKUSHAT DHE KARAKUSHAT

A janë Jusuf Karakushi e Bashkim Hisari pjesëtarë të ekipeve speciale të Serbisë për vrasjen e vëllezërve Gërvalla? Cilët janë kurrkushat e Karakushit? Pse tentai Zenun Çelaj të rehabilitojë Jusuf Karakushin? Pse heshtin nënshkruesit e Apelit? Pse tolerohen paraqitjet publike të Shkëlzen Maliqit, kur dihet se i biri i kujt është? Pse shqiptarët duhet të bashkëpunojnë me Gjykatën e Hagës? Pse duhet të shkojnë ne Hagë ata që kanë bërë krime

VETËM KARAKUSHAT MUND TË JENË KURRKUSHAT!

"BOTA SOT": Zoti Gërvalla, cilët janë vrasësit e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës?

Hysen GËRVALLA: E, kjo është një pyetje tjetër. Do të përgjigjem shumë shkurt: Jusufin, Bardhoshin dhe Kadri Zekën i ka vrarë Jugosllavia, me konkretisht, Serbia, me

ekipe speciale të vrasësve, të ngarkuar me detyra për t'i lehtësuar Serbisë shtrirjen e sigurt mbi trojet etnike shqiptare. Vetvetiu, shtrohet pyetja tjetër plotësuese: A ka pasur shqiptarë në ato ekipe famëzeza speciale të vrasësve? Atëherë është folur për Jusuf Karakushin dhe Bashkim Hisarin, por edhe për disa të tjerë. Ndërsa sot, nëse i analizojmë vetëm pak sjelljet e disa "shqiptarëve", si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, se ka shumë sish, siç do t'i quaja unë, kurrkusha të Karakushave që janë shumë të rrezikshëm, e të cilët i bashkon vetëm një tipar - ai i krimit, i krimit pra, i cili, nëse na do Zoti, nuk do të ecën gjatë si ai kungulli mbi ujë.

"BOTA SOT": Një e përditshme e Prishtinës, e quajtur "Zëri", para sa ditësh botoi një bisedë të gjatë në shumë e shumë vazhdime me Jusuf Karakushin. A mund të quhet ky tentim për rehabilitim të një ish-kryepolici të Kosovës?

Hysen GËRVALLA: E kam lexuar ndonjë pjesë të asaj bisedë të dhunshme maratonike që e bëri Zenun Çelaj. Tentim rehabilitimin e Jusuf Karakushit nga një gazetar, sic i thotë vetes veteran, Kosova nuk ia ka pasur borxh Zenun Çelajt të Vuthajve. Fjalët boshe për larje duarsh si Pilati të "rrushave", kurrkushave dhe Karakushave, që, fatkeqësisht nuk janë pak, nuk çojnë peshë, sepse të gjithë madhorët, që nga viti 1981, i dinë shumë mire të gjitha gjërat. Le të thonë Karakushat dhe kurrkushat e tyre sa të duan, le të bërtasin sa të mundën se "forcat progresive" "kanë bërë shumë ", por mos të harrojnë se opinioni i Kosovës e di mirë se ato "força progresive" kanë krijuar hapësirë sot për t'i ladruar kuajt e vet, fatkeqësisht edhe të një Shkëlzen Maliqi, i cili, po të ishte normal, nuk do ta dhunonte që plot 13 vjet opinionin e gjorë me paraqitjet e tij të rezervuara në RTK- në e mjerë të Agim Zatriqit. Këta pinjoj të etërve gjakatarë do të duhej të skuqeshin para popullit të vet. Për ata që shohin me dy sy, Shteti i Pavarur i Kosovës, i inicuar para me se një dekade nga dr. Ibrahim Rugova, është i pashmangshëm. Ne emër të Zotit, nga varret do të ngriten të vrarët nga dora tradhtare dhe do të kërkojnë drejtësi. Vrasësit dhe shtisit e tyre i pret Ligji i drejtësisë se Shtetit të Kosovës, i pret edhe ligji i Kanunit, edhe përkundër vullnetit të Shkëizen Maliqit, bir i një satrapi të njohur. Sepse, ligji më i rëndë se të gjitha kodet është lënia e trashëgimtarëve ne bela të panevojë.

"BOTA SOT": Populli thotë: «Për pa gjak më vret kollaj, priti burrat masandej»!

Hysen GËRVALLA: Ne Gërvallajve nuk na ngutet. Vëllezërit tanë nuk u vranë për vadë uji, as për gur mexhe. Ata u vranë si bij të çështjes kombëtare. Ne presim ligjin e drejtësisë se shtetit të Kosovës. Sepse çështjen tonë nuk e vjetrojnë as dekadat as shekujt. Shumë herë gjatë shekujve jemi vrarë tinëzisht nga dora e tharë, por askush nuk na ka mbetur borxh. Po e them, për hatër të Shkëlzen Maliqit, se vrasja tradhtare që i përbiu djemtë tanë të paharrueshëm, nuk vjetrohet kurrë. Ajo mbetet amanet i varur në baski të kullës sonë në Dukagjin.

NËNSHKRUESIT E APELIT '89

"BOTA SOT": Si nuk i provokoi nënshkruesit e Apelit '89 gjithë ai rrëfim i Karakushit në "Zëri"?

Hysen GËRVALLA: Gilgameshi i para 5 mijë vjetëve para p.e.re, ka porositur: "Harroje vdekjen, tmerrin s'do ta ndiesh"! Edhe mbreti ynë Bardhyli, sikur të ishte i një gjaku me Gilgameshin, s'është për të na çuditur ndonjë lidhje mijëra shekullore iliro-pellazgo-sumere, i porosiste luftëtarët e vet: "Vraje vdekjen!" Unë nuk po ju them shqiptarëve

vrajeni vdekjen, por vrajeni frikën. Frika të çon në varr" para vaktit. Nëse Jusuf Karakushi është nënshkrues i vendimeve për arrestimet tejet misterioze të disave nga autorët e atij Apelit të njohur të intelektualëve shqiptarë, dhe nëse ata të arrestuar u desh të kalojnë nëpër shumë rrathë të ferrit duke u poshtëruar deri në mosqenie, për derisa këto arrestime nuk i bëri publike Janez Dernovsheku, ish -kryetar i Kryesisë së ish-RSFJ-së, atëherë prej kujt kanë të frikësohen ata intelektualë që nuk i bëjnë publike dhunimet e mynxyrshme që i përjetuan. Sikur të kishte qenë normal Jusuf Karakushi i Zenun Çelës, atëbotë, ai i ka pasur vetëm dy mundësi: ose të vendosë me gjysmëkokën e tij për mosnënshkrimin e atyre vendimeve. ose të japë dorëheqje. Aq me pare kur e kanë ditur edhe fëmijët se ne vitet '90-ta Jugosllavia i kishte ditët e numëruara.

HAGA ËSHTË TEMPULLI I DREJTËSISË

"BOTA SOT": Siç jeni informuar, këto dite për ne Hagë u nisën edhe katër shqiptare të Kosovës. Hiç reagimin prej burrit të shtetit të Presidentit Rugova, një pjesë e madhe e reagimeve të krerëve të Kosovës janë plot me emocione.

Hysen GËRVALLA: Ne përgjigjen e kësaj pyetjeje do të përpiqem të jem shumë i qartë. Asnjë shqiptar i shtetit të Kosovës nuk duhet të harrojë për asnjë qast, se ne vetë, shqiptarët pra, e kemi kërkuar NATO-n ne Kosovë, dhe këtë gjatë disa vjetëve me radhë. T'i kundërvihesh NATO-s dhe UNMIK-ut, siç ndodhi një aksident në protestat në Skënderaj, është njëlloj sikur t'i kundërvihesh vetvetes. Bashkë me NATO-n dhe Amerikën, shqiptarët e Kosovës kanë përshëndetur njëzëri themelimin e Gjykatës së Hagës për krime lufte te ish-Jugosllavisë, pra edhe në Kosovë. Ata që kanë shkuar në Hagë, nuk kanë shkuar në ferr. Nëse e dëshmojnë pafajësinë, prej andej do te vijnë edhe me të fuqishëm. Reagimet emocionale siç ishin lotët e kryeministrit, apo do farë "garancish" të kryeparlamentarit Daci për mundësitë e zhvillimit të procesit gjyqësor në Kosovë kundër te dërguarve në Hagë, nuk janë gjë tjetër pos emocione. Shqiptarët duhet të bashkëpunojnë me Gjykatën e Hagës, sepse, në njëfarë mënyre, pas kroatëve, boshnjakëve e serbëve, ajo është edhe Gjykatë jona. Hagës nuk duhet t'i frikësohet askush. Hagës mund t'i frikësohen vetëm fajtorët, vetëm ata që kanë bërë krime. Nëse ka te tille ata nuk mund t'i mbrojë as kryeministri as kryeparlamentari i Kosovës. Sepse Haga nuk është Gjykatë politike. Aty dënohet vetëm krimi. Çdo manipulim me elektoratin ne emër te "pafajësisë" se atyre që kanë shkuar në Hagë është manipulim me veten tonë, manipulim me të gjitha proceset demokratike që po zhvillohen ne Kosovë.

"MOS QOFSHA NË LËKURË TË DEMËS-Demaçit E TË QOSJES"!

Si i shfrytëzoi Serbia budallalleqet e Demës-Demaçit dhe të Qosjes, përkatësisht si i braktisi populli këta dy "baballarë"? Qëllimet majtiste janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç e mendon tradhtia, ose të mos formohet fare shteti i Kosovës! Pse po vijnë dite të liga për ata që u morën me punë të këqija? Pse nuk u zgjodhën në ShP të UÇK-së Sali Çeku, Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti? Kush po e mbush tokën me varre të reja?

"PERANDORIA E SË KEQES"

"BOTA SOT": Hapi me tragjik për ringjalljen e "Perandorisë të së keqes" ndër shqiptarë u bë në mars të vitit 1993, i njohur si "Marrëveshja e Cyrihut", me ç'rast stalinistët e Shqipërisë (PSSH) dhe lëpëkëistët e Kosovës lidhen marrëveshje për bashkëpunim dhe ndihmë reciproke!

Hysen GËRVALLA: Do të jem shumë konkret. Kjo marrëveshje famëkeqe parashihte ndihmën financiare që do t'i jepte LPK-ja PSSH-së për ta rrëzuar Sali Berishën, ashtu siç edhe ndodhi, ndërsa, stalinistët e Shqipërisë, pasi ta mernin pushtetin, do t'u vinin ne ndihmë stalinistëve kosovarë për ta rrëzuar Rugovën, gjë që tentuan dhe po tentojnë ende, por që fatmirësisht, falë vetëdijes se lartë kombëtare të shqiptarëve të Kosovës, nuk ia arritën dhe nuk do t'ia arrijnë kurrë.

Humbja e Adem Demës-Demaçit të pasburgut ne politikën e Kosovës është ajo pushka me e rende, kur njeriu e vret veten me dore të vet. Të bëhesh pjesëmarrës i një marrëveshjeje që gati fshiu nga harta gjeografike Shqipërinë e vitit 1997 duke djegur Kosovën anembanë, në psikiatri quhet neronizëm.

Budallallëqet e Demës-Demaçit dhe të Qosjes i shfrytëzoi e po i shfrytëzon Serbia ne mënyrë shumë racionale. Megjithatë, mrekullia ndodhi: populli i braktisi Demën-Demaçin dhe Qosjen, këta dy "baballarë" të kombit. Ku janë sot Dema-Demaçi dhe Qosja? Thoshte Jusuf Gërvalla: "Çdo gjë që bazohet ne rrenë e ka jetën e shkurtër". Ashtu ndodhi edhe me Demën-Demaçin e Qosjen. Mos ta harrojmë historinë. Pati tradhti edhe në kohën e Skënderbeut, edhe në kohën e Lidhjes së Prizrenit, edhe në të 12-dhjetën sene. Mirëpo, edhe pse na dëmtuan mjaft tradhtitë e njëpasnjëshme, ato nuk arritën të triumfojnë asnjëherë ne atë masën e dëshiruar të tyre, ne atë masën e programeve shekullore gjenoçidiale ndaj shqiptarëve. Këtyre programeve u përket edhe ajo marrëveshja famëkeqe e Cyrihut, ku u bë tentimi i hapur për restaurimin e "Perandorisë të se keqes" siç e quante presidenti Regan, perandorinë e komunizmit lindor.

"BOTA SOT": Argatët e këtyre programeve ogurzeza kanë zënë sot edhe poste ne Kosovë.

Hysen GËRVALLA: Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës. Ato pozita që i kanë zënë nuk ua lakmon asnjë shqiptar normal, sepse vetëm një Zot e di me çfarë do të përballen ata. Unë për vetë mund të them vetëm kaq: mos qofsha në lëkurë të Demës-Demaçit e të Qosjes, e as të atyre pak argatëve që u kanë mbetur.

DORËZANËT E CYRIHUT

"BOTA SOT": Zoti Gërvalla, "Marrëveshja e Cyrihut", e cila parashihte të bëjë Shqipërinë një Liban të dytë, ndërsa Kosovën një Palestine të Evropës, është ende në fuqi. Është publikuar se kujdestarë të përherëshëm të saj janë: Fatos Nano ne Tiranë, Xhavit Haliti ne Prishtinë dhe Ibrahim Kelmendi ne diasporë!

Hysen GËRVALLA: "N'komë jon çu' ni rrem komitë, me vra shqiptarë e me plaçkitë"!... Sikur lufta të ishte e mire do ta quanin ndryshe, po e zëmë, dasmë. Lufta nënkupton të gjitha të papriturat, të gjitha të këqijat. Jam optimist se të gjitha këto të papritura do të kalohen. Dite të liga po duken në horizont për të gjithë ata që u morën me punë të këqija, me punë antikombëtare. Ata që kanë punuar keq do të vazhdojnë edhe me tutje. Besa ata kanë edhe mjete të mëdha materiale, e kanë me vetë edhe Rusinë, edhe Serbinë, edhe

Greqinë. Kanë edhe një shtresë të popullit të pasherr me të cilën manipulojnë pamëshirshëm. Asgjë e re. Pse? Sepse e njoh popullin tim. Ishin kohërat kur ishim shumë me të dobët, kur njerëzit tanë të ligj ishin disa herë me të forte se ne, sepse ishin të lidhur ngushtë me okupatorin. Populli ishte i rrethuar me vdekje, kurse ata të ligjtë tanë i mbronte Serbia. Dhe jo vetëm e mbijetuam atë ferr, por edhe triumfuam në saje të ndihmës madhore amerikane. Nuk thotë populli kot: "Miku i forte është para Zotit"! Erërat amerikane po fryjnë tani pak me shlirshëm edhe në Shqipëri. Shqiptarët për herë e me të fuqishëm po e identifikojnë veten me Amerikën. Mire është kjo. Kombi shqiptar kurrë nuk ka shkelur në të mirën që ia ka bërë miku. E majta është duke perënduar bashkë me "Perandorinë e se keqes", e djathta po fuqizohet dhe po admirohet për herë e me shumë ne Perëndim. Qëllimi madhor i shqiptarëve të vdekur dhe të gjallë - pavarësia e Kosovës, është një realitet. Si do ta gëzojmë, ajo varet prej nesh. Mos të harrojmë: ne jemi bijtë e atyre pellazgo-iliro-shqiptarëve, që kanë ditur të bëjnë jo vetëm shtet, jo vetëm mbretëri, por edhe perandori.

SHTABI I SHKATËRRIMIT TË PËRGJITHSHËM

"BOTA SOT": Pse nuk ishin "të besueshëm" Sali Çeku, Adem Jashari e Zahir Pajaziti të zgjedheshin ne "Shtabin e Përgjithshëm" të UÇK-së që e hartoi LPK-ja?

Hysen GËRVALLA: Meqë kishim Të bëjmë me një konflikt shqiptaro-serb programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, si parti evro-amerikane ne fillim parashihte si forme te luftës rezistencën paqësore. Kësaj rezistence te suksesshme dhjetëvjeçare, majtistët i thurën definicione ndër me të çuditshmet. Sali Çeku ishte personalitet i rrallë, i brumosur me një horizont te gjerë njohurish si intelektual. Mbi te gjitha ishte njeri i fjalës dhe i besës. Anën (jeter të rezistencës paqësore, atë të kundërveprimit në momente te caktuara, Sali Çekut ia ka besuar akademik Fehmi Agani. Me të gjitha aftësitë intelektuale dhe profesioniste-ushtarake të Sali Çekut janë admiruar Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti. Aftësitë profesionale-ushtarake që kanë ngërthyer në vete ky tresh i famshëm, nuk i kanë shkuar për shtati atij farë "Shtabit te Përgjithshëm " të UÇK-së. Te gjithë e duam diellin, sepse dielli është jetë, mirëpo askush nuk mund ta shikojë se paku një dite pa ndërprerë gjatë jetës së vet. Si mund te kërkohet nga anëtarët e shtabit te shkatërrimit te përgjithshëm te bashkëpunojnë me njerëz të ndërtimit te përgjithshëm te lirisë dhe te pavarësisë se Kosovës. Në asnjë moment nuk guxojmë ta identifikojmë UÇK-në me atë fare "Shtabin e Përgjithshëm".

EPOKA E ZEZË E NANOMEIDANXHUIT!

Sali Çeku, Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti në asnjë moment nuk kanë qenë të implikuar në strukturat majtiste. Kush kishte kohë të merrej me qëndisjen emblemash? Listazinjtë dhe ekzekutorët e atyre listave i takojnë grupimit të të humburve. Politika lëpëkëiste është plot die të dezakorduara pansllaviste që punojnë për mullinjtë rusë, serbë e grekë. Që nga viti 1912 Shqipëria nuk ka bërë politikë më të keqe sesa në kohën e Fatos Nanos dhe Rexhep Meidanit.

GRUSHTSHTETI I 31 JANARIT 1997

"BOM SOT": A ishte grushshtet i enveristëve kosovarë atentati i 31 anarit 1997 në Zahir Pajazitin?

Hysen GËRVALLA: A ishte grushtshtet vrasja e këtij burri të madh, këtë do a thotë historia pasi te sqarohen rrethanat shumë te dyshimta ne te cilat u krye ky atentat. Një gjë, por është e qartë: pas bllokimit te krijimit te ushtrisë institucionale, që e bënë komplotistët nanoistë, pas vrasjes se Adem Jasharit, me likuidimin e Zahir Pajazitit enveristët kosovarë arritën, jo vetëm te uzurpojnë lëvizjen guerile që e kishte krijuar Sali Çeku, Adem Jashari e Zahir Pajaziti, por edhe ta bëjnë atë plaçkë te Sigurimit te Tiranës. Sali Çeku, Adem Jashari e Zahir Pajaziti për asnjë çast nuk kanë qenë te implikuar ne strukturat majtiste. Këta tre burra te mëdhenj te shoqëruar nga një varg i gjatë bashkëluftëtarësh te tyre morën mbi vete detyrën e shenjtë te krijimit te Forcave te Armatosura te Republikës se Kosovës, të armatës moderne te një shteti te ri që po lindte ne zemër te Dardanisë antike. Me punën e tyre te mbarë plot dinjitet kombëtar dhe me shkathtësitë e talentin e tyre prej luftëtarëve origjinalë shqiptarë, e shenjtëruan fillimin e krijimit te Armatës se Kosovës, dhe atë shenjtëri e qendisën me jetët e tyre. Ata filluan krijimin e mirëfilltë te një ushtrie reale, me te cilën se pari do te mbrohej praku i shtëpisë dhe nderi i familjes, mesazh ky i përsëritur sa e sa herë nga presidenti legjitim Ibrahim Rugova, që nga viti 1991.

"BOTA SOT": Kush është kumbarë i emblemës se UÇK-së ?

Hysen GËRVALLA: Është shumë herët te flitet për kumbarë, sepse duhet te flitet edhe për shumë e shumë kumbarllëqe te njerëzve tanë me okupatorin - ne te gjithë lëmenjtë e jetës, pra edhe te luftës. Ta kalojmë lumin e pastaj... Ne diasporën tonë ne Perëndim ka pasur e ka akoma grupe e grupe që kanë pasur kohë, e kanë edhe sot, te merren me qëndisje emblemash e emblemash. E ardhmja do t'i zbardhë te gjitha. Koha po punon për te mirën e kombit tonë ne përgjithësi. Veprat e burrave që ranë për këtë dhe, si monumente te përjetshme, mbajnë sigurt themelet e çlirimit tonë kombëtar. Dikush po mundohet t'i fshehë këto monumente, por pa sukses. Dielli nuk fshihet... Kosova do te këtë ushtrinë e vet, jo te Hasanit e Hysenit, por ushtrinë reale, patjetër.

LISTAZINJTË

"BOTA SOT": Ne tetor 1997 bëhet publike lista e zezë e të dënuarve me vdekje nga Lëvizja Popullore e Kosovës. Te dënuar shpallen Ibrahim Rugova, Bujar Bukoshi, Fehmi Agani, Sabri Hamiti, Enver Maloku, Zekeria Cana...

Hysen GËRVALLA: Në mesin e popullit tonë ka jo pak njerëz me defekte mentale e që hyjnë ne kategorinë e një rrezikimi të veçantë. Defektxhinjtë mentalë e kanë përcjellë historinë tonë dhe, ne momente vendimtare, kanë paraqitur pengesë serioze për realizimin e aspiratës shekullore që quhet pavarësi. Sipas asaj thënies "Me të mirën udhëton edhe e liga". Defektxhinjtë e këtillë, ne momentet me kritike për kombin, kanë arritur të vrasin burrat me të njohur të dheut të Kosovës. Unë mendoj se ekipet e përpiluesve të listave të zeza, se bashku me ekzekutorët, i takojnë grupimit të të humburve. Ky grupim humbëtar, me pamje njeriu, por me shpirt herë të qenit, herë të zagarit, nuk e njeh as vetveten. Ky farë njeri-qen, i edukuar ne bodrumet e literaturës vrastare të Enver Hoxhës, nuk është fare i vetëdijshëm se çfarë borxhi u ngarkon mbi supe bijve, nipave dhe stërnipave që le

prapa. Me këto akte ogurzeza ata ngatërrojnë për jetë të jetëve, pa të drejtë, pasardhësit e tyre edhe me Ligjin e Shtetit të Kosovës, edhe me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Pasardhësit e tyre do të jenë të dënuar ne të ardhmen të çojnë jetë qeni, gojëmbyllur e kokulur para shtetasve të Kosovës, brez pas brezi. I mjerë e tragjik për mua është rënia edhe e ndonjë mësuesi, profesori e akademiku ne nivelin e shokëve të idealit të LPK- së, dhe këtë, për një grusht frangash apo markash të ndyra. Këta vrasës tinëzarë që thajnë krahët e atyre që dhanë çdo gjë për dheun e Kosovës, s'janë gjë tjetër pos farë e huaj, farë sllavo-karpatiane. Politika e LPK-së është plot e përplot ide të dezakorduara pansllaviste që çojnë ujë ne mullinjtë rusë, serbë e grekë. Për këto lista të zeza dinë edhe Dema-Demaçi e Qosja, por asnjëherë nuk ditën që, makar edhe me një fjalë, të gjykojnë këtë të zezë të madhe të kombit tonë. Heshtja e tyre nuk është as me pak e as me shumë se miratim i akteve të ekipeve vrastare.

"BOTA SOT": Pas takimit të Kretës, vrasjen e Kosovës ne Tiranë e bëri publike Fatos Nano, kur tha për Milosheviqin: "Njeriu që bën luftë, di të bëjë edhe paqe"! Kësaj vrasjeje të Kosovës ne Tiranë i ndihmoi edhe Qosja me deklaratën e njohur të lij: "Shqipëria zyrtare ka një vite sa që bën polilikën e duhur" (janar 1998)!

Hysen GËRVALLA: Qosja e di mire se krimi i organizuar ne Shqipëri ka qëllime kryekëput politike e tradhtare. Edhe njëherë me duhet ta përmendi Neronin. Ai e dogji Romën kur ishte i gjithëpushtetshëm. E dogji sepse ishte marrëzisht i dashuruar ne të dhe nuk mund ta mente me mend t'ua le trashëgim pasardhësve. Nano, Meidani, Qosja e Dema-Demaçi nuk e përmbytën Shqipërinë, nuk e dogjën Kosovën, për arsye se i donin ato. Ata e bënë këtë për pushtet, për një grime pushtet, sepse ishin të papushtetshëm. Qosja e Dema-Demaçi e dinë, mirëpo dashuria shtazarake për pushtet nuk i le të pranojnë se që nga vid 1912 Shqipëria nuk ka bërë politike me të keqe sesa kjo që bënë Nano e Meidani. Koha e udhëheqjes se këtyre dy neronëve shqiptarë mund të quhet lirisht epokë e zezë e Nanomejdanxhiut. Qosja e Dema-Demaçi e dinë po ashtu se kanë punuar për ta shpëtuar tradhtinë. Që nga viti 1945 shteti shqiptar nuk e ka kryer asnjë obligim ndaj Kosovës dhe viseve tjera shqiptarë të ndara me dhunë nga ama. Rexhep Qosja e di mire se politika e Fatos Nanos shkel mbi gjakun e të gjithë shqiptarëve të ndarë padrejtësisht nga Atdheu, duke përfshirë këtu edhe Çamërinë. Qosja dhe Dema-Demaçi e dinë po ashtu se shumë varre gjatë luftës dhe të gjitha varret e reja të pasluftës janë produkt final i politikës se Nanomeidanxhiut.

AHMET KRASNIQIN E VRAU TRADHËTIA LËPËKËISTE

Si u luajtën një mijë e një hile e dredhi për ta tradhtuar Ahmet Krasniqin? Si ia hapi rrugën Adem Dema-Demaçi depërtimit të vëllezërisë së hilexhinjëve në ministrinë e Mbrojtjes? Pse Xhavit Haliti, Ibrahim Kelmendi dhe lëpëkëistë të tjerë janë lodra fëmijësh në duartë e Tiranës kuislinge-kukullë e Greqisë dhe Serbisë? Pse nuk prononcohet Bukoshi për bllokadën e ministrisë së Mbrojtjes?

SHKELJA E MARRËVESHJES SË OSLOS

"BOTA SOT": Marrëveshja e Osllos që u arrit me 21-23 maj 1998 në mes të Ahmet Krasniqit dhe Adem Demës-Demaçit parashihte formimin e një subjekti ushtarak me një shtab komandues që do të quhej FARK. Pse u prish kjo marrëveshje?

Hysen GËRVALLA: Ahmet Krasniqin, si emër, e njoh qe plot dyzet vjet. Akademinë ushtarake Ahmeti e kreu me sugjerimet e Metush Krasniqit të madh. Me Ahmet Krasniqin për herë të parë jam takuar ne Tiranë kur ishte ministër i Mbrojtjes i Republikës se Kosovës. Biseduam për hile dhe hilexhinj të luftës. Ishte optimist i madh dhe nuk besonte se mund të ketë ndër shqiptarët njerëz te sojit të tillë. Për ta tradhtuar këtë strateg te rrallë ushtarak janë bërë një mijë e një hile e dredhi. Ahmeti i ka besuar shumë Adem Demës-Demaçit si bashkëluftëtar i Metush Krasniqit. Në saje të këtij besimi na del se Adem Dema-Demaçi ka qenë i vetmi personalitet nëpërmes te cilit hilexhinjtë do të depërtonin te pozicionoheshin në brendinë e besimit te kolonelit. Kreatorët e tradhtisë kanë pasur informata të sakta për lidhjet sentimentale Dema-Demaçi-Krasniqi gjatë kohës së robërisë se tyre. Pa Demën-Demaçin lëpëkëistët nuk do të mund ta realizonin tradhtinë – pra shkeljen e Marrëveshjes se Oslos. Është kjo tradhti që duhet ta kthjellojnë gjyqet ushtarake te shtetit te Kosovës. Demës-Demaçit duhet t'ia kemi lakmi se si nuk ia ndien fare edhe për punët më të ndieshme të historisë sonë.

"BOTA SOT“ Nga kjo që thatë del se lëpëkëistët e bllokuan Minisirinë e Mbrojtjes se Republikës së Kosovës ne Tiranë.

Hysen GËRVALLA: Xhavit Haliti, Ibrahim Kelmendi e lëpëkëistë të tjerë si këta, janë lodra fëmijësh në duart e Tiranës zyrtare. Pa urdhrin e Serbisë, Greqisë e Rusisë nuk ka mundur të ndodhte bllokada, aq me parë kur kemi të bëjmë me një epror të rrallë të rangut të Ahmet Krasniqit, i kalitur moralisht, i edukuar qysh ne fëmijëri kundër shkaut, dhe i përgatitur me një aftësi të paparë profesionalo-ushtarake. Te njëjtat bllokada i kurdisen edhe kolonelit Tahir Zemajt, këtij strategu ushtarak që vështirë da ta lindë Kosova. Kah ka ardhur tërë kjo bllokadë kundër forcave të njëmendta çlirimtare, këtë duhet ta dijë Bukoshi me stafin e tij, i cili është me i përgjegjshmi dhe me i obligueshmi për ta shpalosur te vërtetën.

S’KA TRIMËRI PA FISNIKËRI

"BOTA SOT": Zoti Gërvalla, kush ia shkeli bishtin Bukoshit?
Hysen GËRVALLA: Për të qenë trim duhet të kesh vullnet, ashtu siç duhet të kesh vullnet për te qenë fisnik. Sa i përket FARK-ut ky është një fakt. Faktet tjera duhet kërkuar në legjitimitetin e shpifjeve që iu bënë e po i bëhen kësaj strukture të një ushtrie të mirëfilltë që u konstitua për herë të parë në Kosovën martire, pas asaj strukturës ushtarake që pati krijuar Sylejman Vokshi si ministër i parë i Mbrojtjes pas Lidhjes Shqiptare te Prizrenit. Bukoshit dhe shumë të tjerëve rreth tij shumëkush ua ka lakmi, por edhe zili për atë që u ofroi koha, për atë privilegj me të cilin i nderoi elektorati që zgjodhi Qeverinë, për atë besim te shenjtë ndaj tij. Edhe pse frika ka lindur para njeriut, kryeministri i kohës së luftës duhet ta na sqarojë se kush ishte ai që ia shkeli bishtin. Duhet ta bëjë këtë, sepse edhe populli e zgjodhi me vullnet, edhe Bukoshi me vullnet të madh e përqafoi postin e kryeministrit. Haraçin për moskryerjen e përpiktë të detyrave nga ana e Qeverisë, e pagoi me kokë ministri i Mbrojtjes Ahmet Krasniqi, i pari në histori pas robërisë deceniale nën thundrën e shkaut. Edhe njëherë për fëlliqësirat që bëri e majta kosovare ne bashkëshortësi me te majtën enveriste në Shqipëri. Është interesant se gjatë tërë historisë sonë te mundimshme, sidomos prej se u shpall Pavarësia në Vlorë me 28 Nëntor 1912, në Tiranë është mbajtur pushka e mbushur për të vrare Kosovën në momentet e saj më te vështira. A ka vrasje me te madhe te Kosovës se sa kruzhoqet enveriste të organizuara në Tiranë gjatë luftës, kur djemtë që kishin ardhur edhe nga përtej Atlantiku, për të vdekur për dheun e Kosovës, përpara se t'u jipeshin armët, mbaheshin dy-tri javë në karantinë

për te dëgjuar ligjëratat marksiste - leniniste, dhe për t'u bindur se ata para se të ishin djem te Kosovës, ishin djem te Enverit. Fati i grupeve që u morën me propagande te tille, fati i te gjithë atyre që kolaboruan dhe kolaborojnë edhe sot me këto grupe kriminale e ka vendin ne plehun e historisë sonë.
"BOM SOT": Sërish shtrohet pyetja: pse nuk u njoftua zyrtarisht opinioni i Kosovës për formimin e FARK-ut?

Hysen GËRVALLA: Një arsyetim edhe pse i paqëndrueshëm, ka qarkulluar ato ditë. FARK-u ekziston, por nuk duhet te publikohet për shkak të ndonjë konflikti ndërshqiptar në mes të komandantëve të vetëshpallur që luftonin për pushtet dhe të njësive të armatosura institucionale. Sesa i qëlluar ka qenë formimi i FARK-ut për këtë dëshmon disponimi që mbretëronte në ato dite te luftës kur koloneli Tahir Zemaj shpalli të institucionalizuar Zonën III të Dukagjinit. Për këtë dëshmojnë edhe dy fitoret e mëdha, në mos qofshin edhe më të mëdhatë në tërë luftën që përjetuam, e ato janë Beteja e Loxhës e udhëhequr nga kolonel Tahir Zemaj dhe Beteja e Koshares e udhëhequr nga Sali Çeku e Agim Ramadani, e të cilat u fituan nga brigadat që i kishte formuar Ministria e Mbrojtjes e Ahmet Krasniqit. Pas këtyre dy fitoreve çdo njeri normal e ka te qartë sesa dëm i ka bërë luftës sonë moslegalizimi i FARK-ut si force kryesore ushtarake kundër makinës ushtarake të Beogradit.

VARGU I GJATË I BURRAVE QË I VRAU KRETA

Si u zhvillua ofensiva antishqiptare e agjentëve të bashkuar në Kretë? Kush po I bie daulleve për të bërë, si Sulltani, ”fet” Kosovën në pranverë? Propaganduesit e trepërqindëshit kërkojnë të dinë se kush e vrau Ahmet Krasniqi. Kush e pengoi rikthimin e Tahir Zemës në Kosovë? A ishte Jashar Salihu I mbrojtur nga piramida e kuqe?

SIGURIMCAT E ENVER HOXHËS

"BOTA S0T": Në gjysmën e dytë të vitit 1998, talibanët enveristë fillojnë serinë e terrorit më të paparë deri atëherë në trojet shqiptare. Në një komunikatë të "SHP" të UÇK-së, të shpallur gjatë kohës së atyre atentateve, thuhej: "Gjatë kësaj periudhe kohore u morën masa ndëshkuese ndaj disa elementëve tradhtarë që dëmtuan luftën tonë".

Hysen GËRVALLA: Ishte kjo një ofensivë e agjentëve të bashkuar në Kretë. Ofensivë e kobshme dhe, pothuaj e paparë që nga koha e tradhtisë se Moisiut. Në vargun e gjatë të burrave që i vrau Kreta prijnë emrat e Azem Hajdarit, Ahmet Krasniqit, Enver Malokut... Ky varg tani e ka arritur numrin 20 të personaliteteve më të shquara shqiptare, të vrarë nga, siç po thoni ju, talibanët enveristë. Sa e turpshme është politika sipas të cilës së pari duhet të freskohet populli, e pastaj "shohim e bëjmë"! Kriminelët, qofshin në uniforma apo civile, janë kriminelë. Inicialet e UÇK-së nuk guxojmë t'i identifikojmë me agjentët e Kretës të cilët si mision të parë kishin bastardimin e shenjtërisë së ushtrisë së Kosovës moderne. Është kjo e njëjta qendër agjenturore e cila u përpoq më kot ta bastardojë edhe fuqinë e politikës paqësore të Ibrahim Rugovës. Është po ajo qendër që e dogji Shqipërinë (1997), që e uli këmbëkryq grekun në mes të Tiranës, sikur të mos ekzistonte shqiptar mbi atë tokë. Kryemafiozi i kësaj qendre agjenturore, që quhet Fatos Nano u tha shqiptarëve të Kosovës se "kryeqyteti juaj është Beogradi", dhe për ta realizuar edhe këtë mision, ai ka organizuar sot SHISH-in në çdo skaj të Kosovës. Këta sigurimca të Enver Hoxhës, me do farë leckash, siç janë agjentët e tipit të Idajet Beqirit, këto ditë, po u bijnë

daulleve se ne këtë pranverë si në kohën e Sulltan Muratit do ta bëjnë "fet" Kosovën!- duke ia dorëzuar Beogradit.

"BOTA S0T": Si do të përfundojë kjo aventure?

Hysen GËRVALLA: Në mënyrë të turpshme, shumë të turpshme, si çdo aventurë, si çdo tradhti tjetër e fabrikuar në vegshin e tmerrshëm të ideologjisë enveristë. Populli tani është vetëdijësuar edhe në Kosovë, edhe në Maqedoninë Shqiptare, edhe ne Kosovën Lindore. Ai i ka kuptuar mirë lojërat që u bënë me të, mashtrimet që iu ofruan dhe tradhtinë më të madhe në historinë tonë të gatuar ne Kretë. Ata që ëndërrojnë ta bëjnë "fet" Kosovën do të përfundojnë në muzeun e historisë sonë si tradhtarët më të mëdhenj të Kombit.

PSE NUK DHA DORËHEQJE HALIL BICAJ?

"BOTA SOT":A keni dëgjuar për këtë deklaratë të ministrit të Brendshëm të Republikës se Kosovës, Jonuz Tërstenës: "Prokuroria e Tiranës i ka pezulluar hetimet hidhur me vrasjen e Ahmet Krasniqit, sepse prapa këtij akti terrorist fshihet një klan i madh politik shqiptar në Shqipëri dhe në Kosovë"?

Hysen GËRVALLA: Në një bisedë që kam pasur me Tërstenën, më ka pasë thënë: "Bac, jam i vështirë. Nuk lejoj askënd të bjerë nëpër arat e mia." U gëzova se paskëshim një ministër të Brendshëm të zotin. Ky gëzim nuk zgjati shumë. Ahmet Krasniqi u vra. E ti ku ishe more zoti Tërstena, që me pati thënë se nuk lejon kënd të bjerë nëpër arat tua?! Edhe Ahmet Krasniqi ishte argat në atë arë. Si ndodhi kjo? Pse nuk e pengove vrasjen? Për këtë arsye të gjithë parapaguesit e trepërqindëshit kërkojnë me të drejtë të sqarohet konkretisht se kush e vrau Ahmet Krasniqin, dhe të gjithë burrat tjerë të vrarë gjatë mandatit të Qeverisë së Bukoshit.

"BOTA SOT": Pse nuk e lejoi Halil Bicaj Tahir Zemën që me brigadën e tij "Mërgimi" të shkojë në Papaj?

Hysen GËRVALLA: Gabimi i parë i Halil Bicajt, që do ta zhysë në gabime edhe me të thella, është se pse nuk dha dorëheqje që në fillim, sapo i pa punët si po shkonin në Shtab dhe në atë dorëheqje t'ia sqaronte popullit, se në Bosne, ku kishte shërbyer më parë, ka pasur një organizim ushtarak të një niveli tjetër. E mbaj mend një takim që kam pasur me Bicajn në zyrën e Ministrisë se Mbrojtjes në Tiranë si i deleguar i LDK-së që isha. Zyra kishte dy dyer. Rastësisht me kanë shkuar sytë në njërën derë që rrinte e hapur gjatë bisedës sonë. Aty pashë duke përgjuar Behxhet Bajramin, azilant në Zvicërr, anëtar i devotshëm i LPK-së, me sa di unë, nga Bujanoci, i dënuar në Zvicër për trafikim droge me 7 vjet burg. E pyeta ministrin: " Po ky njeri, çka kërkon këtu?" Bicaj lëvizi nga vendi pa mund të thotë asgjë. "A e njeh?" – ishta pyetja tjetër e imja "Jo!"-m'u përgjigj, dhe i besova "Këtu e kam gjetur dhe tërë kohën rri aty", shtoi ministri. Atëherë, po ju pyes unë juve: Si mos ta ndal Halil Bicaj Tahir Zemën për të shkuar në Papaj, për t'u rikthyer në Kosovë, kur ai, si ministër i Mbrojtjes, punonte, pothuaj, vetëm sipas direktivave që i merrte nga "lart", nga "shokët e idealit". Bicaj s'ka guxuar të lejojë Tahir Zemën të rikthehet në Kosovë, sepse në dosjet e lëpëkëistëve emri i kolonel Zemës ka qenë i nënvizuar mirë si epror që ka dhënë betimin ushtarak para Ahmet Krasniqit, ministri Mbrojtjes, që ka njohur Presidentin Rugova si komandant suprem të Forcave të

Armatosura të Republikës se Kosovës dhe që ishte betuar t'ia japë edhe shpirtin lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

«BOTA SOT» : Si arrti Jashar Salihu t'i pengojë njësitë e Ministrisë se Mbrojtjes për të hyrë ne Junik?

Hysen GËRVALLA: LPK-ja, edhe pse pati filluar vonë me këto punë të mëdha, me politikën e saj prej shtrigave, sipas asaj thënies ogurzezë: "Për inat sime re, vdektë im bir", arriti që nga një hiç siç ishte, t'ia bëjë sherrin më të madh luftës dhe popullit të Kosovës. Për t'i penguar njësitë e Ministrisë se Mbrojtjes që të hyjnë në Junik, Jashar Salihu, jo vetëm ka qenë i dirigjuar prej se "larti" nga shokët e idealit, po ai ka qenë i mbrojtur nga piramida e kuqe dhe nga dreqi e i biri dreqit.

VOTA E LIRË ËSHTË FJALA E ZOTIT

Pse janë konvertuar disa shqiptarë në kombësi serbo-greko-ruse ? Pse shqiptarët u detyruan të luftojnë në dy fronte ? Kush po bënë pazar me martirët e rënë ? Cilët ishin kurbanët e tri parë zgjedhjeve të pasluftës në Kosovë ? Pse e zgjodhi Serbia Mahmut Bakallin si «negociues» kryesor për bisedat sekrete me Beogradin?

SHQIPTAROFOLËSIT SERBO-GREKË !

"BOTA SOT" : Pse nuk po "sosen" shqiptarët që punojnë për shërbime të huaja?

Hysen GËRVALLA: Historia nuk e mban mend të ketë qenë edhe vetëm një serb që të ketë punuar për shërbimet shqiptare në dëm të kombit të vet. Dhe, fakti tjetër, edhe me i hidhur: në Hagë po gjykohen serbët, kroatët, boshnjakët dhe shqiptarët. Tragjikisht, shqiptarët janë të vetmit që akuzohen se kanë bërë krime ndaj shqiptarëve. Kështu, historia e shqipfolësve që punojnë për serbe e grekë e për dreqin e mallkuar, po na ndjek këmba-këmbës. Pse është kështu, për ketë mendoj se duhet ta thonë fjalën e vet shkencëtarët duke bërë analiza historike, e besa edhe gjenealogjike të shqipfolësve të këtillë. Ai që ka gjak shqiptari nuk mund të punojë kundër vetvetes. Kundër vetvetes mund të punojnë vetëm të ashtuquajturit "të shartuar" dhe të konvertuar ne kombësi serbe, apo tjetër, të cilët janë shumë me të rrezikshëm për shqiptarët sesa çetnikët serbe, siç ishte, po e zëmë, një Ali Shukri.

Fatkeqësisht sot në Kosovë ka bukur shumë Alishukria. Ata kanë zaptuar një hapësirë të gjerë nëpër të cilën ladrojnë shlirshëm. Duke u lidhur ngushtë me atë pjesë të se majtës komuniste evroperëndimore që bën sot pushtet në Kosovë, qoftë ne kuadër të UNMIK-ut, qoftë të shoqatave të ashtuquajtura "joqeveritare", soji i shqiptarëve të konvertuar ne kombësinë serbe, prin sot, sidomos ne mediumet informative qoftë të shkruara, qoftë elektronike. Të ashtuquajturit të preferuar të Beogradit, si "politikologë", siç është një Mahmut Bakall, si "analist", siç është një Shkëlzen Maliqi, si "gazetarë", siç është një Baton Haxhi, një Veton Surroi, apo një Blerim Shalë, nuk janë gjë tjetër pos pjesë integrale e atij soji që ka arritur ta instalojë edhe drejtor të RTK-së, një vëlla siamez, siç është një Agim Zatriq.

"BOTA SOT" : Ky farë "soji", siç po e quani ju zoti Gërvalla, po i prin qe me se një decenie fushatës së egër kundër Rugovës!

Hysen GËRVALLA: Propaganda që u bë atëbotë kundër dorëzimit të librezave të Lidhjes se Komunistëve, fushata e mëvonshme kundër Referendumit me të cilin Kosova u definua shtet sovran dhe i pavarur, mosnjohja e Deklaratës së 2 Korrikut, të Kushtetutës se Kaçanikut dhe të institucioneve legjitime të Kosovës, është tentative e njohur e shqiptarëzezëve të konvertuar, për zhbërjen e çdo gjëje që shkon në favor të shqiptarëve të Kosovës. Duhet kuptuar njëherë e mirë se lufta kundër interesave të Kosovës udhëhiqet ne mënyrë perfide nga agjenturat e shteteve fqinje të ndihmuara nga agjentët shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria.

KUSH PO BËN SHALLTITROME ME HERONJTË?

"BOTA SOT": Ne vilet 1997-1999 shqiptarët u ballafaquan me dy lufta: me agresionin dhe masakrën pa maska që ushtronte Serbia mbi ta, ne një anë, dhe me luftën me maska që zhvillohej kundër luftëtarëve të devotshëm, me luftën e fëlliqët, siç thotë populli, që udhëhiqej nga njerëz me maska të LPK-së e LKÇK-së, të trajnuar nëpër zyrat e sigurimit të Tiranës!

Hysen GËRVALLA: Edhe ky është një i ashtuquajtur "specialitet" shqiptar. Maska dhe vrasja pas shpine nuk janë të traditës shqiptarë. Nuk është e traditës shqiptarë as vrasja e njeriut me thikë. As djegia e njeriut. Te gjitha këto, , janë traditë e njohur e sllavo-karpatianëve që fatkeqësisht i përvetësuan disa shqipfolës.

"BOTA SOT": Çka mendoni për dy parë heronjtë, dëshmorët e martirët që i ka Kosova sot?

Hysen GËRVALLA: Kosova i ka heronjtë, dëshmorët dhe martirët e vet. Ata nuk janë asnjë parë, as dy parë, por janë të gjithë burra të dheut që ranë për lirinë e popullit ne truallin e vet. Jemi ne të gjallët që bëjmë këto shalltitromesh, që duam të imponohemi dhunshëm si trima, politikanë e patriotë, duke bërë pazar me të rënët për Atdhe dhe për lirinë e popullit të vet, duke bërë matrapazllëqe si Elez Gabeli me kuajt! Të rënët në Kosovë nuk vdiqën për Leninin e Stalinin e as për Enverin, po për dheun e Kosovës amë.

"BOTA SOT": Para zgjedhjeve të para lokale (28 tetor 2000) Rexhep Qosja pati deklaruar : "Nëse fiton LDK-ja ajo do të jetë fitore e përgjakshme"! LDK-ja fitoi në tri parë zgjedhjet e pasluftës. Lufta civile nuk ndodhi falë vetëdijes se lartë të elektoralit të Ibrahim Rugovës, mirëpo pasojat po na përcjellin.

Hysen GËRVALLA: Pasojat janë me përmasa shqetësuese. Gjatë kësaj periudhe, pra pas luftës, prej afro një mijë të vrarëve, mbi 20 janë personalitete të njohura. Ndër ta, si ne Kështjellën e Rozafës, Xhemail Mustafa u bë kurban i zgjedhjeve të para lokale(28 tetor 2000). Ismajl Hajdaraj u bë kurban i zgjedhjeve nacionale(17 nëntor 2001), dhe Ukë Bytyçi, kurban i zgjedhjeve të dyta lokale(26 tetor 2002). Përgjakja e LDK-së u bë dhe po vazhdon të bëhet edhe kushedi sa kohë. Për të mos e fituar "fitoren" e Bejat Sylës ("Faqen e zezë me ni parë pishtole", kësaj fatkeqësie që po na përcjell, duhet t'ia zëmë pritën, duke e gjykuar dhe dënuar ne mënyrë kolektive. Sepse, vrastarët, të nemunit e kombit, nuk kanë punë tjetër, por t'i numërojnë tinëzisht të vrarët që po i vrasin tinëzisht. Legjendën e Urës e Shenjtë, të ndërtimit të vështirë të saj, Serbia është përpjekur gjithmonë ta bëjë realitet. Për këtë shkak, Serbia prodhonte, e edhe sot prodhon, shkatërrimtarë shqiptarë me ritmin e natalitetit kinez!

"BOTA SOT": Pse e zgjodhi Serbia Mahmut Bakallin negociues kryesor për bisedat sekrete me Beogradin?
Hysen GËRVALLA: Po kënd kishte për ta zgjedhur tjetër? Bashkëkohanikët e Bakallit, shumica, kanë vdekur. Po edhe sikur të ishin gjallë, Serbia prapë do të zgjidhte Mahmut Bakallin, si me besniku i tyre që është.

VOTA E LIRË

„BOTA SOT“: Zoti Gërvalla, në fund, cili është mesazhi juaj për shqiptarët?
Hysen GËRVALLA: Shqiptarëve u qoftë puna e mbarë dhe u shtoftë numri i tyre! Jam i bindur se falë shërbimit që i bëri dhe po i bën Kosovës kolona e gjatë e burrave kolosalë, të gjitha prapësitë do të dëbohen nga qielli i Kosovës ne të mire të mirëqenies se shtetit të Kosovës, sepse njeriu ynë, ne shumicën absolute të numrit të tij, është inteligjent, i ndershëm. Zoti na e dha. Na e dha Amerika e Anglia. Na e dha populli ynë i pathyeshëm nga robëria shekullore, ketë liri që gëzojmë sot.

Vlerësimi i gabueshëm i fuqisë se votës se lire nga ana e një shtrese njerëzish, ishte gabim historik. Ka bukur shumë njerëz që kanë rënë viktimë e propagandës se prirë nga agjentët shqiptarë të rekrutuar nëpër agjentura të huaja se "nuk është gjë puna e votës se lire!", sepse, e djathta, pra LDK- ja, na qenkësh ne "shërbim" të Serbisë.

Mos të harrojmë se vota e lire ka ndërtuar Amerikën, ka ndërtuar botën që quhet e qytetëruar, dhe kjo vote duhet patjetër të na ndërtojë edhe shtetin tonë. Vetëm me armën që quhet VOTA E LIRE E POPULLIT do të arrijmë t'i kapërcejmë me sukses të gjitha të këqijat që na i ka kurdisur armiku me shekuj. Vota e lire është e vetmja arme që nuk e dëmton humbësin. Vetëm me votën e lire do të arrijmë të kapërcejmë fitimtarë të gjitha furtunat qofshin ato të përgatitura edhe nga njeriu i gjakut tonë i rekrutuar ne agjenturat e kombinuara KGB-UDB. Vota e lire është fjala e Zotit!

"BOTA SOT": Ju falemnderit, Zoti Gërvalla!
Hysen GËRVALLA: Me nder qofshi e u qoftë e mbarë puna që po bëni për kombin.

Intervistë dhënë Jusuf Ferizit për 'Bota Sot' nga 10-16 mars 2003

44. MENDJELEHTËSI APO DIÇKA TJETËR

Nga Kadri Rexha

(Lidhur me artikullin „Katër rrëfime për Jusuf Gërvallën“, të nënshkruara nga Fokusipress, botuar në gazetën „Fokusi“, nr. 10, datë 17 janar 2004, faqe 3-7)

Në artikullin „*Katër porositë e Jusuf Gërvallës*“, Fokusipress, ndër të tjera, sjell edhe katër deklarata të Nazmi Selmanajt, ish veprimtar në Gjermani, lidhur me një mision të tij katër ditor në Kosovë, gjatë ditëve të fundit të muajit shkurt të vitit 1980. Meqë deklarata me nëntitullin „*Rrëfimi nr.3*” ka të bëjë personalisht me mua, në këtë reagim, do të merrem vetëm me të. E theksoj, që në fillim, se deklarata është e mangët, e njëanshme, subjektive dhe qëllimkeqe, ndaj e ndjej për obligim, që, lexuesve të njerëzishëm të „*Fokusit*“, t'ua them të vërtetën duke e plotësuar deklaratën me pjesët që i mungojnë, qëllimisht ose paqëllim. Për arsye praktike teksti i plotë i deklaratës së

Nazmiut, në vijim, do të jepet me shkronja kursive, ndërsa plotësimi dhe komentimi nga ana ime jepet brenda kllapave. Pra, të fillojmë nga e para.

"*Në natën e fundit të qëndrimit në Kosovë, trokas në derën e Kadri Rexhës. Mbaja me vete porosi për të. Ishte mesnatë kur një zë femre më përgjigjet se ai nuk ndodhej në banesë*". Plotësimi im: Zëri i femrës ishte gruaja ime, Halë Berisha nga fshati Prapaqan, sot motër e dëshmorit të UÇK-së. Pra, nuk ishte "*zë femre*" i papërcaktuar. Nazmiu gjatë atyre pesë minutave të qëndrimit në banesën time ka mundur të bindet për këtë. Ndryshe tingëllon togfjalëshi "zëri i së shoqes së K." apo "zëri i gruas së K. e pak më ndryshe "një zë femre", ashtu siç është shprehur qëllimisht deklaruesi.

"*Unë insistoj dhe e them kodin me lartësi zëri sa pandehja se po e dëgjonte Kadriu, shoku i Jusufit*". Plotësimi im: Është e vërtetë se matanë derës së banesës sime, në korridor, deklaruesi e ka shqiptuar këtë kod: "kam një porosi nga burri i Rabës." E them me përgjegjësi të plotë se një kod i këtillë mes meje dhe Jusufit nuk ka ekzistuar. As për "vizitën" e Nazmiut nuk kam qenë i paralajmëruar. Një kod kësisoj ka mundur ta shqiptojë edhe ndonjë gojë provokatori. Për fatin e mirë të deklaruesit si dhe të vet misionit, në atë çast, më ra ndër mend se shoqja e Jusufit, Suzana, më ka pas thënë se për hir konspiracioni në biseda telefonike nga Kosova me Jusufin prezantohej me emrin Rabë. Kaq ka mjaftuar për mua, ndonëse , po e përsëris, për një kod të këtillë unë nuk kam ditur gjë.

"*Dhe pas pak ai ngrihet dhe ma mbyllë derën*". Plotësimi im: Cilën derë? Kush e hapi që ta mbylli unë?! Duket sheshit se qëllimi e arsyeton edhe këtë mjet!.

"*Unë insistoj dhe i them nga jashtë se më duhet ta kryej porosinë. Më pas ai hapi derën dhe më futi brenda*". Plotësimi im: Derën e kam hapur pasa e kam dëgjuar shqiptimin e kodit të përmendur, ndonëse isha i vetëdijshëm se po e thyej vendimin që e kishim marrë me shokë që dera e shtëpisë të mos u hapet të panjohurve pas orës 22.00, kur fillonte ora policore e pashpallur. Në këtë rast, Nazmiu ka qenë më i favorizuar. Ai, përmes Jusufit e ka ditur se në derë të kujt po troket, ndërsa unë Nazmiun nuk e kam njohur fare, as si emër. Ndaj, nisur nga fakti se UDB-a gjatë atij dimri fabrikonte spiunë, emisarë dhe provokatorë ditë e natë, hezitimin, dyshimin dhe kujdesin, asokohe, i kam parë si gjërat më normale. Sidomos, kur të kihet parasysh, se shokët e Jusufit përcilleshin në çdo hap. Prandaj, nëse deklaruesi, asokohe, ka pritur se do të takohet me kreshnikë që "syri s'u bën vër", sot pas më shumë se dy dekadash, ai është dashtë ta ketë një rezon tjetër, më afër realitetit. Ilegalja i ka rregullat e veta.

"*Rexha pranoi porosinë, por materialin e kërkuar nga Jusufi nuk ma dha, me arsyetimin se do të fliste vetë me Jusufin.*" Plotësimi im: Porosia e Jusufit e dedikuar për mua ishte: rreth njëqind ekzemplarë të gazetës "*Bashkimi*", ndërsa materiali që kërkohej nga Jusufi nuk ishte në banesën time, nuk e kisha në gji. Jusufi nuk kërkonte molla..! Të përsëris, nuk isha i paralajmëruar që ta kem të gatshëm për atë natë materialin e kërkuar.

"*Këtë nuk e kishte bërë ndonjëherë*". Plotësimi im: Konstatim tejet subjektiv. Deklaruesi, në këtë rast, mund të flasë vetëm për vetveten. Mund të thotë: me mua kurrë më nuk ka pasur kontakt tjetër. Se a i kam përmbushur unë detyrat ndaj Jusufit dhe shokëve të tjerë ai nuk ka mundur të dijë kurrë. Nazmiu nuk ishte i vetmi, nuk ishte as i pari e as i fundit që për punë të kësaj natyre kishte trokitur në derën time. Dhe, Nazmiu gabon rënd nëse mendon se për çdo gjë ka qenë i informuar mirë! Jusufi, sikur me të gjithë veprimtarët tjerë, as me Nazmiun nuk ka biseduar më tepër se sa për pjesën e punës që i ka takuar atij personalisht. Në rastin konkret Nazmiu ka luajtur rolin e postierit, ndonëse edhe kjo detyrë i ka përgjegjësitë dhe sakrificat e shumta.. Këtë e them me plot bindje. Besoj se e njoh mirë karakterin e Jusufit.

"*Rexha dukej se dëshironte të harronte historinë me Jusuf Gërvallën*." Plotësimi im: Edhe ky është një vlerësim qëllimkeq i deklaruesit. Gjykim i një adoleshenti të

përjetshëm narcisoid. Noli në këtë rast do të thoshte: Ajme!, ndërsa Jusufi do të shprehej me fjalët: e madhe është kjo botë! Nazmiu me gojën e vet pohon se "*Rexha pranoi porosinë*" e Jusufit, pra rreth 100 ekzemplarë të "*Bashkimit*" dhe në të njëjtin moment dhe po me të njëjtën gojë, pa pikë turpi, me rezultatet e tij psikoanalitike, vjen në përfundim: "*Rexha dukej se dëshironte të harronte historinë me Jusuf Gërvallën.*" Absurditet. Papastërti shpirtërore. Mjerim mendor..! Thënë të vërtetën, asokohe e kam vlerësuar lartë sakrificën e Nazmiut, djaloshit të ri student. Këtë vlerësim për të e kam shprehur edhe në një intervistë në gazetën "*Qëndresa*". Deri me sot kam jetuar me mendimin se Nazmiu në një kohë të caktuar e ka kryer me nder një detyrë që ia ka besuar Jusufi, dhe fund, por kurrën e kurrës nuk më ka shkuar mendja se ai ia paska pas ngarkuar vetës edhe një mision të ri, detyrën e vëzhguesit intrigues ndaj shokëve të Jusuf Gërvallës. Këtë veprim ai po e pohon sot, pothuaj, pas një çerek shekulli heshtjeje. Ç'ti bëj fatit. Nuk po di ç'të them tash për atë kohë: ta qaj vetën, a Jusufin?! ! (…) Mbi njëqind ekzemplarët e gazetës "*Bashkimi*", të cilat nga ai moment kalojnë në dorën time për Nazmiun nuk flasin gjë. Ose, thënë më qartë, në trurin e Nazmiut pranimi i porosisë nga ana ime, në vend se të dëshmonte përtëritjen e historisë …, jepte sinjale se "*Rexha dukej se dëshironte ta harronte historinë me Jusuf Gërvallën.*" Dhe, nëse Nazmiu, për vetveten, vlerëson se vepra e tij, në atë rast, ka qenë sakrificë e madhe, një sakrificë kësisoj, ndoshta edhe më të madhe, nuk është dashtë t'u mohohet të tjerëve. Vallë, e pyes vetën, ku pi ujë ky guxim kaq i marrë i Nazmi Selmanajt! Ka këtu mendjelehtësi apo diçka tjetër më të errët. Po, veç të tjerave, Nazmi, si i ke vlerësuar këto dy raste që lidhen me punën time. Rasti i parë, një përpjekje për ta "*harruar historinë me Jusuf Gërvallën*", lidhet me udhëtimin tim në Gjermani dhe kontaktin tim të drejtpërdrejtë me Jusufin, në fillim të muajit Gusht të vitit 1980, mu në kohën kur Jusufi po e botonte numrin e parë të "*Lajmëtarit të lirisë*". Rreth këtij rasti dhe fakteve të tjera lexuesit mund të informohen më hollësisht në monografinë për Jusuf Gërvallën me titull "*Fati i luleve*", botuar më 1993, shkruar nga autori i këtij reagimi. Dhe rasti i dytë, si dëshmi tjetër e "*harrimit*" të kësaj historie lidhet me dënimin tim trevjeçar për veprimtari antijugosllave, në shkurt të vitit 1982, pikërisht dy vjet pas trokitjes tënde në derën e banesës time. Nuk po i ceku këtu dhjetëra shkrime dhe aktivitete tjera të miat që lidhen me emrin dhe me veprën e Jusufit. Por…Medet…!

Dhe, më në fund, Nazmi, më ke detyruar ta shtrojë këtë pyetje: cili është qëllimi i botimit të kësaj deklarate kësisoj, me ngjyrë kaq të zezë, pas 24 vjetësh? Nxjerrja në pah dhe glorifikimi i veprimtarisë sate patriotike duke i fyer të tjerët, denigrimi i shokëve të Jusufit apo zvetënimi sa më i madh i personalitetit të Jusufit? Për qëllimin e parë, Nazmi, ke pasur rrugë të tjera, larg trillimeve dhe pështjellimeve. Sidomos që tashti ke edhe post, je pushtet. Qëllimi i dytë të shkon huq. Shokët e Jusufit, ata të zgjedhurit e Jusufit, nuk ka limë që i ha. Të gjithë janë njerëz me biografi. Të kuptohemi, jo ata të rastit, siç je ti, dhe jo ata të shpifurit, më vonë. "*Se në Maj këndon kushdo, këndon dhe zogu i qyqes, o*", këndonte Jusufi. Edhe qëllimi i tretë do të të dështojë. Dhe, këtu nuk kam asnjë fije dyshimi. Sikur Skënderbeu, edhe Jusufi Gërvalla, për jetë të jetëve do t'i çajë shekujt e historisë, si trim i mirë me shokë shumë.

"Fokusi", 7 shkurt 2004, botimi në perëndim

45. Riaktivizohet klubi letrar "Jusuf Gërvalla"

Tetovë, 18 nëntor 2006 (Kosovapress)

Me qëllim të gjallërimit të jetës letrare dhe kulturore në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe me dëshirën për të nxitur krijimin e artit letrar ndër studentë e më gjerë u riaktivizua veprimtaria e klubit letrar "Jusuf Gërvalla", që ishte themeluar në vitin 1996.

Takimi i studentëve krijues të fjalës së shkruar artistike u mbajt në një nga sallat e programit studimor gjuhë dhe letërsi shqipe të USHT-së.

Në këtë takim krijuesit e rinj diskutuan dhe shtruan nevojën e organizimeve më të shpeshta të veprimtarive letrare, kulturore e artistike, të cilat do të mund t'i menaxhonte një Qendër Kulturore, e cila do të funksiononte në USHT. Klubi letrar "Jusuf Gërvalla" në të ardhmen do të merret me organizimin e orëve letrare, debateve letrare, shënimet e përvjetorëve të figurave të ndryshme letrare e historike, nxjerrjen e një reviste etj.

Tubimi zgjodhi kryesinë e re prej nëntë anëtarësh. Kryetar u zgjodh Xhemazije Rizvani, studente e vitit të tretë, ndërsa nënkryetar Arzije Dervishi studente e vitit të dytë të programit mësimor gjuhë dhe letërsi shqipe.

Klubi letrar "Jusuf Gërvalla" mori qëndrim që me rastin e Festës së Flamurit, të organizohet një ore letrare në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Ora letrare do të mbahet më 22 nëntor, në ora 15.00, në amfiteatrin e Shkencave Humane dhe Arteve, ku do të ftohen të lexojnë poezitë e tyre pos studentëve, profesorët krijues, si dhe poetë të tjerë.

Klubi letrar "Jusuf Gërvalla" mbajti Orë letrare

Ne sallën e Fakultetit te Shkencave Humane dhe Arteve ne praninë e një numri te madh te studenteve, profesorëve dhe drejtuesve te USHT-se, Klubi letrar "Jusuf Gërvalla" mbajti ore letrare, ku u përkujtua Dita e Flamurit, Dita e Pavarësisë se Shqipërisë, ndërsa poetet e shumte lexuan krijimet e tyre.

Aktiviteti letrar u hap me Himnin kombëtar te ekzekutuar nga Korri i Universitetit. Referatin kushtuar Ditës se Flamurit e lexoi Lejla Iljazin, e cila u ndal gjerësisht ne përpjekjet dhe luftën e shqiptareve qe bene ne te shkuarën për tu çliruar nga sundimi pesëshekullor osman. Plaku i urte Ismail Qemali, me 28 nëntor 1912, se bashku me delegatet atdhetare nga trojet e ndryshme shqiptare shpalli ne Vlore, Pavarësinë e Shqipërisë dhe kështu u hap rruga për një te ardhme me te mire ne mesin e kombeve te botes.

Me pas poetet e shumtë dhe anëtarë te Klubit letrar "Jusuf Gërvalla" lexuan krijimet e tyre si: Alide Lloga, Malsore Karimani, Ramadan Sinani, Arzije Dervishi, Rami Kamberi, Ibadete Ilazi, Flora Sela, Shaip Emerllahu, Emine Osmani, Sadije Aliti, Ejup Ajdini, Blerije Bajramoska, Ekrem Ajruli, Adem Abdullahu, Xhemazije Rizvani dhe Salajdin Salihu.

Studentet lexuan edhe poezi të Jusuf Gërvallës dhe të Shaban Xheladinit. Të pranishmit me këtë rast patën mundësi të dëgjojnë edhe këngë të kënduara nga vet, Jusuf Gërvalla.

46. Intervista e Hysen Gërvallës për Gazetën Bota Sot

Hysen Gërvalla, Intervistë për "Bota Sot" (Dhjetor 2006)

Flet Hysen Gërvalla, vëllai i madh i vëllezërve Jusuf Gërvalla e Bardhosh Gërvalla, kryetar i Degës së LDK-së në Zvicër

UDB-ja m'i ka vrarë vëllezërit, por dua ta dijë se kush ma ka ngrënë bukën e ma ka bërë tradhtinë pas shpine

Për jetën, e veprën e vëllezërve Bardhoshë e Jusuf Gërvalla, për vrasjen e 17 janarit të vitit 1982 në Shtutgart, për organizatorët dhe ekzekutorët e kësaj vrasje, për ata që janë implikuar në këtë vrasje, për kthimin e eshtrave të Jusufit e Bardhoshit në vendlindje, për personalitetin e presidentit Ibrahim Rugova dhe për rolin e LDK-së në procesin e Pavarësisë së Kosovës, për ndryshimet e fundit në LDK, për akademik Nexhat Dacin dhe për të ardhmen e LDK-së, flet ekskluzivisht për gazetën kombëtare "Bota sot", Hysen Gërvalla, vëllai i madh i vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla, kryetar i Degës së LDK-së në Zvicër.

Më shumë se dyzet vjet më parë, në Kullën e Gërvallajve në katundin Dubovik të Deçanit, një nënë, si të gjitha nënat e tjera shqiptare po hiqte të zitë e ullirit, siç thotë një fjalë e urtë popullore, për të rritur e përgatitur për jetë një grumbull fëmijësh. Ata kanë bërë hapat e parë të fëmijërisë në oborrin e shtëpisë, në livadhet përreth.

Edhe sot e kësaj dite Kulla e Gërvalljave është dëshmitare e jetës plot skamje, vuajtje, vaj e dhune. Shtylla e kësaj Kulle dhe e kësaj familje, Nëna Ajshe nuk është më në këtë botë, por djali i madh i Nënës Ajshe, Hyseni, ai që i kishte rënë hise të merr barrën e përkujdesjes për vëllezërit e tij më të vegjël, pranë kësaj Kulle, në trollin që më parë kishte qenë i okupuar nga fqiu serb, me mbiemrin Shaliq, ka ndërtuar një shtëpi të re.

Në varrezat e katundit, pranë Nënës Ajshe sot prehen edhe eshtrat e Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Në shtëpinë e re të Gërvallajve ka ndryshuar shumëçka. Në Kullën e vjetër, matanë rrugës ka mbetur edhe shumëçka të thuhet, edhe shumëçka të shkruhet. Bashkë me kufomat e trupave të pajetë të Jusuf e Bardhosh Gërvallës është varrosur edhe misteri i vrasjes së tyre, Por, Hysen Gërvalla – Baca, ka një brengë në shpirt: "Unë gjithë jetën jam për atë që ta dijë se kush është ai që më ka vrarë, jo për hakmarrje por unë dua ta dijë se kush ma ka ngrënë bukën e ma ka bërë tradhtinë pas shpine" shprehet ai, 24 vjet pas vrasjes së 17 janarit të vitit 1982.

Bota sot: Bac, po bisedojmë në vendlindjen tuaj, në vendlindjen e vëllezërve tuaj, në oborrin e shtëpisë në Dubovik, fare pranë Kullës ku ju keni lindur e jeni rritur. Çka ka ndryshuar prej asaj kohe në këto troje?

Hysen Gërvalla: Së pari ju dëshiroj mirëseardhje. Ndjejeni veten si në shtëpinë e juaj. Jam i nderuar që kam rastin të flas për gazetën kombëtare "Bota sot" dhe që ju kam mysafir në shtëpinë time këtu në Dubovik. Prej asaj kohe ka ndryshuar shumëçka. Ka qenë fukarallëk i madh në atë kohë. Por, ka qenë edhe kohë e dhunës, e ndjekjeve e shpërnguljeve. Këtu ku po bisedojmë ne, para më shumë se 40 vjetëve ne nuk kemi guxuar as të shkelim me këmbë. Megjithëse livadhi dhe toka ka qenë e jona, neve na e pat zaptuar Shaliqi, një kolon malazez, prej të cilit më vonë u detyruam edhe të shpërngulemi. Sot gjithçka është ndryshe dhe të gjitha këto ndryshime janë bërë për të mirë të këtij vendi e të këtij populli.

Bota sot: A mendoni se edhe Ju, familja Juaj, vëllezërit e tuaj, keni "hise", keni merita për këto ndryshime. A është kjo liri e sotme e shkruar edhe me sakrificën dhe gjakun e familjes tuaj?

Hysen Gërvalla: Shihni, të gjithë shqiptarët kudo që janë duhet të jenë krenarë për lirinë që e gëzojmë sot. Të gjithë, i madh e i vogël. Për mua është gabim i madh nëse meritat maten me kandar. Ne nuk duhet të bëjmë kësi ndarjes, se ai ka bërë më shumë e ky më pak. Edhe ne kemi bërë aq sa kemi mundur e qa sa kemi ditur për këtë liri, për atdheun tonë. Të gjithë kemi merita, të gjithëve na takon krenaria.

Bota sot: A jeni të kënaqur me këtë liri dhe me këto ndryshime, për të cilat ranë edhe dy vëllezërit tuaj, Jusufi e Bardhoshi?
Hysen Gërvalla: Deri diku jam i kënaqur.

Bota sot: Pse thoni kështu? Nuk jeni të kënaqur me këtë liri që e gëzojmë sot?
Hysen Gërvalla: Nuk jam plotësisht i kënaqur. Mbi të gjitha nuk jam i kënaqur me mënyrën se si e përvetësojnë këtë liri disa individë dhe disa grupe. Edhe Jusufi, edhe Bardhoshi, edhe Kadri Zeka edhe të gjithë dëshmorët e tjerë të rënë para, gjatë dhe pas luftës kanë patur vetëm një ideal, lirinë dhe pavarësinë e vendit. Ata nuk kanë luftuar për grupe individësh, ideologji apo parti politike.

Bota sot: Të ndalemi edhe pak te familja Juaj. A po e ndjeni mungesën e Nënës Ajshe, vëllezërve Tuaj, Jusufit e Bardhoshit, sidomos tash kur jeni kthyer në vendlindje dhe ata nuk janë më në këtë botë?

Hysen Gërvalla: Po shumë po e ndjej mungesën e tyre. Kemi lindur dhe jemi rritur në këto troje dhe kam kujtime të paharrueshme. Ne kemi qenë me emra dhe trupa të ndryshëm por shpirtin e kemi patur të njëjtë. Unë bashkë me Nënën Ajshe i kam rritur dhe i kam shkolluar vëllezërit e mi sepse mi ka lënë baba amanet. Ata u shkolluan, iu përgjigjën kohës, koha i mori…

Bota sot: A mendoni se fakti se eshtrat e Jusufit dhe Bardhoshit sot prehen në vendlindje, edhe ata në atë botë por edhe ju jeni më të qetë shpirtërisht, e keni një lehtësi shpirtërore?

Hysen Gërvalla: Po, sigurisht se edhe ne si familje, edhe unë si vëlla i tyre jemi më të qetë për faktin se eshtrat e tyre prehen në vendlindje, pranë Nënës Ajshe, pranë eshtrave të babës dhe të familjarëve të tjerë. Besoj se edhe për ata dheu i vendlindjes është më i lehtë. Kam edhe një dëshirë, që ndoshta një ditë do ta bëje realitet: kam dëshirë që pranë varrit të Jusufit e Bardhoshit të ngris një lapidar në shenj nderimi për jetën, veprën dhe rënien e tyre për këtë liri që e gëzojmë sot.

Bota sot: Bac, para më shumë 15 vjetësh, në një intervistë që kemi bërë, kur ju kam pyetur se kush janë vrasësit e Jusuf e Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës më keni thënë se vrasës është UDB-ja serbe, ndërkaq emrat e bashkëpunëtorëve shqiptarë në këtë vrasje do t'i them më vonë. Më pas, në një intervistë tjetër Ju keni dhënë për herë të parë detaje të tjera rreth kësaj vrasje si dhe i keni shtruar disa pyetje, ish-bashkëpunëtorëve të Jusufit, Bardhoshit e Kadriut. Sot a keni të shtoni edhe diçka rreth kësaj atentatit të 17 janarit të vitit 1982 në Shtutgart?

Hysen Gërvalla: Për fat të keq edhe sot e kësaj dite nuk janë zbuluar vrasësit e Jusufit, Bardhoshit e Kadriut, ndërkaq unë edhe më tutje vazhdoj ta kem atë bindje dhe mendim që ta kam shprehur më vitin 1997 për ata shqiptarë të cilët më qan zemra se në njëfarë mënyre i kanë ndihmuar kësaj vrasje. Unë nuk mund t'i quaj ata bashkëpunëtorë të Jusufit sepse ata që sot janë gjallë, e që thirren si bashkëpunëtorë të Jusufit, nuk kanë qenë seriozë, kanë qenë destruktivë prandaj nuk mund t'i quaj edhe bashkëpunëtorë të tij. Unë nuk mund t'i akuzoj tash ata për vrasje por ata as atëherë e as sot nuk kanë patur aspak vlera elementare njerëzore.

Bota sot: Për kë e keni fjalën konkretisht?

Hysen Gërvalla: ...Unë atëherë e kam përmendur Ibrahim Kelmendin dhe disa të tjerë. Ato fjalë që t'i kam thënë atëherë, ti them edhe sot, sepse unë i kam folur fjalët që ata m'i kanë thënë, që ata më kanë treguar se çka kanë bërë e çka kanë vepruar. Dhe jo që m'i kanë thënë këto fjalë në besim por unë e dija qëllimin e tyre dhe kam patur durimin t'i dëgjoj deri në fund. Të kam thënë ty, sepse je gazetari i parë që prej vitit 1990 që je interesuar për këtë vrasje dhe që ke ardhë në Zvicër për të bërë intervistë me ne vëllezërit e gjallë të Jusuf e Bardhosh Gërvallës.

Bota sot: Ju në intervistën tonë të dytë, i keni parashtruar disa pyetje Ibrahim Kelmendit, por ai nuk u është përgjigjur këtyre pyetjeve tuaja?

Hysen Gërvalla: Ai edhe sot nuk përgjigjet edhe pse ishte dashtë që të më përgjigjet. Ai me siguri se nuk ka dëshirë as sot t'ia përmend emrin. Por, po e përsëris edhe njëherë se "heshtja" e tij nuk më jep të drejtën ta akuzoj për vrasje, por ai është mirë të tregojë vet për sjelljet e tij atëherë në raport me Jusufin.

Bota sot: Pavarësisht se mund të ketë të dyshuar për vrasjen e vëllezërve të tuaj, ekzekutorë të saj janë pjesëtarë të UDB-së. Madje vetë Jusufi në çastet e fundit të jetës së tij ka thënë se "...nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë!" Pra, prapë kjo vrasje mbetet enigmë?

Hysen Gërvalla: Unë gjithë jetën jam për atë që ta dijë se kush është ai që më ka vrarë, jo për hakmarrje por unë dua ta dijë se kush ma ka ngrënë bukën e ma ka bërë tradhtinë pas shpine. Disa sjellje të disave para lufte, prej se është vrarë Jusufi e deri më sot, më bëjnë të dyshoj. Edhe njëherë po e përsëris se jam i bindur se UDB-ja e ka organizuar vrasjen e Jusufit, Bardhoshit e Kadriut, por janë edhe disa shqiptarë të implikuar në këtë vrasje.

Bota sot: Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufi, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?

Hysen Gërvalla: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.

Bota sot: Zoti Hysen Gërvalla, ju nuk keni qenë "aktiv" në grupimet e ndryshme politike në diasporë, pas vrasjes së vëllezërve tuaj, por me formimin e LDIK-së, jeni këqyr në këtë parti. Pse keni hyrë në LDK-?

Hysen Gërvalla: Fare thjesht, kombëtarja ka dominuar mbi të gjitha ideologjitë në mua dhe familjen time. Por, me daljen në skenë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në fillim si lëvizje kombëtare, unë kam përqafuar këtë parti sepse te programi i kësaj partie kam parë shumë ngjashmëri me edukatën time familjare kombëtare. Ky program është edhe sot i njëjtë prandaj unë edhe sot jam dhe do të jem me LDK-në.

Bota sot: A ka patur përpjekje që juve të ju implikojnë në lëvizje dhe grupacione të ndryshme organizative, gjatë viteve të kaluara?

Hysen Gërvalla: Po janë bërë shumë përpjekje të vazhdueshme e me premtime të mëdha, por unë nuk kam dashur që të jem pjesë e lodrave e premtimeve të ndryshme ideologjike.

Bota sot: A ka qenë presidenti Rugova një prej arsyeve tuaja që e keni pranuar programin e LDK-së dhe jeni bërë anëtar i saj?

Hysen Gërvalla: Po. Presidentin Rugova unë nuk e kam njohur më parë, sepse kam qenë në kurbet. Ai është njohur me Jusufin. Por, unë edhe atëherë por edhe më vonë e kam kuptuar se dr.Ibrahim Rugova është një burrë i madh i popullit shqiptar të Kosovës të cilit duhet t'i dalim në ndihmë në përpjekjet e tij për shtetin e pavarur të Kosovës.

Bota sot: A ju ka folur diçka në atë kohë Jusufi për Ibrahim Rugovën?

Hysen Gërvalla: Po, më ka folur. Ata kanë qenë shokë të një brezi. Ata janë njohur shumë mirë me njëri-tjetrin. Kanë ndejtur bashkë.

Bota sot: Cili është mendimi juaj për presidentin Ibrahim Rugova, sot kur ai më nuk është në mesin tonë?

Hysen Gërvalla: Unë nuk kam fjalë që të përshkruajë personalitetin e dr.Ibrahim Rugovës. Elita intelektuale, historianë e studiues e kanë obligim që të zbardhin dhe të dokumentojnë rolin dhe personalitetin e dr.Ibrahim Rugovës në historinë e re të Kosovës.

Bota sot: A ju kujtohet ndonjë moment i veçantë nga takimet me dr.Ibrahim Rugovën?

Hysen Gërvalla: Kam shumë momente të takimeve me dr.Ibrahim Rugovën, por sa herë jam takuar, gjithmonë e kam forcuar bindjen se ai është i brumosur me ndjenjën kombëtare dhe se vetëm çështja kombëtare, çështja e Kosovës e ka preokupuar. Kjo liri që e kemi sot është meritë e dr.Ibrahim Rugovës. Unë nuk e mohoj as rolin dhe rëndësinë e partive të tjera, të luftëtarëve të UÇK-së e mbi të gjitha të forcave aleate të NATO-s për çlirimin e Kosovës, por dr.Ibrahim Rugova është i pari që në këtë fundshekull e nisi luftën për dëbimin e Serbisë nga Kosova.

Bota sot: Ju keni qenë prej themelimit të Degës së LDK-së në Zvicër keni qenë të kyçur. Në ndërkohë, si në disa vende të tjera edhe ne Zvicër ka patur "dridhje" të ndryshme që kanë pasuar me dorëheqje apo largime nga LDK. Ju e morët udhëheqjen e LDK-së në kohë të papërshtatshme. A keni patur ndonjëherë ndonjë dyshim personal apo edhe kërcënim për angazhimin tuaj në LDK-, qoftë gjatë luftës, qoftë pas përfundimit të saj?

Hysen Gërvalla: Jo. Unë asnjëherë nuk jam luhatur në përcaktimet e mia për LDK-në.

Bota sot: Edhe sot jeni në krye të Degës së LDK-së në Zvicër. A mendoni se LDK-ja, edhe pas vdekjes së presidentit Rugova ka forcë dhe potencial për të udhëhequr vendin drejt pavarësisë dhe integrimeve evropiane?

Hysen Gërvalla: Vdekja e presidentit Ibrahim Rugova është humbje e madhe për popullin e Kosovës, për çështjen e Kosovës por edhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës. Por, ne kemi një obligim që të qojmë në vend amanetin e tij dhe të PERMBYLLIM kështu synimet e popullit shqiptar të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran.

Bota sot: A mendoni se brenda strukturave aktuale të LDK-së prej nivelit lokal deri te ai qendror, ka aktivistë dhe intelektualë që mund ta udhëheqin LDK-në drejt sukseseve të reja?

Hysen Gërvalla: Po, unë mendoj se ka. Janë bërë disa lëshime, disa gabime, si[është rasti me zëvendësimin e kryetarit Daci nga Kuvendi i Kosovës, por unë kam shpresë të madhe në LDK-në dhe në strukturën udhëheqëse të saj. Në mesin e tyre ka edhe asi që kanë dëshira të tepruara, apo me vizione të qarta por mbase të paarritshme, por në përgjithësi LDK-ja ka forcë të tejkalojë edhe shumë sfida të tjera.

Bota sot: Ju personalisht por edhe Dega e LDK-së në Zvicër keni qenë ndër të parët që nuk jeni pajtuar me vendimin për zëvendësimin e ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës akademik Nexhat Dacit dhe jeni "rreshtuar" në anën e tij. Pse e përkrahni akademik Nexhat Dacin që ai të jetë kryetar i ardhshëm i LDK-së?

Hysen Gërvalla: Shihni, unë nuk bëj dallime në mes të Dacit, Eqrem Kryeziut, Kolë Berishës, Fatmir Sejdiut e ndonjë tjetri. Të gjithë këta për mua kanë kontribuar për LDK-në. Por, Nexhat Daci e ka treguar veten së është një kuadër i madh i LDK-së, ai e ka dhënë "provimin" shumë herë para popullit dhe anëtarësisë së LDK-së.. Akademik Nexhat Dacin e ka njohur shumë mirë dr.Ibrahim Rugova. Ata janë njohur në mes vete shumë vite para se të formohej LDK-ja. Madje edhe unë kam arritur ta njoh dhe të dëgjoj për Nexhat Dacin prej vitit 1968 e këndej. Ai i takon plejadës së hershme të intelektualëve, i cili bashkë me Ibrahim Rugovën, Gazmend Zajmin etj ka patur guximin që të ngre zërin kundër okupimit serb të Kosovës. Prandaj unë sot kam besim të plotë në akademik Nexhat Dacin dhe mendoj se LDK-ja në krye më Nexhat Dacin do të jetë edhe në të ardhmen forca më e madhe politike në Kosovë. Nexhat Daci i ka të gjitha kualitetet që duhet t'i ketë një akademik dhe një lider i ardhshëm i LDK-së.

Bota sot: Në shtator do të fillojnë zgjedhjet në LDK. A mendoni se këto zgjedhje do të forcojnë unitetin e brendshëm të LDK-së apo do të ketë "fraksione" të brendshme?

Hysen Gërvalla: Unë besoj se ky popull dhe anëtarësia e gjerë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, do t'i detyrojë udhëheqësit e saj që të bëhen bashkë dhe që të ruajnë unitetin e LDK-së të krijuar e të kultivuar nga lideri ynë dr.Ibrahim Rugova.

Bota sot: Kënd e shihni si lider të ardhshëm të LDK-së?

Hysen Gërvalla: Duke i patur parasysh ato që i thashë më lart, mendoj se akademik Nexhat Daci është ai që i plotëson të gjitha kriteret për të qenë lider i ardhshëm i LDK-së.

Bota sot: Bacë, a keni ndonjë porosi për lexuesit e gazetës kombëtare "Bota sot"?
Hysen Gërvalla: Për lexuesit e gazetës tuaj të nderuar dhe për gjithë popullin shqiptar të Kosovës kam vetëm një porosi: të punojmë të gjithë së bashku, kush sa mundet e sa di për shtetin e pavarur të Kosovës. (Dhjetor 2006)

47. Në Deçan shënohet 25-vjetori i renies se vellezerve Gervalla e Kadri Zeka

Deçan, 17 janar 2007

Vepra e Jusufit ndriqohet nga elita e shkencës dhe kritikës letrare Në sesionin shkencor do të flasin njerëz eminent të letrave shqipe, ndërkohë që do të ndahet edhe çmimi Jusuf Gërvalla. Manifestimi i konsideruar edhe eveniment mbahet nën patronatin e kryeministrit Agim Çeku dhe KK-së të Deçanit...

Një simpozium shkencor kushtuar jetës dhe veprës së heroit Jusuf Gërvalla, në 25 vjetorin e rënies së tij bashk më të vëllain Bardhoshin dhe bashkëveprimtarin Kadri Zeka, do të jetë boshti i manifestimeve të shumta që do të organizohen dy ditë radhazi në vendlindjen e dy të parëve, në Deçan. Emra të njohur të shkencës e të letërsisë do të jenë referuesit për gjithë personalitetin e pa shkoqitur ndonjëherë tërësisht të Jusuf Gërvallës në fushat në të cilat ai la gjurmë duke u bërë së pari pishtari i ngjarjeve të mëdha politike dhe ideolog për pasardhësit që shkuan gjurmëve të tij. Numri një i këtij organizimi, shkrimtari Rasim Selmanaj, që është edhe kryetar i Klubit të Krijuesve „Rrjedha" në Deçan, thotë se, për shumçka të paditura për personalitetin e Jusufit do të referojnë doktorët e shkencave albanologjike, Agim Vinca, Emin Kabashi, Rafet Rudi, pastaj shkrimtarët Rushit Ramabaja, Adem Gashi, studiusia Myrvete Dreshaj, Kadrush Radogoshi, Pren Buzhala, bashkëveprimtarët Hydajet Hyseni, Bedri Islami, Hasan Ukëhaxhaj, Nazmi Selmanaj dhe penat e publicistikes, si: Halil Matoshi, Fehmi Ajvazi etj. Selmanaj tregon se krijuesit që do të gjenden me 17 janar 2007, në Deçan në nderim të veprës së Jusuf Gërvallës do të ndriqojnë krijimtarin shumë dimensionale të tij, ndërkohë që bashkëveprimtarët e tij të gjallë do të japin segmente edhe të panjohura për veprimtarin patriotike të Jusufit gjatë veprimit në Kosovë dhe në emigracion. Sesioni shkencor që do të mbahet me 17 janar 2007 ,do të paraprihet më një ekspozitë personale të eksponateve të mbetura të patriotit Gërvalla dhe me homazhe tek varrezat e tyre në Dubovik të Deçanit. Ndonëse sesioni konsiderohet pjesa bosht e gjithë këtij evinimenti dyditor, që fillon në ora 11, manifestimi me moton „Në fillim qe fjala-Sërish me Jusufin" do të begatohet edhe më ndarjen për herë të parë të çmimit Jusuf Gërvalla. Begati e kësaj ngjarje për të cilën thuhet se do të jetë tradicionale, do të jeë mbajtja e një ore të madhe letrare në të cilën krijues nga gjithë hapësira shqiptare do të lexojnë nga veprat e tyre, kurse përmbyllja e saj do të shënohet me zërin e këngëtarëve të estradës: Ilir Shaqiri, Shyhrete Behluli, Shkurte Fejza dhe Rifat Berisha. Të mërkurën në Deçan do të gjendet edhe kryeministri i Kosovës z.Agim Çeku, nën patronatin e të cilët mbahet manifestimi kushtuar jetës dhe veprës së Jusuf Gërvallës. Për të qenë organizimi sa më shumë në nivel, organizatori ka arazhmuar ardhjen dhe kthimin e gjithë krijuesve nga Prishtina ,me autobus më datën 17.01.2007 , i cili do të jetë i parkuar në orën 9 :00 para Pallatit të shtypit "Rilindja", në Prishtinë.

Shkëlzen Tahirsylaj

48. AKTIVITETE PËRKUJTIMORE

U zhvilluan aktivitete përkujtimore, kushtuar 25 vjetori të rënies së trimave Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka

Deçan/Gjilan, 18 janar 2007 QIK - Me homazhe dhe vendosjen e kurorave me lule mbi varrezat në Dubovik të Deçanit dhe në Gjilan, filloi manifestimi kushtuar 25 vjetorit të rënies së heronjve të kombit Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka. Manifestimi u mbajtë nën patronatin e Kryeministrit Agim Çeku. Kryeministri Çeku në orët e pasditës ka bërë homazhe në varret e dëshmorëve Gërvalla, por edhe në varrin e Kadri Zekës në Gjilan. Për ta përkujtuar burrin, intelektualin dhe atdhetarin e përkushtuar Jusuf Gërvalla në Deçan u mbajtën një një varg aktivitetesh përkujtimore në 25 vjetorin e vrasjes nga UDB ja jugosllave së bashku me Bardhoshin dhe Kadri Zekën. Kryeministri Çeku tha se Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi u shndërruan në rrëfim për gjeneratat e ardhshme. Ai ka nënvizuar se me vrasjen e tyre lëvizja jonë humbi ideatorët por edhe veprimtarët e saj më të devotshëm, por siç ndodh shpesh herë në histori pas një rënie të madhe vjenë ringjallja e madhe. Me këtë rast u mbajt në Deçan një akademi përkujtimore, ku u fol për jetën dhe veprën e dëshmorëve të kombit. Në Deçan u mbajt edhe simpoziumi shkencor, ora letrare, programi artistik, si dhe u nda çmimi "Jusuf Gërvalla", që sivjet iu dha Adem Demës-Demaçit, Nexhmie Pagarushës dhe Jashar Salihut. Manifestimin e organizoi klubi letrar "Rrjedha" nga Deçani dhe për moto kishte sloganin "Në fillim qe fjala, sërish me Jusufin". Ndryshe, mbrëmë në Gjilan me akademinë përkujtimore kushtuar vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës me moton: "25 vite të një vrasjeje tinëzare", u tha se Jusufi, Bardhoshi dhe Kadriu ishin dhe mbeten ndër ideatorët kryesorë të shtetësisë së Kosovës.

49. E ADMIRON KËTË NJERI

Hysen Gërvalla, vëllai i Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, kërkon nga opinioni që ta ruajë Ibrahim Kelmendin për dëshmi. E admiron atë se i ka hyrë një pune shumë të madhe dhe thotë se edhe vetë Kelmendi është njeri shumë i përfolur. Ibrahim Kelmendi është autor i librit “Atentati”, që për qëllim ka pasur zbardhjen e vrasjes së vëllezërve Bardhosh e Jusuf Gërvalla.

Prishtinë 11 mars 2007

Ibrahim Kelmendi, autor i librit “Atentati”, i cili ka tentuar të zbulojë vrasësin e Jusuf Gërvallës përmes këtij libri, sipas familjes Gërvalla, është njeriu i parë i cili ka drejtuar gisht në një njëri të dyshuar për vrasjen e Bardhosh dhe Jusuf Gërvallës dhe për këtë ka prapa këtë familje.

Hysen Gërvalla, vëllai i Jusufit, pas publikimit të intervistës së Ibrahim Kelmendit, të botuar në gazetën Express, ka treguar se e admiron këtë njëri për guximin se i ka hyrë një pune shumë të madhe. Tregon se nuk është njeriu i vetëm i dyshuar Rezili, por janë edhe shumë të tjerë.

Ndër ta, thotë Hyseni, është edhe vetë Ibrahim Kelmendi, njeri shumë i përfolur si atentator i vrasjes së Jusuf Gërvallës. Për këtë, tash për tash, Gërvalla nuk dyshon në Kelmendin për shkak se ky ka marrë guximin t`i hyjë hetimit dhe zbardhjes së rastit të vrasjes së vëllezërve të tij.

“Pasi Ibrahim Kelmendi ka thënë se ka obligim moral për zbardhjen e rastit të vrasjes së Jusuf Gërvallës, atëherë unë nuk dyshoj në të, edhe pse është përfolur shumë për të”, ka thënë Gërvalla. Në këtë rast, Hysen Gërvalla kërkon nga populli kosovar dhe

mbarëshqiptar ta ruajë Ibrahim Kelmendin si dëshmi për vrasjen e vëllezërve të tij. “Lus popullin shqiptar që mos ta sakatojë Ibrahim Kelmendin, pasi që ai po di aq shumë për vrasjen e vëllezërve të mi”, tha Gërvalla.

Të dyshuar për vrasjen e Jusufit, janë një mori personash, që të gjithë shqiptarë, shpjegon ai. Por, nuk dëshiron që me askënd të kacafytet pa ardhur momenti i duhur për të vepruar. Nuk janë të interesuar si familje ta akuzojnë askënd për vrasjen e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës derisa nuk e kanë në dorë të sigurt njeriun, i cili e ka vrarë Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën.

Për Rezilin, Hyseni thotë se nuk e njeh, por vetëm është në dijeni se emri plotë i tij është Riza Salihu. Ndërsa për miqësitë e Ibrahim Kelmendit me Jusuf Gërvallën, Hyseni tregon se kanë qenë shokë dhe kanë ndenjur bashkë njashtu si edhe Hyseni vetë. Libri i Kelmendit, sipas Gërvallës, **është një libër i mirë**, edhe pse nuk e ka lexuar në tërësi.

Hysen Gërvalla, vëllai i Bardhosh dhe Jusuf Gërvallës, në emër të familjes Gërvalla nuk dëshiron që t’ia drejtojë gishtin askujt për vrasjen e vëllezërve të tyre. Por, thotë se nuk do të lërë pa hulumtuar dhe çuar deri në fund çështjen e vrasjes së dy vëllezërve të tij. Për këtë pret kohën e duhur. (Gazeta Express, 13 mars 2007)

50. Dëshmorët e "Brigadës 131 Jusuf Gërvalla"

Në 8 vjetorin e rënies, në Deçan, u përkujtuan 16 dëshmorët e lirisë "Brigada 131 Jusuf Gërvalla"

Me moton "Kujtojmë dëshmorët" në Deçan u organizua Akademi përkujtimore në 8 vjetorin e rënies së 16-të dëshmorëve të lirisë, të gjithë pjesëtarë të Batalionit Gardist, i cili veproi në kuadër të “Brigadës 131 Jusuf Gërvalla”, të UÇK-së, në Zonën e Dukagjinit.

Në majin e vitit 1999 Batalioni Gardist merr përsipër detyrën e rëndë dhe plotë sfida të bartjes së bashkëluftëtarëve të plagosur për në Shqipëri. Tetë vite më parë në trekëndëshin shqiptarë Kosovë-Shqipëri-Plavë, Guci ata bien në një pusi të përgatitur nga forcat serbe.

Beteja ishte e përgjakshme dhe heroike, në terren jashtëzakonisht të papërshtatshëm dhe me teknikë të pabarabartë, djemtë e batalionit gardist zhvilluan një luftë heroike. Në këtë betejë ranë në altarin e përjetësisë 16 dëshmorët e lirisë, ndërsa u plagosën rëndë dhjetë bashkëluftëtarë të tjerë, në mesin e të cilëve edhe komandanti i këtij batalioni, kolonel Avdyl Mushkolaj.

Beteja e 24 majit, në trekëndëshin shqiptar, apo beteja e Bogiqes, është njëra ndër më të përgjakshmet ne vazhdën e betejave të lavdishme të UÇK-së për çlirimin e atdheut. Dëshmorët e rënë në këtë betejë ranë për të rilindur në misionin e tyre të shenjtë - shpëtimin e shokëve të plagosur nëpër frontet e luftës, u tha në këtë akademi.

Në fund të kësaj akademie përkujtimore në nderim të veprës së dëshmorëve ,për sakrificën sublime të tyre , nga OVL - për Dukagjin ,për familjarët e dëshmorëve të rënë në këtë betejë u ndanë mirënjohje.

16 dëshmorët e rënë në këtë betejë:
Artan Mehmetaj,
Përparim Ferizi,
Sali Ferizi,
Valiant Ferizi,

Përparim Shala,
Fehmi Demiqi,
Nuredin Gërvalla,
Islam Krasniqi,
Nazmi Gradina,
Nimon Musaj,
Naim Berisha,
Limon Morina,
Metë Krasniqi,
Hysen Mehmeti,
Xhavit Islami dhe
Hajrush Demaj.

51. Magjistratura e Myrvete Dreshaj-Baliu

Myrvete Dreshaj – Baliu
Jusuf Gërvalla, Jeta dhe vepra, Prishtinë 2010

PARATHËNIE

Tema e lidhur me emrin e Jusuf Gërvallës, fillimisht vetëm me jetën e tij, më ka nxitur të merrem që kur isha nxënëse dhe prej saj nuk kam mundur të lirohem as si gjimnaziste, kur bashkë me disa shokë e shoqe kishim themeluar një grup politik në frymën e idealeve dhe të idealistëve si ai, as si studente kur dijes sime, përtej biografisë së tij jetësore, i ishte shtuar edhe biografia e tij intelektuale dhe krijuese. Kjo mund të duket mbase krejt personale, por duke dëgjuar fillimisht tregimet e bashkëkohësve për misionin e tij dhe duke dëgjuar më vonë rrëfimet e nënës Ajshe për fatin tragjik të familjes së saj, nuk kam mundur të mos e ndërtoj edhe unë një botë më vete për historinë e tij jetësore, familjare dhe më në fund kombëtare. Që nga manifestimet përkujtimore, (të filluara së pari si aktivitet kombëtar dhe së dyti si aktivitet kulturor, që më 1988) kur fillova t'i recitoj poezitë e tij dhe të shkruaj më vonë për veprën e tij (në temën e diplomës së Universitetit të Prishtinës), ngacmimi më shfaqej veçmas në çaste ballafaqimi me nënën e tij. Nga ajo kisha dëgjuar, në një qetësi dhe krenari, për fëmijërinë, për fatin tragjik të familjes dhe sidomos për misionin e tij. Ishin disa rrëfime, të cilat, në fund të fundit, nuk dilnin jashtë kornizave të baladave e këngëve të lashta, që vinin nga thellësia e botës shqiptare, duke u përsëritur nga brezi në brez deri në fund të shekullit XX.

Nga ajo që kisha dëgjuar nga miqtë, kolegët dhe bashkëveprimtarët e Lëvizjes ilegale për rolin e shumanshëm të tij në procesin e rezistencës së popullit të robëruar të Kosovës dhe të luftës për liri e pavarësi, biografia e tij më së miri më reflektonte gjeniun e krijuesit dhe ashpërsinë e konfliktit të tij e të popullit të tij me pushtuesin, të cilat realizoheshin njësishëm brenda vetes. Përmasa e angazhimit të tij më dilte e shumanshme: publicist, përkthyes, krijues, veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare në Kosovë dhe në mërgatë, si dhe organizues e ideolog i saj.

Ndoshta mu për këtë, fati i këtij autori dhe reflektimi i jetës dhe i veprës së tij në ndërtimin e kësaj monografie, ndeshen me një element të përbashkët, me kujtesën time dhe me ndikimin e saj në këtë proces krijues. Ky element, si shenjë e kujtesës së përbashkët për veprimtarinë brenda së njëjtës Lëvizje, mund të jetë veçoria personale, që në këtë rast na bashkon si objekt dhe si subjekt.

Në këtë rrjedhë, interesimi im për t'u marrë me hulumtimin dhe me studimin e veprës jetësore, intelektuale dhe letrare të Jusuf Gërvallës, lidhet me përpjekjen time për ta rikthyer atë si objekt kërkimi, në kohën kur për studimin e jetës dhe veprës së tij ende mungonte guximi i mjaftueshëm intelektual dhe qytetar ndër studiuesit dhe ndër institucionet tona shkencore. Vepra e tij letrare ishte bërë objekt i kritikës vetëm deri në vitin 1979 (Ali Aliu, Emin Kabashi, Teki Dervishi e Sylejman Syla), por pas largimit nga Kosova, në jetën kulturore e letrare ishte kthyer pjesërisht vetëm në Tiranë (Ismail Kadare, Pandeli Koçi, Ramadan Vozga e Lumira Berati), ku ishin botuar edhe dy vepra letrare të tij: Bekimi i nënës (përmbledhje me poezi të zgjedhura) dhe romani Rrotull. Ai do të rikthehet në letrat shqipe në Kosovë vetëm pas vitit 1990, kur do të botohen shumë shkrime rasti, me theks të veçantë për aktivitetin e tij politik dhe kur do të botohen disa prej vlerësimeve më të plota për veprën e tij letrare-artistike nga veprimtarë dhe studiues: Kadri Rexha, Sabri Hamiti, Hydajet Hyseni, Agim Vinca etj.

Pavarësisht nga këto, veprimtaria e tij jetësore dhe sidomos vepra e tij krijuese, ende nuk janë bërë objekt i një studimi më të thelluar apo i një monografie të plotë, prandaj këtë përpiqet ta arrijë studimi ynë.

Pas viteve nëntëdhjetë një numër i studiuesve dhe i kritikëve shqiptarë, në vazhdimësi kanë botuar studime në trajtën e monografive për vepra, autorë e çështje të ndryshme të letërsisë shqipe. Këto monografi studimore janë kryesisht të trashëgimisë letrare, por më së shpeshti të autorëve të ndaluar për një gjysmë shekulli. Studimet, zakonisht kanë karakterin e rivlerësimeve letrare e historike dhe të paraqitjes për njohje, vlerësim dhe vendosje të autorëve e veprave në kontinuitetin e vlerave letrare shqipe. Edhe qëllimi ynë është që në rrjedhat e këtij kontinuiteti të shprishur me kritere jashtëletrare, ta rivendosim edhe Jusuf Gërvallën (me pjesën më të madhe të veprës letrare të botuar dhe të mbetur në dorëshkrim) me një studim që është e zakonshme t'i rrijë pranë veprës. Jo thjesht, për të shtuar një emër në listën e shkrimtarëve të përmendur, që bëjnë historinë e letërsisë shqipe, por në radhë të parë, për të hapur për diskutim artin krijues letrar të Jusuf Gërvallës. Po e bëjmë këtë me qëllim që të mos na ngjajë, si rëndom, që ndaj vlerave krijuese letrare të reagojmë me vonesë.

Pra, projekti ynë synon që Jusuf Gërvallën ta shpërfaq jo vetëm si veprimtar të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por edhe si emër të dalluar të letrave shqipe. Nëse jetën e tij e shohim të arsyeshme që ta paraqesim përmes pjesës së parë dhe brenda tre kapitujve: Jetës, Kulturës dhe Mitit të vrasjes, veprën e tij letrare e shohim të arsyeshme që ta vlerësojmë përmes tri njësive: Poezisë, Prozës dhe Dramës. Kjo vepër ka edhe një shtojcë që përmban të hulumtuar mjaft shterueshëm Bibliografinë përmbajtësore të botimeve të tij. Një numër i madh i këtyre teksteve (kryesisht nga publicistika) nuk kanë mundur të komentohen brenda studimit, sigurisht për shkak se ato nuk kanë ndonjë rol të veçantë për qasjen e tashme, por kanë rëndësi për opusin e përgjithshëm krijues të tij, prandaj bibliografia përmbajtësore e botimeve është dhënë në pjesën e tretë si evidencë e zgjeruar. Arsyeja e një paraqitje të tillë ka qenë fakti se sot, përkundër një numri të madh të shkrimeve kryesisht publicistike për Jusuf Gërvallën dhe veprimtarinë e tij, vepra e tij jo vetëm nuk është botuar e plotë, por është e panjohur në disa aspekte të saj. Në këtë bibliografi, në interes të krijimit të një pasqyre më të plotë, sidomos të mendimit të tij politik, kemi paraqitur edhe elementet ndihmëse të teksteve, si: mbititujt, nëntitujt, mestitujt, hyrjet ose rezymetë e tyre.

Në fund të kësaj parathënie nuk mund të mos i përmend vështirësitë e dala gjatë hulumtimit dhe grumbullimit të materialit. Jeta e tij në shumë aspekte, aq sa ka qenë e njohur, po aq ka qenë edhe e panjohur, pavarësisht se për jetën ka shumë tekste të

publikuara, kryesisht në përvjetorët e vrasjes së tij. Mirëpo, dokumentet autentike (materialet e Lëvizjes, letërkëmbimi, dorëshkrimet, shtypi ilegal) ishin të shpërndara kryesisht në mërgatë dhe në Tiranë. Në diasporë (në arkiva private) gjendet pjesa më e madhe e literaturës që lidhet me veprimtarinë politike të Lëvizjes Kombëtare për çlirim, anëtar i së cilës ka qenë edhe Jusuf Gërvalla. Për këtë arsye jam detyruar që të shfrytëzoj disa forma të kërkimit. Në Tiranë kam hulumtuar në Arkivin Shtetëror, Bibliotekën Kombëtare dhe në arkivat e disa punonjësve shkencorë dhe të kulturës; në Prishtinë kam hulumtuar Arkivin e Kosovës dhe Bibliotekën Kombëtare, arkivin e të përjavshmes "Zëri i rinisë", arkivin e të përditshmeve "Flaka e vëllazërimit" dhe "Rilindja" etj., ndërsa nga mërgata kam marrë kopjet e dokumenteve dhe të shtypit të Lëvizjes: "Zëri i Kosovës", "Liria", "Lajmëtari i lirisë" dhe "Bashkimi".

Me këtë rast e ndjej të nevojshme t'ju shpreh mirënjohje të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre më kanë dalë në ndihmë për hulumtimin dhe grumbullimin e materialit: drejtorit të Arkivave të Shqipërisë prof. dr. Shaban Sinanit, drejtorit të Arkivave të Kosovës, dr. Jusuf Osmanit, si dhe punonjësve të këtij institucioni: Ismail Ismailit, Fikrije Berishës, Fatime Sylejmanit; punonjësve të Bibliotekës Kombëtare: Tahir Foniqit dhe dhe të tjerëve; punonjëses së bibliotekës së Institutit Albanologjik, z.Shpresa Krasniqit, studiuesve, publicistëve e pjesëtarëve të Lëvizjes ilegale për çlirimin e Kosovës brenda dhe jashtë vendit: Fahridin Tafallarit, Kadri Rexhës, Ibish Nezirit, Hasan Ukëhaxhës, Zymer Nezirit, Reshat Sahitajt, Behare Rexhepit, Musa Berishës, Skënder Blakajt, Xhevë Gërvallës etj.; ndërsa respekt të veçantë ju shpreh lexuesve të parë të dorëshkrimit: akademik Rexhep Qosjes (kryetar i Komisionit për mbrojtjen e tezës së magjistraturës), prof. dr. Emin Kabashit (mentor) dhe prof. dr. Agim Vincës (anëtar i Komisionit), sugjerimet e të cilëve më ndihmuan t'i jap formën përfundimtare këtij projekti. Myrvete Dreshaj, Prishtinë, maj 2002

52. FLAKA Që NDRIQOI RRUGËN E LIRISË

Sabit Rrustemi: Flaka e Janarit 2011;
www.zemrashqiptare.net, 17 janar 2011

"Flaka e Janarit 2011"

FLAKA QË NDRIQOI RRUGËN E LIRISË

Për të njëzetën herë me radhë, qyteti i Gjilanit përmes institucioneve të saja, krijuesve si dhe veprimtarëve të kulturës, mbledh dhe i bën tok trojet shqiptare në nderim dhe përkushtim të thellë për martirët dhe dëshmorët e kombit, përmes prezentimit dhe përurimit të vlerave artistike dhe ate, në fushën e artit pamor, skenik, muzikor dhe letrar.

Ky Manifestim shumëdimensional i kulturës, filloi rrugëtimin pikërisht në një përvjetor të madh, në dhjetëvjetorin e rënies heroike të tre atdhetarëve të kombit, shkrimtarit e këngëtarit Jusuf Gërvalla, Kadri Zekës e Bardhosh Gërvallës.

Atë kohë, jo dhe aq të largët por në kushte të rënda okupimi e terrori, ishte Shoqata e Pavarur Kulturore e Gjilanit që e nxori dhe e zbatoi këtë projekt kulturor dhe tepër metaforik "Flaka e Janarit", ndihmuar pa masë nga rinia gjilanase dhe ajo kosovare, e prirë prej Forumit të Rinisë të LDK-së si dhe një trekëndëshi hapësinor Bresalc – Gjilan – Përlepnicë, prej nga kjo Flakë, nëpër vitet e mëpasme përflaku jo vetëm Kosovën po kudo, trevat shqiptare dhe madje, edhe atje ku jetonin e vepronin shqiptarët, deri në Australinë e largët.

Ditët e 18 dhe 19 Janarit të vitit 1992, me kuptimin e plotë të fjalës, gradualisht po e identifikonin Gjilanin si epiqendër të një Manifestimi ndër më masivët anekënd shqiptarisë si dhe muajin Janar apo siç e kemi thirrur më parë, muajin Kallnor, në muaj të përshpirtshëm për një mal martirësh e dëshmorësh që u përpoqën nëpër kohë për t' i bërë bashkë shqiptarët deri tek një shtet i vetëm, i lirë e i pavarur për të cilin ideal apo projekt atdhetar ende vazhdojnë e s' kanë të rreshtur përpjekjet tona.

Ky Manifestim në muajin më të ftohtë të vitit, në janarin e dhembjes dhe krenarisë kombëtare, ishte i ndikuar nga ngjarjet, nga veprimet e bujshme që ju ndodhën prijësve tanë nëpër kohë, që nga Gjergj Kastrioti e deri të Vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka si dhe atyre që ranë e u flijuan për lirinë tonë edhe pas tyre.

"Flaka e Janarit", nëpër këto vite është përpjekur përmes një armate të tërë krijuesish llojesh të ndryshme arti, për t' i mbajtur gjallë shembylltyrat e tyre në kujtesën e kombit, qoftë përmes veprave përkushtuese të artit po, edhe përmes ndriqimit të figurave të tyre përmes tribunave të "Flakës..." e, në veçanti edhe përmes pjesës muzikore, këngës dhe si i tillë ky Manifestim, për brezat e rinj, për brezat që vinin dhe rriteshin me "Flakën...", përveç se rikujtues, ishte edhe frymëzues e ndriques në rrugën drejtë lirisë dhe pavarësisë, të cilën tashmë e gëzojmë sepse edhe e kemi merituar.

"Flaka e Janarit" si flakë që ka flakëruar parreshtur nëpër këto vite e që nuk është shuar asnjëherë, përmes idealit të të rënëve, atyre më herët po edhe të rënëve në vitet – 80-ta e 90 –ta, sidomos rezistencës së bujshme të Rexhep Malës e Nuhi Berishës më 12 Janar 1984, në një mënyrë ishte edhe flakadan i luftës çlirimtare të Kosovës, në vitet 1998 e1999, luftë kjo që u kurorëzua me dëbimin e armikut shekullor nga këto troje si dhe lirinë e këtij populli po, edhe hapjen e udhës drejt pavarësisë.

"Flaka e Janarit" ishte sfida më e madhe kulturore në Kosovën e okupuar, që me një madhështi të paparë u manifestua përmes Gjilanit nëpër midise tjera shqiptare. Natyrisht ishte edhe Muza krijuese apo thënë paksa në mënyrë figurative, edhe Olimpi kulturor i Kosovës, meqë nxiste, mblidhte dhe prezentonte vlerën më të arrirë brenda një viti dhe, përmes veprave artistike dha mundësinë të nderohen adthetarët e kombit.

Si një ndër Manifestimet më jetëgjatë të dekadave të fundit "Flaka e Janarit" në Kosovën e pasluftës, nuk e mori ende tretmanin e duhur. Përkundër kërkesave, ende nuk u ngrit përmes institucioneve qendrore, në manifestim shtetëror të Kosovës, kuptohet, duke ruajtur Selinë e saj, Gjilanin si dhe katër shtyllat kulturore, të cilat merituan dhe kërkojnë përsosje të vazhdueshme.

Një përkujdesje më e madhe shtetërore jo vetëm do rriste vlerën artistike edhe më tej të këtij Manifestimi por, edhe do ta nxirrte atë nga heterenogjiteti çfarë realisht e ka si dhe do ndikonte që brenda tërë vitit, brenda trevave shqiptare nga krijuesit dhe njerëzit që bëjnë e organizojnë kulturën, të garohet për të marrë pjesë në këtë manifestim, pikërisht shkaku i dedikimit të tij.

"Flaka e Janarit" ishte më shumë se një manifestim kulture. Ishte edhe "Flakë..." integruese e kulturës shqiptare dhe qendrave të saja, Prishtinës, Shkupit e Tiranës. Jo pak herë brenda këtyre viteve, këto tri qendra kryesore shqiptare ishin në një sofër, në Sofrën e Madhe të "Flakës..." përmes veprave të artit.

"Flaka e Janarit", në një mënyrë a tjetër ka unifikuar përveç kulturës shqiptare, edhe pjesën politike të kombit. Si i tillë, ky Manifestim, ka nevojë për t'u përsosur edhe mëtutje, për t'u rritur në vlerë, duke gëzuar një mbështetje më të madhe nga insitucionet tona Po, mbi të gjitha duke u trajtuar si Manifestim kombëtar i kulturës sepse edhe i tillë ka qenë në këto dy dekada.

Ndërsa, komuna e Gjilanit, si vendlindje dhe seli e këtij Manifestimi, meriton një nder të veçantë, për gatishmërinë, sakrificën, përkushtimin dhe gjithë atë që ka bërë gjatë këtyre njëzet viteve për "Flakën..." e me "Flakën..." për më të shenjtit e kombit.

Sepse, falë, krijuesve, njerëzve të kulturës, artdashësve, donatorëve dhe institucioneve të kësaj komune, (qoftë atëherë kur vepruan në kushte okupimi, qoftë sot, kur marrim frymë shlirë dhe veprojmë në rrethana krejt tjera), "Flaka e Janarit" sfidoi të gjitha situatat dhe, po mbahet për të njëzetën herë.

Jubile i "Flakës..." që do shpalohet në Gjilan nga Sheshi "Agim Ramadani", do jetë jubile për gjithë shqiptarët, të cilët në një apo tjetër mënyrë kanë jetuar dhe bashkëecur me këtë Manifestim. Natyrisht, të ndihmuar dhe nga institucione qendrore, jo vetëm përmbajtja e këtij Manifestimi por, edhe dekori do jetë më solemn. Dhe, kemi arsye; me "Flakën e Janarit" dhe idealin e gjithë atyre atdhetarëve që u flijuan për gjënë më të shtrenjtë të kombit, lirinë, jemi këtu. E, po më "Flakën..." do vazhdojmë dhe tutje.

53. Shkrimtari Gërvalla vjen i plotë para lexuesit

Ragip Sylaj
www.zeri.info, 19 janar 2011

Autor që ka shkruar poezi, prozë, dramë dhe artikuj publicistik për letërsinë e për muzikën, Jusuf Gërvalla (1945-1982) është vrarë në një atentat bashkë me Barshosh Gërvallën e Kadri Zekën, në një fshat të Gjermanisë. Ai, kësaj here para lexuesit vjen me veprën e tij të plotë në katër vëllime, që u përurua në ambientet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë.

Drejtuesi i shtëpia botuese "Faik Konica", Nazmi Rrahmani, përvijoi një profil krijues të Gërvallës, i cili para lexuesit vjen me këto vëllime, e ku bëjnë pjesë veprat e botuara më parë në vargje: "Fluturojnë e bien", "Kanjushë e verdhë", "Shenjat e shenjta", "Këngët e moshës" dhe poezi në dorëshkrim e tekste këngësh. Në vëllimin e dytë është përfshirë romani "Rrotull", tregime të botuara në gazeta e revista të kohës dhe drama, "Procesi". Në vëllimin e tretë dhe të katërt janë përfshirë shkrimet publicistike të botuara kryesisht në gazetën "Rilindja" dhe në "Flaka e vëllazërimit".

Për veprën poetike të Jusuf Gërvallës foli Sali Bashota. Sipas tij, Jusuf Gërvalla është poet i vendlindjes, i atdheut, i botës shqiptare. Ky është artikulimi me karakterizues për një poet që fuqinë e frymëzimit e mbështet fillimisht ne truallin e tij për t'u bere i te gjithëve. Prandaj, që në fillimet e krijimtarisë dy figura reprezentative të poezisë se tij, te cilat shndërrohen në simbole të veçanta janë: Nëna dhe Shtëpia. Në çdo variant shpërthimi krijues i poetit valëviten në situata ekzistenciale përmes këtyre dy figurave në tërë udhëtimin e tij krijues, ndërsa vendlindja është burim i mallit, i dashurisë, i shqetësimit, i krajatave jetësore.

Veprat poetike të Jusuf Gërvallës "Fluturojnë e bien", "Kanjushë e verdhe" "Shenjat e shenjta", "Këngët e moshës", si dhe poezitë e mbetura në dorëshkrim , i shtresojnë dhe i fuqizojnë situatat ekzistenciale ne kohen dhe hapësirën e caktuar. Jusuf Gërvalla ne poezinë e tij e ka sistemuar ligjërimin lirik dhe figurën poetike drejt një koncepti estetik nga shpërthen malli për vendlindjen deri te synimi i idealit te subjektit krijues nga shpërthen dashuria për njeriun. Preokupimi krijues i poetit i ka shenjat e veta, frymën e vet, zërin e vet.

Duke folur për veprën e botuar të Gërvallës, Kujtim M. Shala tha se Jusufi shkruante poezi e përkthente prozë, duke shfaqur kështu dashurinë e tij të fshehtë për prozën. Kush nuk i kujton, pyeti ky referues, vjershat e tij të mallit atdhetar, shenjat e shenjta, romanin "Rrotull" etj.? Që me tregimet e tij, krijuesi Gërvalla kishte anticipuar romanin e tij, ku zbulohet edhe kultura orale dhe me të folmen e figurshme apo "me rrotulla" i shmanget të folurit të drejtpërdrejtë. Edhe personazhet më parë se karaktere

janë figura në prozat e tij, ndërkaq romani i tij është sintezë e tregimtarit që e përbëjnë amzën poetike të tij dhe e sprovojnë atë me temat autentike. Ai, sipas Shalës, jetën e tij e bëri vepër për t'u kthyer sot para lexuesit me veprën e plotë.

Për shkrimet publicistike përkatësisht të kritikës së jetës kulturore muzikore foli etnomuzikologu, Rexhep Munishi, përkatësisht për vëllimet 3 dhe 4. Këto shkrime iu përkasin këtyre llojeve: intervista, shkrime për muzikën, si për festivalet "Akordet e Kosovës", "Skena Muzikore e Prishtinës" etj. Me afinitete të shumta dhe me diapazon të gjerë diturish çfarë ishte Jusufi, ai shkruante për tërë atë kompleksitet që quhet kulturë. Pasi foli për jetën kulturore të kohës në fushën e muzikës, për të veçantat e saj dhe për hovin e saj për të marrë në Kosovë një kthesë socio-kulturore, Munishi tha se në shkrimet e Gërvallës për këngët e interpretuara në festivale, ai bënte prezantime, analiza, kritikë, por edhe sugjeronte dhe hidhte ide e mendime për fizionominë e manifestimit. Jusufi interesim të veçantë tregonte për muzikën serioze. Ka në dosjen e gazetarisë së Jusuf Gërvallës shkrime, intervista, prezantime, portretime të krijuesve, dirigjentëve, interpretuesve të afirmuar në atë kohë. Shkrimet e tij janë model se si shkruhet edhe sot për muzikën dhe njëherësh sjellin relaksim shpirtëror.

Në fjalën e saj përshëndetëse dhe falënderuese, Suzana Gërvalla, bashkëshortja e autorit të ndjerë, Jusuf Gërvalla evokoi dramën e botimeve të veprave të të shoqit. Sipas saj, përmbledhja e vështrimeve të Jusufit është edhe një pasqyrë e jetës kulturore të Kosovës në atë kohë. Ndërkaq, në veprat e botuara me këtë rast, sipas saj, shpërfaqet etja për liri e krijuesit që u ndoq deri në Gjermani e që u bë shembull për shumë breza të rinj të Kosovës.

54. DUHET THYER HESHTJA

Donika Gërvalla, Koha Ditore, 19 Janar 2012

Deri sot kam heshtur rreth faktit që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth miqve të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim. Kam mësuar shumë edhe për armiq të tij, të cilët si atëherë ashtu edhe sot, shtiren sikur kanë qenë shokë të tij.

Unë kam qenë 10-vjeçare kur u vra Babi në Gjermani. Vrasja u krye nga profesionistë të Sigurimit jugosllav. Jusuf Gërvalla vdiq më 18 janar 1982, në orën tre të mëngjesit në spital, si pasojë e atentatit të ushtruar më 17 janar ndaj tij, vëllait të tij Bardhoshit, si dhe mysafirit të tyre, Kadri Zeka. Rreth rrethanave të vrasjes kam heshtur 30 vjet.

Për mua dhe vëllezërit e mi, ai më shumë se gjithçka tjetër mbetet Babi ynë. Për nënën tonë ai mbetet bashkëshorti dhe shoku i dashur i jetës. Për Nënën Ajshe, së bashku me mixhën Bardhosh, ata mbesin djemtë e saj të dashur, vdekja e të cilëve ia rëndoi zemrën shumë. Për shumë njerëz në Kosovë, njeriu Jusuf Gërvalla, shkrimtar, gazetar dhe kantautor, ka qenë dhe mbetet një figurë e nderuar, por edhe një njeri i dashur për ta. Këtë burrë trupvogël e bëri të madh jeta dhe vepra e tij.

Deri sot kam heshtur rreth faktit, që e njoh çdo faqe të dosjes hetimore të organeve gjermane. Kam heshtur edhe rreth asaj që kam mësuar nga këto dosje rreth miqve të vërtetë, por edhe armiqve të babait tim. Kam mësuar shumë edhe për armiq të tij, të cilët si atëherë ashtu edhe sot shtiren sikur kanë qenë shokë të tij. .....

Nuk duhet të heshtin më dëshmitarët e kohës që i njohin të gjitha këto fakte. Nuk duhet të heshtet as për atë burrë që e dërguan me armë tek Babi në shtëpi që ta vriste.

Babi, pa i nuhatur aspak qëllimet e tij, gjatë bisedës së gjatë që zhvilluan e bëri që të nxjerrë armën, ta vërë para vetes në tavolinë dhe t'i thotë: „Jusuf, bëj çfarë të duash me mua. Unë kam ardhur të të vras, sepse më patën bindur se je tradhtar. E shoh që qenkam mashtruar". Përgjigjja e Babit ishte miqësia që i ofroi. Po i njëjti person, një atdhetar i flaktë dhe i pakompromis, nga të njëjtët njerëz dërgohet në Kosovë, bie në kurth dhe dënohet me 14 vjet burg. Një viktimë e regjimit jugosllav dhe njëkohësisht një viktimë e tradhtisë shqiptare. ...

Le ta thyejmë heshtjen së bashku… (Koha Ditore, 19 Janar 2012)

Kadri Mani-Osmani: "*Revista jonë "Shqipëria etnike" kaherë e ka thyer heshtjen! Gazetari ynë në Gjermani, zotni Xhafer Leci me shokë, patën përkthyer tekste nga gazetat gjermane."* (www.zemrashqiptare.net, 28 janar 2012)

55. Heshtja që është thyer tash e tri dekada

Nga Faridin Tafallari

Për Jusufin, Kadriun dhe Bardhoshin, nga bashkëveprimtarët dhe shokët e tyre është shkruar që në ditët e para, fill pas vrasjes makabre të Tre Yjeve të Pavdekesisë, me 17 janarin ogurzi të vitit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë.

Komunikata e parë është shkruar për opinionin, me këtë tekst: « TRE RANË ME MIJËRA U NGRITËN»… Më 23 janar 1982, është protestuar para dyerëve të konsullatës vrastare jugosllave, në Shtuttgart, për vrasjen kriminale të TRE TRIMAVE!

Është bërë varrimi me shumë pjesëmarrës, bashkatdhetarët tanë mërgimtare kanë ardhur nga e gjithë Gjermania, kanë ardhur shokë e bashkëveprimtarë të Kadri Zekës, nga Zvicra, kanë marrë pjesë edhe miq e shokë gjermanë, të cilët gjatë varrimit kanë marrë fjalën për të shpreh keqardhjen dhe dhimbjen e tyre, duke u bashkuar me ne në këtë humbje të madhe për kombin tonë.

Varrimi është bërë në mënyrën më madhështore për kohën. Janë dhënë ndihma nga rrethi i Shtuttgartit, nga shumë bashkatdhetarë, nga shumë qytete të Gjermanisë, të cilat janë të regjistruara, pra të dokumentuara. Kanë ardhur ndihma edhe nga Zvicra, Franca, Belgjika, Suedia e vende të tjera evropiane. Nuk munguan ndihmat as nga SHBA-ja e nga Australia. Disa nga ato ndihma janë publikuar në tre librat e mi (F.T.) dhe tash së fundi janë publikuar edhe në tre librat e shkruar nga Xhafer Durmishi.

Janë organizuar disa demonstrata pas vrasjes së tre shokëve nëpër qytetet më të njohura të Perëndimit, si në Bon të Gjermanisë, më 3 prill 1982, atëhere kryeqyteti i Gjermanisë Perëndimore, më 24 prill 1982, në Vjenë, kryeqyteti i Austrisë, si dhe shtet fqinj me ish-Jugosllavinë titiste-fashiste. Janë organizuar edhe shumë e shumë demonstrata dhe tubime, akademi përkujtimore, si dhe organizime të ndryshme apo aktivitete të tjera, pa u ndalur kurrë!!! Të gjitha këto kanë vazhduar deri në momentin, kur UÇK–ja, me kryekomandantin legjendar Adem Jasharin, rroku armët dhe i doli ZOT VENDIT përballë Serbisë fashiste.…Më herët, para se të fillonte lufta, shokët dhe bashkatdhetarët tanë kurrë nuk e ndalën aktivitetin atdhetar e patriotik…shokët tanë binin edhe nëpër burgjet famëkeqe të ish-Jugosllavisë-fashiste… shokët dhe në atdhe …edhe në mërgim vazhdonin me guxim demonstratat e protestat… Për këto aktivitete me karakter patriotik e atdhetar nuk kanë munguar as shkrimet e ndryshme në shtypin e ditës, revista si dhe në libra, ashtu siç e ceka më lart. Kanë shkruar, Kadri Rexha, Faridin Tafallari, Xhafer Durmishi, që të tre shokë e bashkëveprimtarë të Jusuf Gërvallës, ka shkruar dhe magjistruar Myrvete Dreshaj, si dhe shumë të tjerë !? (TË «THYEJMË HESHTJEN»…HESHTJE, QË ËSHTË "THYER" TASH E TRI DEKADA, wwww.albaniapress.com, 4 mars 2012)

56. TRE YJEVE TË PAVDEKËSISË

Nga Faridin Tafallari

www.albaniapress.com, 25 janar 2013

FJALA IME PËRSHENDETËSE NË AKADEMINË PËRKUJTIMORE, E MBAJTUR ME RASTIN E 31 VJETORIT TË VRASJES MAKABRE, TË SHOKËVE TË MI TË IDEALIT, JUSUF E BARDHOSH GËRVALLA DHE KADRI ZEKA, PËRSHENDETJE, ME TË CILËN DËSHIROJ TA NJOH EDHE LEXUESIN E GJERË, NËPËRMES PORTALIT MËSE ATDHETAR–ALBANIAPRESS, PORTAL, QË PËR MUA MËRGIMTARIN, ËSHTË NJË COPËZ ATDHE SHQIPTARIE!!!...

Të nderuara familja Gërvalla e Zeka!
Të nderuar Ju, familjet e dëshmorëve të kombit shqiptar!
Të dashur bashkatdhetare, motëra dhe vëllezer!
Të nderuar organizatore, dhe Ju te nderuar miqtë e mi të klubit „Bardhosh Gërvalla"!

Ju përshëndes të gjithëve "SHQIPTARISHT", DUKE FALENDERUAR, në veçanti, ME ZEMRËN E PASTËR TË BASHKËLUFTËTARIT TË AFËRT E BESNIK, të TRE YJEVE TË PAVDEKËSISË, JUSUF E BARDHOSH GËRVALLA DHE KADRI ZEKA, JU, organizatorët, e kësaj akademie përkujtimore, JU MIQTE E MI TE NDERUAR te klubit "BARDHOSH GERVALLA", që rregullisht keni organizuar, për 31 vite rresht, përvjetore përkujtimi, në nder të atyre TRIMAVE TË PAHARRUAR, përvjetorë, ku unë kam qenë i ftuar rregullisht e njëherit edhe pjesëmarrës dhe ku më është dëgjuar edhe fjala ime përshëndetëse!!!

Por, sot, këtu para jush, duke marrë shkas, nga shkrimi me titull: "DUHET THYER HESHTJA", i shkruar, vitin e kaluar, nga znj. Donika Gërvalla, e bija e heroit te kombit Jusuf Gërvalla, ku ajo, nëpërmes këtij shkrimi kërkon të "thyhet heshtja" për vrasjen makabre të TRE YJEVE TË PAVDEKËSISË, dëshiroj të flas pak e të sqaroj edhe për këtë fakt mjaft të rëndësishëm për mua!? Së pari, nuk di se për çfarë dhe cilën "heshtje " kërkon të thyej znj. Donika, kur "heshtja" e vrasjes së Jusufit të madh, Kadriut të mençur dhe Bardhoshit të paharruar është thyer që në momentin e vrasjes së TRIMAVE, në atë 17 janar ogurzi të vitit 1982!?

…Dhe së dyti, dua t'i kujtoj kësaj zonje se, ajo, në atë kohë, ka qenë një fëmijë jo më shumë se dhjetëvjeçar…dhe për një kohë të gjatë ka jetuar në Tiranë,.. Kështu që, mesa duket, ose nuk i ka lexuar fare, ose nuk i kanë pëlqyer, ato, që janë shkruar e shkruar, që nga ai moment e në vazhdim, për 31 vite me radhë, duke mos heshtur kurrë për këtë vrasje, e cila qe një humbje e madhe për mbarë kombin shqiptar, si në atë kohë, por edhe për ditët e sotme!!!

…Pas vrasjes së TRIMAVE, e cila që një tronditje e madhe për mbarë kombin shqiptar, për të gjithë mërgimtarët patriotë e atdhedashës, janë organizuar dhjetëra demonstrata nëpër qytete të ndryshme të Perëndimit, si në Gjermani, Zvicër, edhe në shtetet përreth…Po si mund të harrohen gjithë ata bashkatdhetarë, që vinin me lot në sy, nga çdo anë e globit tokësor…madje që nga matanë oqeanit, për tu "përshëndetur" me TRE YJET E PAVDEKËSISË?!

Për nder të TRE YJEVE TË PAVDEKËSISË janë organizuar gati 20 tubime përkujtimore, deri sa eshtrat e tyre u kthyen në vendlindje!? Por edhe "kthimi" i tyre në atdhe, nuk na "ndau" nga përvjetorët e shtrenjtë të TRIMAVE… Ndaj për çdo përvjetor kemi shkuar të organizuar, tek vendi i ngjarjes. Këtu, në mënyrë të veçante, dua te përmend z. Can Tahiri, zëvendes kryetar I UNIONIT ARTISTIK I KOMBIT SHQIPTAR dhe njëherit AMBASADOR I PAQES GLOBALE, i cili me shumë përkushtim, ka drejtuar më shumë se dhjetë vite, organizimin e vizitës në Untergrupenbach, tek banesa e Gërvallajve, si dhe tek Garazha, por edhe në sallën e tubimit!

Prandaj, dëshiroj ta theksoj se, për njëzet vite sa ishin eshtrat e TRIMAVE këtu, ne, së pari kemi protestuar me forcë, për vrasjen e tyre, nga UDB-titiste e ish-Jugosllavisë, nëpër rrugët e Shtutgardit…dhe prej aty, pa pyetur për acaret e akullt të janarit, kemi shkuar në varreza, për të bërë homazhe… duke i mbuluar me kurora lulesh, varret e atyre TRIMAVE të PAHARRUAR!

Dhe jo vetëm ne, të Shtutgardit me rrethinë, por, në ato kohëra, në ato vite të vështira, bashkatdhetarët tanë vinin nga çdo anë e Gjermanisë, me gra e fëmijë te vegjël, në acar e në të ftohtë, në borë e ngrica të janarit të egër, për t'i kujtuar e nderuar TRIMAT E RËNË!?

Pra, e nderuara znj. Donikë, që këtu, tashmë, ishte thyer "heshtja"…Në protestat tona ziente revolta, mllefi, urrejtja kundër dorës gjakatare të UDB-s titiste, por edhe kundër asaj dore tradhëtie, udbashes shqipfolës, që e ndihmuan këtë vrasje makabrë !?

Znj Donika, babai është shumë i shtrenjtë, por edhe shoku, në veçanti shoku i mirë dhe i ndershëm, shoku i idealit të shenjtë ,atdhetar e patriot, ku së bashku jemi betuar se, deri në vdekje do të luftojmë për Çlirimin e trojeve shqiptare nen ish-Jugosllavinë fashiste, deri në bashkimin e të gjitha trojeve me Shqipërinë Amë, ku në të gjithë rrugën tonë të luftës e sakrificave sublime, i qëndruam besnik njeri tjetrit…edhe për mua ky shok është i rrallë…është tepër i shtrenjtë!?…

I tillë ishte JUSUFI I MADH PËR MUA! Të tillë ishin TRIMAT, SHOKËT E MI TË IDEALIT TË SHENJTË… JUSUF, KADRI, BARDHOSH!!!...

Të gjitha organizimet janë të dokumentuara, të inçizuara, të filmuara, madje për kuriozitet, me kamerën time personale ka inçizuar një shok, Hamit Krasniqi Por, unë, si bashkëluftëtari më i afërt i Jusufit, kam shkruar edhe katër libra, dhe mjaft shkrime të tjera publicistike, si për ngjarjen tragjike, për dashurinë dhe respektin, përkushtimin tim të madh për TRE YJET E PASHUARA!!!

Librat e mi janë shkruar në bazë të ditarit tim personal, ku kam mbajtur shënime të rregullta gjatë aktiviteteve dhe veprimtarive, por edhe në bazë të dokumentacionit të vërtetë dhe real, pa shtojca apo sajime e të pavërteta, e jo siç po bëjnë disa kalemxhinj ,sot, ku fatkeqësisht janë shumë, që shkruajnë fantazi të mbushura me gënjeshtra dhe me të pavërteta, si për figurën e TRIMAVE, PËR IDEALIN DHE RRUGËN E TYRE DREJT LIRISË!?

Kohëve të fundit, ka shkruar në librat e tij, për JUSUF GËRVALLËN, edhe Xhafer Durmishi, i cili ka qenë shoku më i ngushte i Jusufit, njëherit dhe i imi. Ai ka qenë pranë Jusufit dhe e ka ndihmuar edhe në përgatitjen e shtypit ilegal si "Zëri i Kosovës" etj! Në këto libra, Xhafer Durmishi, ka bërë një analizë që, cilido dhe kushdo, që të ishte ai, e edhe intelektuali më i arsimuar kurrë nuk do të mund ta bënte aq saktesisht, atë, që ai e ka bërë në mënyrë shumë reale dhe me besnikëri burrërore …Ndaj do ju lutesha, të lexoni gjashtë librat e Xhafer Durmishit se vetëm aty dhe vetëm ATY, në atë saktësi

shkrimesh, të këtij besniku të JUSUFIT TË MADH do ta gjeni TË VËRTETËN E MADHE të FIGURËS SË GJENIUT JUSUF!!!…DO TË GJENI JUSUFIN E GJALLË, LUFTËTARIN E PAEPUR TË LIRISË DHE ÇËSHTJES MBARËKOMBËTARE SHQIPTARE!!!

Po e përsëris, të dashur bashkatdhetarë se, pos Xhafer Durmishit, kurrë nuk do ta bënte asnjë tjetër, sepse, askush si ai, nuk e ka njohur karakterin burrëror, patriotik e luftarak, shpirtin e madh, njerëzor, korrektesën, ndershmërinë, besën dhe sinqeritetin e fortë dhe të gjitha ato virtyte të larta, që i ka pasur, si askush tjetër, Jusufi ynë i Madh!
Për dëshmorët dhe heronjtë e kombit nuk mund të shkruhet me sajesa e me gënjeshtra, apo edhe më keq… duke ia vjedhur punën dikujt tjetër?!?

* * *

TE NDERUAR LEXUES!

Duke qenë, dëshmitari i gjallë dhe më i afërt, NË ATO VITE TË STUHISHME, të veprimtarisë sime atdhetare, me shokët e mi të IDEALIT, JUSUF E BARDHOSH GËRVALLA DHE KADRI ZEKA, kam qenë, jam dhe do të jem përherë i vëmendshëm, ne veçanti për ate se, ç'ka thuhet, ç'ka flitet dhe c'ka shkruhet, nga kushdo qoftë, pra gjithçka, që ka lidhje me TRE YJET E PAVDEKËSISË, përherë me qëllimin e lartë për të qenë të vërtetë dhe real!!!

Edhe në këtë AKADEMI PËRKUJTIMORE, në fjalën e saj, znj. Donika Gërvalla, e bija e HEROIT TË KOMBIT, JUSUF GËRVALLA bëri një "kritike" se…"nuk po përmendet sa duhet axha Bardhosh Gërvalla…!?"

Për Ju, lexues të nderuar, dua tu them, me bindje të plotë se, ne, shokët e TRIMAVE, unë, Faridin Tafallari, apo edhe Xhafer Durmishi, kurrë nuk e kemi lënë anash Bardhoshin, por i jemi përmbajtur realitetit. Është e vërtetë se, kemi shkruar me shumë për Jusufin, sepse Jusufi ishte dhe është në qendër të punimeve tona, por ama Bardhoshin nuk e kemi harruar kurrë dhe kjo është mëse e vërtetë dhe madje e vërtetuar pothuajse në të gjitha shkrimet tona!?

Por me këtë rast unë dua t'i bëj një KUNDËRKRITIKË shumëdomethënëse znj.Donika Gërvalla, ku, ajo, në nismën "ME JUSUFIN", NISMË E FONDACIONIT GËRVALLA , botuar dhe shpërndarë në internet, në janar të vitit 2012, që në emërtimin e nismës e në tërë përmbajtjen e saj, në asnjë rresht, nuk e përmend askund axhën e saj, BARDHOSH GËRVALLA!?!...

Dhe, për të vërtetuar këtë, po ju jap më poshtë, të plotë, nismën e Fondacionit "Gërvalla", të titulluar "ME JUSUFIN"
Nga www.gervalla.org
Një nismë për të mbledhur dhe publikuar
kujtimet tuaja me Jusuf Gërvallën
A e keni takuar ndonjëherë Jusuf Gërvallën? A njihni dikë që e ka njohur?

A njihni dikë që mund të ketë ende shkrime, fotografi apo këngë të Jusufit (kaseta, pllaka, video)? Ju lutemi, na lejoni të bëjmë një kopje profesionale të tyre.
A ju kujtohet ndonjë këngë, tekst apo ngjarje para dhe pas vdekjes së tij, që ju ka lënë mbresë dhe ka domethënie të posaçme për Ju? Na shkruani nëse Jusufi ju ka frymëzuar për një vepër atdhetare, letrare, artistike apo thjesht njerëzore në ndonjë fazë të jetës suaj.
Ju lutemi, na dërgoni materialet tuaja!

Fondacioni Gërvalla me anë të këtyre dëshmive dëshiron të paraqesë sa më realisht figurën e Jusuf Gërvallës. Në muzeun Gërvalla dhe jashtë tij do të dokumentojmë veprimtarinë atdhetare të Jusufit, jetën, artin, shkrimet dhe këngët e tij.
Vullneti juaj do të respektohet, nëse dëshironi që dëshmia Juaj të mbetet konfidenciale. Publikimet mund të bëhen vetëm me pëlqimin tuaj.
Ju lutemi, ndihmoni të dokumentojmë trashëgiminë e Jusufit për brezat e ardhshëm. Mbështesni nismën „Me Jusufin“. (www.gervalla.org, janar 2012)

Faridin Tafallari, www.albaniapress.com, 25 janar 2013

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: “*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.”* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Qershor 2013-Shkurt 2026